RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
"AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE MBI VEPRIMTARINË E ADMINISTRATËS SË ZONAVE TË MBROJTURA LEZHË"

	Përmbajtja	1
I	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	2-2
	1.Përshkrim i shkurtër Projektit të Aditimit	2-3
	2.Përshkrim i gjetjeve kryesore	3-4
	3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	4-5
II	**HYRJE**	5-5
	1.Objekti i auditimit	5-6
	2.Qëllimi i auditimit	5-6
	3.Identifikimi i çështjes	5-6
	4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	6-6
	5.Përgjegjësitë e audituesve	6-6
	6.Kriteret e vlerësimit	7-7
	7.Standardet e Auditimit	7-7
	8.Metodat e auditimit	7-7
	9. Dokumentimi i auditimit	7-8
III	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	8-60
	1.Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	8-9
	2.Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve tëauditimit	9-60
Pika 1	Krijimi dhe përdorimi i të ardhurave që realizon institucioni. Burimet e krijimit të të ardhurave. Auditimi i kontratave të dhënies me qira dhe PPP-ve. 1.1 Auditim mbi përdorimin e të ardhurave nga institucioni.	9-9 9-16 16-19
Pika 2	2. Mbi administrimin e pronës shtetërore. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare. 2.1. Inventarizimi i pronës shtetërore dheregjistrimi në Zyrat e Pasurisë.	19-23 23-24
Pika 3	3. Auditim mbi zbatimin e ligjshmërisë në monitorimin e mjedisit dhe zbatimi i kushteve për ruajtjen e tyre. Vlerësimet periodike të situatave mjedisore në aktivitetin mjedisor e zhvillimor të zonave dhe ruajtjen e monumenteve të natyrës, masat e marra. 3.1. Mbi zbatimin e procedurave për planet zhvillimore të subjekteve private e vetë njësisë publike. 3.2. Hartimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit për Zonat e Mbrojtura.	24-28 28-42 42-44 44-55

Pika 4	4. Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të vetë monitorimit dhe monitorimit të mjedisit në zona dhe auditimin e dosjeve mjedisore.	55-57
Pika 5	5. Auditim mbi bashkëpunimin me organet e tjera të kontrollit si ARM, etj., për kryerjen e inspektimin e kontrolleve të përbashkëta në zona e mbrojtura.	57-60
6	Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimi	-
IV	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	61-67
V	**ANEKSE**	68-71

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë kryen veprimtarinë në zbatim të ligjit nr.81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò; VKM nr.1189, datë 18.11.2009 ñPër rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisitò; Ligjin nr.10431, datë 9.6.2011 ñPër mbrojtjen e mjedisitò i ndryshuar; si dhe Urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 129, datë 23.06.2016 ñPër miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojturaò, vendime dhe udhëzimet tjera të dala në funksionim të ligjeve. Menaxhimin ruajtjen e zonave të mbrojtura mjedisore, parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, menaxhimit të kujdesshëm, të burimet tokës, përfshirë ajrin, ujin, florën dhe faunën. Integrimi i politikave të mbrojtjes së mjedisit në ato të zhvillimit ekonomik, ndërgjegjësimin e popullatës ndaj florës, faunës, ndalimi gjuetisë të paligjshme në zona të mbrojtura. Monitorimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura si dhe krijimin e përdorimin të ardhurave që realizon institucionit.

I .1. Përshkrim i shkurtër i Projektit tëAuditimit

I.2. Auditimi i ushtruar në ADZM Lezhë, u realizua mbi zbatimin e përputhshmërisë, rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në aktivitetin, monitorimin, gjendjen e florës dhe faunës si dhe mbrojtjen e mjedisit.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Në zonat e mbrojtura ushtrojnë aktivitet individ privat banorë të zonës si dhe një numër i konsiderueshëm biznesesh,që shfrytëzojnë këto burime natyrore fitimprurëse.	Pika 3.	E mesme	AdZM Lezhë të marrë masa që në çdo raste të ketë informacionin e duhur nëpërmes monitorimeve për aktivitete që kryhen brenda zonës së mbrojtur.
2	Mangësi në dokumentacionin e shpenzimeve për karburant.	Pika 2.	E mesme	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë, të marrin masa për planifikimin e shpenzimeve të karburantit referuar volumit të punës,nevojave reale dhe normativave të harxhimit për çdo mjet me qëllim realizimin e objektivave dhe përdorimin me efektivitet të aktiveve.
3	Mos hartim i planit të menaxhimit nga Ministria e Mjedisit dhe	Pika3.2	E mesme	Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në sinkron me AKZM, Tiranë të kërkojnë pranë

	Turizmit.			Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, përshpejtimin e miratimit të planeve të menaxhimit, për zonat e mbrojtura, për sigurimin e ruajtjes dhe mirë menaxhimit të tyre ,duke zbatuar rregullat dhe planet me përpikmëri të këtyre planeve nga të gjithë aktorët që janë pjesë dhe shfrytëzojnë burimet natyrore dhe vlerat kulturore, historike të ZM për 10- vjeçarin e ardhshëm.
4	Problematikat e flora dhe fauna në zonat e mbrojtura. ¤	Pika. 4	E mesme	Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, ku njëra monitoron dhe konstaton dhe tjetra procedon, për çdo kontroll të kryer në terren të merren masa që rastet e flagrancës të dokumentohen e ndëshkohen rastet e kundërvajtjeve administrative dhe shkeljeve ligjore.
5	Nga auditimi u konstatua se 8 procesverbale konstatimi rezultojnë të jenë pa autorë,	Pika .5		Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në bashkërendim me Inspektoratin e Policisë Pyjore të marrë masa për të zbuluar dhe ndëshkuar,rastet e dëmtimit, pushtimit, shpërdorimit, tjetërsimit, shkretimit dhe degradimit të zonave të mbrojtura brenda territorit të tyreò.
6	Ndërtimet Informale në zonat e mbrojtura	Pika3.1	E Lartë	ADZM Lezhë të marrë masa dhe të këtë të gjithë informacionet për ndërtimet informale, si dhe të bashkëpunoje me të gjitha institucionet ligj zbatuese për Zonën e mbrojtura me njoftime periodike shkresore pranë IKMT dhe ASHK për ndjekjen procedurave ligjore në të gjitha ato zona ku ka objekte të ndërtuara jashtë ligjit.

I.3. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi përputhshmërinë: (pa kulifikuar)

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Administratës të zonave të Mbrojtura, me VKM Nr.102, datë 04.02.2015 ñPër krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të administrative rajonale të zonave të mbrojtura) dhe me Ligjin nr. 81/2017 ñPër Zonat e Mbrojturaò.

Në opinionin tonë, bazuar në punën e kryer të auditimit ka rezultuar se aktiviteti i Administratës të Zonave të Mbrojtura, është në përputhje në të gjitha aspektet materiale me VKM Nn.102, datë 04.02.2015 ñPër krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të administrative rajonale të zonave të mbrojtura) dhe me Ligjin nr. 81/2017 ñPër Zonat e Mbrojturaò.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin e përputhshmërisë në mbështetje me ligjin nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò në përputhje me

(ISSAI 4100)[1] Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Manuali i Auditimit Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.06.2020. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së.

Në besojmë se evidencat e auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit i pa kualifikuar. Dhënien të **opinionit pa kualifikuar** e mbështesim në konkluzionet e mëposhtme të arritura në përfundim të procesit të auditimit për marrjen e masave në zgjidhjen e çështjeve:

-Zonat e mbrojtur Lezhë kanë shtrirje në një sipërfaqe prej15 mije hektarë, si zonë e mbrojtur natyrore dhe nga të dhënat e raporteve të menaxhimit dhe monitorimit nga Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë dhe nga projekte veprimtaritë ekonomike-sociale, që veprojnë në këtë zonë, është konstatuar se ka nivele të larta ndotjeje të cilat kanë ndikuar në cilësinë ujit dhe të ajrit si dhe kanë ndikim negativ në florën dhe fauna e cila është e kërcënuar për vete faktin se brenda zonave të mbrojtura jetojnë një numër i lartë banoresh, që me aktivitetin e tyre cenojnë këto vlera si dhe dëmtojnë biodiversitetin.

Gjithashtu në zonat e mbrojtur ushtrojnë aktivitet individ privat banorë të zonës si dhe një numër i konsiderueshëm biznesesh,që shfrytëzojnë këto burime fitimprurëse.

-Nga Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë ka evidentim dhe regjistrim të subjekteve të biznesit të cilat kryejnë veprimtari të ndryshme me karakter ekonomik dhe social si bujqësi,kulturore dhe shërbimet turistike. Nuk ka të dhëna për to në lidhje me aktivitetet e tyre (licencimi,koha e ushtrimit të aktivitetin, mendime , territoret apo dhe veprimtaritë e të cilëve përfshihen në zonën e mbrojtur ose në atë buferike) në kundërshtim me neni 9 pika 5 I ligjet nr. 81/2017 ñPër Zonat e Mbrojturaò.

-Nga Qeveria Qendrore dhe Pushteti Vendor nuk është zgjidhur problem i taksimit specifik të personave fizik dhe juridik që shfrytëzojnë vlerat natyrore, historike dhe kulturore të zonave të mbrojtura, nëpërmjet përfshirjes së tyre në paketat fiskale të tyre.

-Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë ka të evidentuara ndërtimet pa leje të kryera në ZM të Qarkut Lezhe, të cilat duhet të ishin raportuar pranë AKZM Tiranë. Nga informacioni i marrë nga zyra e ASHK Lezhë, rezulton se ka pasur një numër të ndërtimeve pa leje dhe Vetë deklarimeve për legalizim. Për këtë arsye në disa zona aty ku ka pasur edhe një dendësi të lartë të ndërtimeve është vepruar duke i shpallur Zona Informale.

-Këto legalizime janë bërë në mungesë të planit të menaxhimit të zonës të aprovuar në kundërshtim meligjin nr. 81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò ñneni 19 ñPërdoruesit e zonave të mbrojturaò dhe Neni 25 ñVeprimtaritë në zonat e mbrojturaò ligjin nr. 2020/2020 ñPër Përfundimin e Proceseve kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisëò.

-Për periudhën objekt auditimi ishin kryer inventarët e viteve 2019 dhe 2020, por ende nuk ishte kryer inventari i vitit 2021, për këtë në Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhënuk ka ardhur urdhër për kryerjen e inventarit të vitit 2021 nga AKZM.

-Nga auditimi u konstatua se 8 procesverbale konstatimi rezultojnë të jenë pa autorë, sa më sipër është vepruar në kundërshtim të ligjit Nr. 81/2017 ñPër Zonat e Mbrojturaò.

[1] ***ISSAI 4100*** *- Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet veçmas me auditimin e pasqyrave financiare.*

-Në subjekte që kanë lidhur kontratë qiraje me Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë rezulton që nuk ka dorëzuar pranë kësaj administrate raportet e vetëmonitorimit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim të ligjit Nr.81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò.
Nga Ministra e Turizmit dhe Mjedisit nuk është zgjidhur, problemi i vendosjes së infrastrukturës dhe tarifave të nevojshme, gjetjen e rrugëve dhe mjeteve për realizimin e të ardhurave, nga institucionet që menaxhojnë zonat e mbrojtura.
Përgjegjësitë e Drejtuesve të Administratës së Zonave të Mbrojtura Lezhë:
-Monitorimi i mjedisit dhe zbatimi i kushteve për ruajtjen e tyre, vlerësimet periodike të situatave mjedisore, aktivitetin mjedisor e zhvillimor dhe ruajtjen e monumenteve të natyrës,
- Hartimi i plan-menaxhimit dhe zbatimi i tyre,
- Bashkëpunimi me organet e tjera të kontrollit si ish/DRISHMP, Njësitë Vendore etj.
Përgjegjësitë e Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:
Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Administratës së Zonave të Mbrojtura Lezhë, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe efecient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.
Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e administrimit të zonës së mbrojtur, që është identifikuar gjatë auditimit.
Audituesit identifikojnë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe përshkruhen në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë audituesit mendojnë që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSH-sëò, në zbatim të Programit të Auditimit nr.1275/1, datë 26.11.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 26.11.2021,deri në datë 04.02.2022, në subjektin AZM Lezhë, për periudhën nga 01.01.2019 deri në 31.12.2021,u krye auditimiñMbi zbatimin e përputhshmërisëò, nga **Grupi i Auditimit me përbërje:**

1.V. B., përgjegjës grupi
2.Sh.H., anëtare
3.K. F., anëtare
4.M. B., anëtare

***1.Objekti i auditimit*:** Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar zbatimin e përputhshmërisë, rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në aktivitetin, monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit për periudhën objekt i këtij auditimi, në përputhje me:
-Ligjin nr. 154/2014datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligjin nr.81/2017 datë 04.05.20217ñPër zonat e mbrojturaò;

-Vendimi i KM nr. 102, datë 04.02.2015 ñPër krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojturaò;
-Urdhri i Kryeministrit nr.39 datë 12.03.2015, mbi ñMiratimin e strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonaletë Zonave të Mbrojtura";
-Urdhrin nr. 48 , datë 29.03.2016, óñMiratimin e strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojturaò i ndryshuar;
-Si dhe udhëzimeve te dala nga Ministria Mjedisit dhe Turizmit.

2.Qëllimi i auditimit: Eshtë vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve proceduralë, administrative, ekonomike e financiare të Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhe, mbi çështjet që lidhen me ruajtjen, menaxhimin, monitorimin e zonave të mbrojtura si dhe masat dhe bashkëpunimet ndërinstitucionale për parandalimin e dëmtimeve ekologjike dhe natyrore.

3. Identifikimi i çështjes
1-Rregullshmëria e plotësimit dhe përpunimit të dokumentacionit për shpenzimet e të ardhurat.
2-Hartimi i kontratave dhe lidhja me të tretet, mënyra e plotësimit dokumentacionit.
3-Përdorimi efektiv i shpenzimeve minimale operative në lidhje me rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e dokumentacionit mbështetës për përdorimin e karburantit dhe kancelari.
4-Monitorimi i mjedisit dhe zbatimi i kushteve për ruajtjen e tyre,vlerësimet periodike të situatave mjedisore, aktivitetin mjedisor e zhvillimor dhe ruajtjen e monumenteve të natyrës.
5-Hartimi i plan-menaxhimit dhe zbatimi i tyre.
6-Marja e të dhëna për ndërtimet informale në zonat e mbrojtura.
7- Bashkëpunimi me organet e tjera të kontrollit si ish/DRISHMP,Njësitë Vendore etj.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar
Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhe,në zbatim - ligjin nr.81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò që ka për objektiv: Vendimi i KM nr. 102, datë 04.02.2015 ñPër krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojturaò.
-Urdhri i Kryeministrit nr.39 datë 12.03.2015, mbi ñMiratimin e strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonaletë Zonave të Mbrojtura"
-Urdhrin nr. 48 , datë 29.03.2016, óñMiratimin e strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojturaò i ndryshuar.
-Si dhe udhëzimeve te dala nga Ministria Mjedisit dhe Turizmit.
-Monitorimi i mjedisit dhe zbatimi i kushteve për ruajtjen e tyre,vlerësimet periodike të situatave mjedisore, aktivitetinmjedisor e zhvillimordhe ruajtjen e monumenteve të natyrës,
- Hartimi i plan-menaxhimit dhe zbatimi i tyre,
- Bashkëpunimi me organet e tjera të kontrollit siish/DRISHMP, Njësitë Vendore etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve
Grupi i auditimit të KLSH-së,për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimitnë përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, grupi i auditimit ka zbatuar Kodin e Parimet Etike të cilat drejtojnë përgjegjësitë profesionale të audituesit, si dhe Standardet e Miratuara të Auditimit të cilat kanë në qendër të vëmendjes:

- Evidentimi i të metave dhe mangësive në lidhje me rregullshmërinë e proceseve sipas legjislacionit dhe rregullave të funksionimit të miratuaranga Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë.
- Monitorimi i mjedisit dhe zbatimi i kushteve për ruajtjen e tyre, vlerësimet periodike të situatave mjedisore, aktivitetinmjedisor e zhvillimordhe ruajtjen e monumenteve të natyrës.
-Vlerësimi i realizimit të treguesve të të ardhurave, shpenzimeve, mënyrës dhe saktësisë në pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare dhe rakordimit me thesarin.
- Hartimi i plan-menaxhimit dhe zbatimi i tyre.
-Puna për krijimin e të ardhurave dhe mbështetja institucionale për vendosjen e tarifave dhe infrastrukturës së nevojshme për realizimin e tyre.
- Vlerësimi i transparencës me publikun, krahasimi i rezultateve të veprimtarisë së institucionit midis viteve objekt i auditimit.
- Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës.
- Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, shlyerjen e dëmeve të mundshme ekonomike dhe parandalimin e veprimtarive të paligjshme dhe ruajtjen e vlerave natyrore e kombëtare të ZM.

6. Kriteret e vlerësimit

Përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të Administratës së Zonave të Mbrojtura Lezhë, normat dhe metodat e përcaktuara sipas kërkesave të ligjeve, akteve administrative, rregullores së institucionit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe database e kadastrave.

Në të gjitha fazat e auditimit sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit, në referencë me problematikën është patur si kriter vlerësues në radhë të parë ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, - Ligjin nr.81/2017 datë 04.05.20217 ñPër zonat e mbrojturaò;VKM nr.102 datë 04.02.2015 ñPër krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojturaò;Urdhri i Kryeministrit nr. 39 datë 12.03.2015, mbi ñMiratimin e strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura";Urdhrin nr.48,datë 29.03.2016, ñMiratimin e strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojturaò i ndryshuar.

Në vlerësimin e mekanizmave të auditimit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

-llojet e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve të cilat mund të ndodhin;

-procedurat e mekanizmave të auditimi, që i shërbejnë parandalimit dhe zbulimit të këtyre gabimeve, të metave, parregullsive dhe shkeljeve;

-nëse janë miratuar procedurat e duhura dhe nëse niveli i respektimit të tyre, është i kënaqshëm;

-anët e dobëta të mekanizmave ekzistuese të auditimi, që çojnë në mos zbulimin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve prej tyre;

-ndikimi që këto anë të dobëta kanë, dhe:

-shpërndarjen në kohë dhe intensitetin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve.

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet duke përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë së procesit të legalizimit dhe rregullshmërisë së veprimtarisë, konform me parimet, normat, rregullat dhe ligjet në fuqi.

7. Standardet e auditimit

Rregullorja e Brendshme ñMbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetitò, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 85, datë 30.06.2015; Rregullorja e Brendshme ñPër procedurat e auditimit të KLSHò; Udhëzimi i Kryetarit të KLSH nr. 1,datë 04.11.2016ñ Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetitò; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-tò (ISSAI), ñStandardet e Kontrollit të KLSHò, ñManualeveò si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre.

8. Metodat e auditimit

Përarritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

a. *Metoda e ekzaminimit*: Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar të mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe efiçencën e veprimeve.

b. *Metoda e ekzaminimit kryq*: Është përdorur kur është marrë informacioni për një ngjarje nga një burim i caktuar. Ky informacion është marrë dhe është krahasuar me një informacion të marrë për të njëjtat ngjarje, por me origjinë nga një burim tjetër. Kjo metodë është përdorur për të arritur nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë së përfundimeve**.**

c. *Metoda e intervistimit*: Është konsideruar si një nga metodat më të mira dhe më të përshtatshme të përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të menjëhershëm. Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi i takimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patur përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxherial dhe operacional gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësisë së audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashtrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së informacioneve duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjera). Evidencat e auditimit që përftohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.

d. *Metoda e testimit të detajuar*: Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230ñDokumentimi i Auditimitò. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Administrata e zonave të Mbrojtura Lezhë kryen veprimtarinë në zbatim tëligjit nr.81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò; VKM nr.1189, datë 18.11.2009 ñPër rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisitò; Ligjin nr.10431, datë 9.6.2011 ñPër mbrojtjen e mjedisitò i ndryshuar; si dhe Urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 129, datë 23.06.2016 ñPër miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojturaò vendime dhe udhëzimet tjera të dala në funksionim të ligjeve, ka për objektiv: menaxhimin, ruajtjen e zonave të mbrojtura mjedisore, parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, menaxhimit të kujdesshëm, të burimet tokës, përfshirë ajrin, ujin, florën dhe faunën; integrimi i politikave të mbrojtjes së mjedisit në ato të zhvillimit ekonomik, ndërgjegjësimin e popullatës ndaj florës, faunës, ndalimi gjuetisë të paligjshme në Zonë të mbrojtura.Monitorimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojturasi dhe krijimin e përdorimin të ardhurave që realizon institucionit.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

Pika. 1. Krijimi dhe përdorimi i të ardhurave që realizon institucioni. Auditimi i kontratave me qira dhe PPP-ve.

Për periudhën objekt auditimi nga Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë, në lidhje me aktivitetin e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor zonë e mbrojtur për kryerjen e aktiviteteve të lejuara në zbatim të ligjit 81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò. Lidhja dhe zbatimi i kontratave është bërë në zbatim ligjit nr. 81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò, procedurat janë ndjekurnë zbatim të Urdhrit të Ministrit të Mjedisit nr. 129, datë 23.06.2016 ñPër miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojturaò.

Në zbatim të nenit 58 dhe 57 të ligjit nr.81/2017, ñPër Zonat e Mbrojturaò janë miratuar dy akte nënligjore: VKM nr.1156, datë 24.12.2020 ñPër përcaktimin e të ardhurave të gjen eruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyreò. Dhe udhëzimi nr.1, datë 10.2.2021 i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit ñPër rregullat e përdorimit dhe të gëzimit të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore dhe pagimin e çmimit për toò.

Në mbështetje të pikës 11, të VKM-së1156/2020 në datën 2 mars 2021, nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është kryer transferimi i të ardhurave të akumuluara në llogarinë jashtë thesarit në bankë te nivelit të dytë, me emërtimin ñDrejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe kullotave, qe nga krijimi i AKZM-se,në llogarinë e të ardhurave të thesarit për AKZM, të cilat sipas këtij vendimi do të administrohen nga AKZM.

Këto të ardhura ishin kanalizuar nëpërmjet llogarisë së thesarit dhe do të përdoren nga AKZM si të ardhura jashtë limitit. Sipas lidhjes 1 të VKM-së janë miratuar 7 grupe tarifash për zonat e mbrojtura mjedisore. Tarifat e vendosura në VKM hyn ne fuqi në 1 shtator te vitit 2021.

Gjatë periudhës objekt auditimi 1 Janar 2019 deri më 31.12.2021, baza ligjore mbi të cilën janë lidhur kontratat për të ardhurat e krijuara në ZM janë bërë në zbatim ligjit nr. 81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò procedurat janë ndjekur në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Mjedisit nr. 129, datë 23.06.2016 ñPër miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojturaò, U evidentuan tre lloje burimesh të ardhurash:

-Të ardhura nga dhëniet e fondit me qira të zonave të mbrojtura.

-Të ardhura të krijuara nga hyrja e vizitorëve në postblloqet; Kune Vain.

Pika 1.1.Auditimi mbi përdorimin etëardhurave,që krijohen nga institucioni .

Të ardhurat arkëtohen sipas VKM të hyrë në fuqi nga shtatori 2021, në llogaritë të AKZM Tiranë, të cilat përdoren sipas nevojave të institucionit me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm.
Pranë AdZM-së nga subjekte të ndryshëm u janë depozituar kërkesa të shumta me natyra të ndryshme për zhvillim veprimtarish të lejuara brenda territorit të zonave të mbrojtura dhe konkretisht:
Në AdZM-në e Lezhës, për vitet 2019, 2020 dhe 2021, janë lidhur 8 kontratë qiraje, me kërkesa nga subjekte apo persona fizik për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura: si më poshtë: tetë subjektet kanë lidhur kontrata me një periudhe 1-vjecare me të drejtë përsëritje, dhe në një rast me afat vjeçare.
Nga auditimi i kryer u shqyrtuan procedurat e kontratave për subjektet si më poshtë:
Kërkesat nga AdZM Lezhë
1. Për subjektin: A.L.
1.Kërkesë e paraqitur nga subjektime nr. 121, datë 06.06.2017 dhe është përcjellë AKZM me shkresën nr. 415/1 datë 21. 06. 2017, nga AdZM Lezhe, me shkresën nr. 715 datë 21.06.2017, Për shqyrtim dhe vlerësim të dokumentacionit të subjektit; **A. L.** për zhvillimin e veprimtarisë ñveprimtari turistikeò, Instalimin e subjektit me konstruksion druritë çmontueshëm për qellim pushim dhe argëtimi te pushueseve në ZM ñPatok Fushë Kuqeï Ishëmò.
Nga AKZM, është bërë shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesës bazuar në pikën 7 të Urdhrit të Ministrit nr. 129, datë 23.6.2016 ñPër miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje për zonat e mbrojturaò. Si dhe udhëzimit të Ministrit të Mjedisit dhe Turizmit 10.02.2021 ñPër rregullat e përdorimit dhe gëzimit të shërbimeve qe zotëron zona e mbrojtur dhe pagimin e çmimeve për toò.
Nga Drejtoria e Menaxhimitnëpërmjet memos informuese është dhënë informacion mbi lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së ñveprimtari turistikeò, për ngastrën ñpër ngastrën 0.63 ha, ñme zoonim të brendshëm Zonë e Zhvillimit të qëndrueshëm. Në zonën e mbrojtur Kune ï Vain Tale parcele nr. 16 ekonomia pyjore Shëngjin Tale ñò Për lejimin e zhvillimit të kësaj veprimtarie,nga Drejtori i Përgjithshëm është bërë aprovimi nëpërmjet urdhrit nr. 132, datë 22.06.2021 ñPër miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 0.63 ha, në zonë të mbrojtur, Lezhë ò. Është lidhur kontrata nr.93 datë 12.07.2019, nga AdZM Lezhë, me afat 1vjeçare, nga datë .02.07.2020,deri në datë 01.07.2021, më të drejtë rinovimi , me vlere **56,700** lekë në vit. Nga auditimi i kësaj procedure u konstatua që veprimtaria e kërkuar është në përputhje me neni 33, të ligjit 81/2017ñPër zonat e mbrojturaò. Nga auditimi rezultoi që tarifa e vendosur ishte në përputhje me lidhja nr.2, VKM-së nr.1064, datë 22.12.2010, ñPër disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò. Pagesa është kryer në përputhje me nenin 5 të kontratës. Kontrata është lidhur me një afat 1 vjeçar,me të drejtë rinovimi.
Në zbatim të pikës 2, të kreut IV të VKM-së nr.382, datë 25.5.2016 ñDisa shtesa në vendimin nr. 102, datë 04.02.2015 ñPër krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojturaò, i ndryshuar. Nga AdZM Lezhë është lidhur kontrata më subjektin R. L. Person Fizik.
Nga auditimi i kësaj procedure u konstatua që veprimtaria e kërkuar nuk është në përputhje me neni 33, të ligjit 81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò, **germa a)**çdo veprimtari tjetër në përputhje me Planine Menaxhimit;si dhe gërma **ç)**struktura në përputhje me përcaktimet ePlanittë Menaxhimit në shërbim të aktiviteteve turistike.
Kërkesat nga AdZM Lezhë
2.Për subjektin: N. C.

Kërkesë e paraqitur me datë 17.09.2018. nga AdZM Lezh, ñPër shqyrtim dhe vlerësim të dokumentacionit të subjektit; **N. C.,** për zhvillimin e veprimtarisë ñveprimtari turistikeò,Instalimin e subjektit me konstruksion druritë çmontueshëm për qellim pushim dhe argëtimi te pushueseve në ZMñPatok Fushë Kuqe ï Ishëmò.

Nga AKZM, është bërë shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesës bazuar në pikën 7 të Urdhrit të Ministrit nr. 129, datë 23.6.2016 ñPër miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje për zonat e mbrojturaò. Si dhe udhëzimit të Ministrit të Mjedisit dhe Turizmit 10.02.2021 ñPër rregullat e përdorimit dhe gëzimit të shërbimeve qe zotëron zona e mbrojtur dhe pagimin e çmimeve për toò.

Nga Drejtoria e Menaxhimitnëpërmjet memos informuese është dhënë informacion mbi lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së ñveprimtari turistikeò, për ngastrën me sipërfaqe 0.550 ha, ñme zoonim të brendshëm Zonë e Zhvillimit të qëndrueshëm. Për lejimin e zhvillimit të kësaj veprimtarie,nga Drejtori i Përgjithshëm është bërë aprovimi nëpërmjet urdhrit nr.1371 datë 13.11.2018 ñPër miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 0.55 ha, në zonë të mbrojtur, Lezhë ò. Është lidhur kontrata nr.146 datë 18.09.2020, nga AdZM Lezhë, me afat 1vjeçare,nga dt. 18.09.2020 deri në datë 17.09.2021, më të drejtërinovimi, me vlerë **288,450 lekë në vit.**

Në memon e paraqitur nga akzm Drejtoria e monitorimit theksohet se subjekti në bashkëpunim me RNM të përcaktojë vendin e grumbullimit të mbetjeve urbane që mundëtë gjëndërohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë dhe mënyrën e largimit tyre nga zona e mbrojtur sipas një grafiku të të miratuar respektivisht nga AdZM Lezhë dhe Bashkia Kurbin .

Në zbatim të pikës 2, të kreut IV të VKM-së nr.382, datë 25.5.2016 ñDisa shtesa në vendimin nr. 102, datë 04.02.2015 ñPër krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojturaò, i ndryshuar. Nga AdZM Lezhëështë lidhur kontrata më subjektin **N. C.** Person Fizik, Nga auditimi i kësaj procedure u konstatua që veprimtaria e kërkuar është në përputhje me neni 33, të ligjit 81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò. Nga auditimi rezultoi që tarifa e vendosur ishte në përputhje me lidhja nr.2, e VKM-së nr. 1064, datë 22.12.2010, ñPër disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò. Pagesa është kryer në përputhje me nenin 5 të kontratës. Kontrata është lidhur me një afat 1 vjeçar,me të drejtë rinovimi.

si dhe në kundërshtim me ñNeni **56 pika3.**Në zonate e mbrojtura mundë të ushtrohet veprimtarivetëm pasi të jetepajisur***më leje mjedisore.***

Kërkesat nga AdZM Lezhë

3.Për subjektin: M.D.

Kërkesë e paraqitur me datë 0.11.2018, nga AdZM Lezhe, ñPër shqyrtim dhe vlerësim të dokumentacionit të subjektit; **M.D.** për zhvillimin e veprimtarisë ñveprimtari turistikeò, Instalimin e subjektit me konstruksion druritë çmontueshëm për qellim pushim dhe argëtimi te pushueseve në ZMñPatok Fushë Kuqe ï Ishëmò.

Nga AKZM, është bërë shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesës bazuar në pikën 7 të Urdhrit të Ministrit nr .129, datë 23.6.2016 ñPër miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje për zonat e mbrojturaò. Si dhe udhëzimit të Ministrit të Mjedisit dhe Turizmit 10.02.2021 ñPër rregullat e përdorimit dhe gëzimit të shërbimeve që zotëron zona e mbrojtur dhe pagimin e çmimeve për toò.

Nga Drejtoria e Menaxhimit nëpërmjet memos informuese është dhënë informacion mbi lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së ñveprimtari turistikeò, për ngastrën 0.1ha,ñme zoonim të brendshëm Zonë e Zhvillimit të qëndrueshëm. Për lejimin e zhvillimit të kësaj veprimtarie, nga Drejtori i Përgjithshëm është bërë aprovimi nëpërmjet urdhrit nr.343 datë 13.11.2018 ñPër miratimin e dhënies në përdorim të

sipërfaqes prej 0.1 ha, në zonë të mbrojtur, Lezhe ò. Është lidhur kontrata nr.153 datë 17.12.2019, nga AdZM Lezhë, me afat 1vjeçare, nga dt. 17.12.2019 deri në datë 16.12.2020, më të drejtë rinovimi, me vlerë ***9,000 lekë*** në vit.

Në germën **e***), subjekti në bashkëpunim me RNM të përcaktojë vendin e grumbullit të mbetjeve urbane që mundë tre gjenerohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë dhe mënyrën e largimit tyre nga zona e mbrojtur sipas një grafiku të të miratuar respektivisht nga AdZM ,Lezhë dhe Bashkia Kurbin.* ***Ky dokument mungon .***

Në zbatim të pikës 2, të kreut IV të VKM-së nr.382, datë 25.5.2016 ñDisa shtesa në vendimin nr. 102, datë 04.02.2015 ñPër krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojturaò, i ndryshuar. Nga AdZM Lezhë është lidhur kontrata nr.204/1,datë 29.12.2020, deri në datën 28.12.2021, me sipërfaqe 0.1hanëpërmjet memos informuese është dhënë informacion mbi lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së ñveprimtari turistikeò, për ngastrën 0.1 ha, ñme zoonim të brendshëm Zonë e Zhvillimit të qëndrueshëm më subjektin **M.D.** Person Fizik, me vlere **9,000 lekë.** Nga auditimi i kësaj procedure u konstatua që veprimtaria e kërkuar është në përputhje me neni 33, të ligjit 81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò. Nga auditimi rezultoi që tarifa e vendosur ishte në përputhje me lidhja nr.2, e VKM-së nr. 1064, datë 22.12.2010, ñPër disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò. Pagesa është kryer në përputhje me nenin 5 të kontratës. Kontrata është lidhur me një afat 1 vjeçar,me të drejtë rinovimi, në vlerë

Kërkesat nga AdZM Lezhë

4.Për subjektin: R.L.

Kërkesë e paraqitur me nr. 137, datë 11.06.2021. nga AdZM Lezhe ,ñPër shqyrtim dhe vlerësim të dokumentacionit të subjektit; R.L. për zhvillimin e veprimtarisë ñveprimtari turistikeò, Instalimin e subjektit me konstruksion druritë çmontueshëm për qellim pushim dhe argëtimi te pushueseve në ZMñPatok Fushë Kuqe ï Ishëmò.

Nga AKZM, është bërë shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesës bazuar në pikën 7 të Urdhrit të Ministrit nr.129, datë 23.6.2016 ñPër miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje për zonat e mbrojturaò. Si dhe udhëzimit të Ministrit të Mjedisit dhe Turizmit 10.02.2021 ñPër rregullat e përdorimit dhe gëzimit të shërbimeve qe zotëron zona e mbrojtur dhe pagimin e çmimeve për toò.

Nga Drejtoria e Menaxhimit në përmjet memos informuese është dhënë informacion mbi lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së ñveprimtari turistikeò, për ngastrën 0.12ha, ñme zoonim të brendshëm Zonë e Zhvillimit të qëndrueshëm. Për lejimin e zhvillimit të kësaj veprimtarie, nga Drejtori i Përgjithshëm është bërë aprovimi nëpërmjet urdhrit nr.132, datë 22.06.2021 ñPër miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 0.12 ha, në zonë të mbrojtur, Lezhe ò. Është lidhur kontrata nr.154 datë 02.07.2021, nga AdZM Lezhë, me afat 1 vjeçare, nga dt. 02.07.2021, deri në datë 01.07.2022, më të drejtë rinovimi , me vlere 60,800 lekë në vit.

Rezulton se :*Në memo drejtorisë së Monitorit AKZM subjekti në bashkëpunim me RNM, të përcaktojë vendin e grumbullit të mbetjeve urbane që mundë të regjenerohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë dhe mënyrën e largimit tyre nga zona e mbrojtur sipas një grafiku të miratuar respektivisht nga AdZM Lezhë dhe Bashkia Kurbin , ky grafik mungon.*

Në zbatim të pikës 2, të kreut IV të VKM-së nr.382, datë 25.5.2016 ñDisa shtesa në vendimin nr. 102, datë 04.02.2015 ñPër krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojturaò, i ndryshuar. Nga

AdZM Lezhë është lidhur kontrata më subjektin R.L.Person Fizik. Nga auditimi i kësaj procedure u konstatua që veprimtaria e kërkuar nuk është në përputhje me neni 33, të ligjit 81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò, ***Konstatim:*****germa a)**çdo veprimtari tjetër në përputhje mePlanine Menaxhimit si dhe gërma **ç)**struktura në përputhje me përcaktimet e Planit të Menaxhimit në shërbim të aktiviteteve turistike.

Kërkesat nga AdZM Lezhë

5.Për subjektin: O.D.

Kërkesë e paraqitur me nr. 46 datë 11.04.2019 nga AdZM Lezhe , ñPër shqyrtim dhe vlerësim të dokumentacionit të subjektit; **O.D.** për zhvillimin e veprimtarisë ñveprimtari turistikeò, Instalimin e subjektit me konstruksion druritë çmontueshëm për qellim pushim dhe argëtimi te pushueseve në ZM ñStomi Ishull-Shëngjinò.

Nga AKZM, është bërë shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesës bazuar në pikën 7 të Urdhrit të Ministrit nr.129, datë 23.6.2016 ñPër miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje për zonat e mbrojturaò. Si dhe udhëzimit të Ministrit të Mjedisit dhe Turizmit 10.02.2021ñPër rregullat e përdorimit dhe gëzimit të shërbimeve që zotëron zona e mbrojtur dhe pagimin e çmimeve për toò.

Nga Drejtoria e Menaxhimitnëpërmjet memos informuese është dhënë informacion mbi lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së ñveprimtari turistikeò, për ngastrën 0.01ha, ñme zoonim të brendshëm Zonë e Zhvillimit të qëndrueshëm. Për lejimin e zhvillimit të kësaj veprimtarie, nga Drejtori i Përgjithshëm është bërë aprovimi nëpërmjet urdhrit nr.120 datë 13.05.2019 ñPër miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 0.01 ha, në zonë të mbrojtur, Lezhë ò. Është lidhur kontrata nr.144 datë 02.12.2019, nga AdZM Lezhë, me afat 1 vjeçare, nga dt. 02.12.2019, deri në datë 02.12.2020, më të drejtë rinovimi , me vlere 50,000 lekë në vit.

Me kontratën nr. 205, datë 29.12.2020, është lidhur kontrata me afat 1 vjeçare nga data 29.12.2020 deri në datë 28.12.2021, sipas përcaktimit të nenit 3 pika 3.2 të kontratës. Me vlerë **50,200** lekë. Nga auditimi i kësaj procedure u konstatua që veprimtaria e kërkuar është në përputhje me neni 33, të ligjit 81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò. Nga auditimi rezultoi që tarifa e vendosur ishte në përputhje me lidhja nr.2, e VKM-së nr. 1064, datë 22.12.2010, ñPër disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò. Pagesa është kryer në përputhje me nenin 5 të kontratës. Kontrata është lidhur me një afat 1 vjeçar, me të drejtë rinovimi.

Në germën **e***), subjekti në bashkëpunim me RNM të përcaktojë vendin e grumbullit të mbetjeve urbane që mundë tre gjëndërohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë dhe mënyrën e largimit tyre nga zona e mbrojtur sipas një grafiku të miratuar respektivisht nga AdZM Lezhë dhe Bashkia Kurbin, ky grafik mungon.*

Në zbatim të pikës 2, të kreut IV të VKM-së nr.382, datë 25.5.2016 ñDisa shtesa në vendimin nr. 102, datë 04.02.2015 ñPër krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojturaò, i ndryshuar. Nga AdZM Lezhë,është lidhur kontrata nr.205 datë 19.12.2020 me subjektin **O.D.** Person Fizik, me afat nga data 29.12.2020 deri në datë 28.12.2021 me vlere 50,000 lekë në vit. Nga auditimi i kësaj procedure u konstatua që veprimtaria e kërkuar është në përputhje me neni 33, të ligjit 81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò. Nga auditimi rezultoi që tarifa e vendosur ishte në përputhje me lidhja nr.2, e VKM-së nr. 1064, datë 22.12.2010, ñPër disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò. Pagesa është

kryer në përputhje me nenin 5 të kontratës. Kontrata është lidhur me një afat 1 vjeçar, me të drejtë rinovimi.

Kërkesat nga AdZM Lezhë

6.Për subjektin: L.

Kërkesë e paraqitur me nr. 147 datë 11.04.2019 nga AdZM Lezhe, ñPër shqyrtim dhe vlerësim të dokumentacionit të subjektit; **Gj.M.,** për zhvillimin e veprimtarisë ñveprimtari turistikeò, Instalimin e subjektit me konstruksion druritë çmontueshëm për qellim pushim dhe argëtimi te pushueseve në ZMñPatok Fushe Ishëm ò.

Nga AKZM, është bërë shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesës bazuar në pikën 7 të Urdhrit të Ministrit nr 129, datë 23.6.2016 ñPër miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje për zonat e mbrojturaò. Si dhe udhëzimit të Ministrit të Mjedisit dhe Turizmit 10.02.2021 ñPër rregullat e përdorimit dhe gëzimit të shërbimeve qe zotëron zona e mbrojtur dhe pagimin e çmimeve për toò.

Nga Drejtoria e Menaxhimitnëpërmjet memos informuese është dhënë informacion mbi lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së ñveprimtari turistikeò, për ngastrën 1 ha, ñme zoonim të brendshëm Zonë e Zhvillimit të qëndrueshëm. Për lejimin e zhvillimit të kësaj veprimtarie,nga Drejtori i Përgjithshëm është bërë aprovimi nëpërmjet urdhrit nr.1425 datë 30.06.2016ñPër miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 0.01 ha, në zonë të mbrojtur, Lezhëò. Është lidhur kontrata nr.154 datë 04.11.2016, nga AdZM Lezhë, me afat 5vjecarë, nga dt. 04.11.2016, deri në datë 04.11.2021, më të drejtërinovimi , me vlere **52,000 lekë,** në vit.Nga auditimi i kësaj procedure u konstatua që veprimtaria e kërkuar është në përputhje me neni 33, të ligjit 81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò. Nga auditimi rezultoi që tarifa e vendosur ishte në përputhje me lidhja nr.2, e VKM-së nr. 1064, datë 22.12.2010, ñPër disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò. Pagesa është kryer në përputhje me nenin 5 të kontratës. Kontrata është lidhur me një afat 1 vjeçar,me të drejtë rinovimi. Janë paguar për 4vite**(4 *52,000=208,000) lekë .**

Bashkëlidhur praktikës QKB mandat pagesat për 5 vitet.

Në germën **e***), subjekti në bashkëpunim me RNM të përcaktojë vendin e grumbullit të mbetjeve urbane që mundë të gjen erohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë dhe mënyrën e largimit tyre nga zona e mbrojtur sipas një grafiku të miratuar respektivisht nga AdZM Lezhë dhe Bashkia Kurbin, ky grafik mungon.*

Kërkesat nga AdZM Lezhë

7 .Për subjektin: S.V.

Kërkesë e paraqitur me nr. 32 datë 27.12.2019 nga AdZM Lezhe, ñPër shqyrtim dhe vlerësim të dokumentacionit të subjektit; **S.V.,** për zhvillimin e veprimtarisë ñveprimtari turistikeò, Instalimin e subjektit me konstruksion druritë çmontueshëm për qellim pushim dhe argëtimi te pushueseve në ZMñPatok ï Fushe- Ishëmò.

Nga AKZM, është bërë shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesës bazuar në pikën 7 të Urdhrit të Ministrit nr .129, datë 23.6.2016 ñPër miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje për zonat e mbrojturaò. Si dhe udhëzimit të Ministrit të Mjedisit dhe Turizmit 10.02.2021 ñPër rregullat e përdorimit dhe gëzimit të shërbimeve qe zotëron zona e mbrojtur dhe pagimin e çmimeve për toò.

Nga Drejtoria e Menaxhimit nëpërmjet memos informuese është dhënë informacion mbi lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së ñveprimtari turistikeò,për ngastrën 0.42ha, ñme zoonim të brendshëm Zonë e Zhvillimit të qëndrueshëm. Për lejimin e zhvillimit të kësaj veprimtarie,nga Drejtori i Përgjithshëm është bërë aprovimi nëpërmjet urdhrit nr.230 datë 28.12.2020 ñPër miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 0.42 ha, në zonë të mbrojtur, Lezhëò. Është lidhur kontrata nr.1, datë 08.01.2021, nga

AdZM Lezhë, me afat 1vjecar, nga dt.08.01.2021,deri në datë 07.01.2022, më të drejtë rinovimi, me vlere 88,075 lekë në vit. Nga auditimi i kësaj procedure u konstatua që veprimtaria e kërkuar është në përputhje me neni 33, të ligjit 81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò. Nga auditimi rezultoi që tarifa e vendosur ishte në përputhje me lidhja nr.2, e VKM-së nr. 1064, datë 22.12.2010, ñPër disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò. Pagesa është kryer në përputhje me nenin 5 të kontratës. Kontrata është lidhur me një afat 1 vjecar, me të drejtë rinovimi.

Bashkëlidhur QKR mandat pagesa plan rilevimit ,projekt zbatimi plan i biznesit raporti teknik

Konstatim: Në germën **e***), subjekti në bashkëpunim me RNM të përcaktojë vendin e grumbullit të mbetjeve urbane që mundë të gjen erohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë dhe mënyrën e largimit tyre nga zona e mbrojtur sipas një grafiku të miratuar respektivisht nga AdZM Lezhë dhe Bashkia Kurbin , ky grafik mungon.*

Kërkesat nga AdZM Lezhë

8 .Për subjektin: M. M.

Kërkesë e paraqitur me nr. 16, datë 20.02.2017 nga AdZM Lezhe, ñPër shqyrtim dhe vlerësim të dokumentacionit të subjektit; **M. M.** për zhvillimin e veprimtarisë ñveprimtari turistikeò, Instalimin e subjektit me konstruksion druritë çmontueshëm për qellim pushim dhe argëtimi te pushueseve në ZM ñPatokï Fushe- Kuqe Kurbin ò.

Nga AKZM, është bërë shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesës bazuar në pikën 7 të Urdhrit të Ministrit nr. 129, datë 23.6.2016 ñPër miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje për zonat e mbrojturaò. Si dhe udhëzimit të Ministrit të Mjedisit dhe Turizmit 10.02.2021 ñPër rregullat e përdorimit dhe gëzimit të shërbimeve që zotëron zona e mbrojtur dhe pagimin e çmimeve për toò.

Nga Drejtoria e Menaxhimit nëpërmjet memos informuese është dhënë informacion mbi lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së ñveprimtari turistikeò, për ngastrën 0.2 ha, ñme zoonim të brendshëm Zonë e Zhvillimit të qëndrueshëm. Për lejimin e zhvillimit të kësaj veprimtarie,nga Drejtori i Përgjithshëm është bërë aprovimi nëpërmjet urdhrit nr.185 datë 16.02.2017ñPër miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 0. 2 ha, në zonë të mbrojtur, Lezhëò. Është lidhur kontrata nr.50 datë 22.02.2017, nga AdZM Lezhë, me afat 5 vjeçare, nga dat 22.02.2017, deri në datë 22.02.2021, me vlere 10,400 lekë në vit. Nga auditimi i kësaj procedure u konstatua që veprimtaria e kërkuar është në përputhje me neni 33, të ligjit 81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò. Nga auditimi rezultoi që tarifa e vendosur ishte në përputhje me lidhja nr.2, e VKM-së nr. 1064, datë 22.12.2010, ñPër disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò. Pagesa është kryer në përputhje me nenin 5 të kontratës. Kontrata është lidhur me një afat 5 vjecar,me të drejtë rinovimi. E likujduar sipas viteve.

Bashkëlidhur qkrmandat pagesaplan rilevimit ,projekt zbatimi plan i biznesit ,Raporti teknik si dhe plan rilevimin nga zyra e regjistrimit.

Në germën **e***), subjekti në bashkëpunim me RNM të përcaktojë vendin e grumbullit të mbetjeve urbane që mundë te gjen erohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë dhe mënyrën e largimit tyre nga zona e mbrojtur sipas një grafiku të miratuar respektivisht nga AdZM Lezhë dhe Bashkia Kurbin, ky grafik mungon.*

Tabela nr .1

Në lekë

Nr	Vitet	Kontrata sipas viteve	Sipërfaqja në (ha)	Vlera e qerasë ne vite (lekë)
1	2019	5	0.73	386,100

2	2020	5	0.65	363,250
3	2021	4	0.54	157,275
	Total	14	3.02	915,625

Burimi AdZM
Siperfaqja pej 3.02 ha, paraqitetsiperfaqe në vazhdimësi të kontratave 5 vjecare.

Duke bërë krahasimin ndërmjet dy viteve, vërejmë se numri i kontratave të qirasë për dhënie në përdorim të sipërfaqes zonë e mbrojtur është pothuaj i njëjtë. Kështu në vitin 2019 numri i kontratave është 5 në vlerë 386,100 lekëdhe në vitin 2020nr. kontratave 5 nëvlerë 363,250 lekë dhe në Viti 2021 janë lidhur 4 kontrata në vlerë 157,275 lekë. Vlera në total për tre vite periudhe 915,2 lekë.

Nga auditimi u evidentua ***që 8 subjekte*** me aktivitete të montueshëm, kontrata e të cilëve ishte në vazhdim rezultojnë të jenë kryer pagesat sipas pikës se kontratësevidentuar kjo si në tabelën më mësipërme.

Çdo kontrate bashkëlidhur gjendej:
-Kërkesa nga personi fizik
-Kërkesa nga AdZM Lezhë drejtuar AKZM
-Memo nga Drejtoriae monitorimit AKZM
-Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm për dhënë e lejes për lidhje kontratë
-Raport teknik të përgatitur nga specialistet e AdZM-së .N.P.,A.H.,P. N. dhe P. J.
-Plan Biznesi si dhe mandat pages

Tabela me subjekte që kanë lidhur kontrata nga AdZM

Nr.Ren	Emertimi I subjektit	Miratuar nga AKZM-jaNr.data.viti	Zona e Mbrojtur	N/Ngast	Afati	Sip.e dhene (Ha)	Qellimi I Perdorimit	Data e lidhjes se kontrates
1	L. N.	Urdher nr.1425 date 31/10/2016	Patok-Fushe Kuqe-Ishem	6/b	5	1 ha	Njësi portative qellime turiste	04/11/2016
2	M. M.	Urdher nr.185 date 16/02/2017	Patok-Fushe Kuqe-Ishem	10	1	0.2	Njësi portative qellime turiste	22/02/2017
3	O.D.	Urdher nr.120 date 13/05/2019	Kune	12/a	1	0.01	Njësi portative qellime turiste	02,12,2019
4	A.L.	Urdher nr.151 date 21/06/2017	Vain	16	1	0.63	Njësi portative qellime turiste	04/07/2017
5	M. D.	Urdher nr.343 date 13,11,2018	Patok-Fushe Kuqe-Ishem		1	0.1	Njësi portative qellime turiste	17,12,2018
6	N. C.	Urdher Nr 344 date 13,11,2018	Patok-Fushe Kuqe-Ishem		1	0.55	Njësi portative qellime turiste	18,09,2020
7	S.V.	Urdher Nr 230 date 28,12,2020	Patok-Fushe Kuqe-Ishem		1	0.42	Njësi portative qellime turiste	08,01,2021
8	R. L.	Urdher Nr 130 date 22,06,2021	Patok-Fushe Kuqe-Ishem		1	0.12	Njësi portative qellime turiste	02,07,2021

Konkluzion: Nga auditimi i mësipërm për tetë kontratat rezultoi se në tre raste-nuk janë zbatuar kushtet e vendosura nga Drejtoria e Monitorimit si: *vendin e grumbullit të mbetjeve urbane që mund të gjenerohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë dhe mënyrën e largimit tyre nga zona e mbrojtur sipas një grafiku të miratuar respektivisht nga AdZM Lezhë dhe Bashkia Kurbin, ky grafik mungonte bashkëlidhur.*

-Në një rast kontrata është lidhur pa aplikimin e lejes mjedisorë jo në përputhje me neni 33, germa a) të ligjit 81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò.

Në vitin 2021 janë lidhur 4 kontrata të cilat janë në vazhdim nga vitet e mëparshme por nuk kanë plan menaxhimi sipas përcaktimeve në ligj, nga Ministria e Mjedisit dhe Kulturës nuk janë hartuar plane menaxhimi edhe pse AdZM, ka venë ne dijeni ministrinë.

II.Për periudhën objekt auditimi nuk janë lidhur kontrata,nga fondi i kullotave në zonat e mbrojtura.

III .Të ardhurat e arkëtuara nga hyrja e vizitorëve në Kune Vain Lezhë.

- Për periudhën objekt auditimi u evidentuan të ardhurat e krijuara nga hyrja e vizitorëve dhe automjeteve në postbllokun në Kune Vain Lezhë. Në vitin 2020, nëpërmjet investimit të kryer nga AKZM këta postblloqe janë bërë me kalim elektronik. Në vitin 2020 u evidentuan një rënie e nivelit të arkëtimeve, kjo për pasojë të Covid-19.

Niveli i të ardhurave të arkëtuara paraqitet në tabelën vijon: Në /lekë

Vitet	Totali i Të ardhurave	Kune -Vain
2019	98,700	98,700
2020	162,150	162,150
2021	429,000	429,000
Total	689,850	689,850

Vlera prej **689,850** lekë është arkëtuar gjate tre viteve e cila, për 2 vitet e parë është derdhur në llogari të Ministrisë së Mjedisit dhe Kulturës. Ndërsa në vitin 2021 sipas ndryshimeve ligjore, të ardhurat derdhën në llogari të AKZM.

-Përveç kontratave të lidhura dhe traut, të vënë për hyrjen e vizitoreve në Kune ï Vain, brenda zonave të mbrojtura ushtrojnëaktivitet ekonomikoï financiare dhe subjekte të tjera të cilat, janë në pronën e tyre private dhe kanë detyrim sipas nenit nr. 36 i ligjit nr 81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò, vetëm marrje mendimi për ushtrimin e këtyre aktiviteteve.

Nga kjo rezultoi se:

-Në zonat e mbrojtura ushtrojnë aktivitet individ privat banorë të zonës si dhe një numër i konsiderueshëm biznesesh,që shfrytëzojnë këto burimenatyrore fitimprurëse. Nga AdZM ka një evidentim dhe regjistrim të subjekteve të biznesit të cilat kryejnë veprimtari të ndryshme me karakter ekonomik dhe social si bujqësia tradicionale, agro-pylltaria dhe të gjitha aktivitetet artizanale, kulturore, sportive dhe shërbimet turistike. Nuk ka të dhëna për to në lidhje me aktivitetet e tyre (licencimi, koha e ushtrimit të aktivitetin, lejet mjedisore, territoret apo dhe veprimtaritë e të cilëve përfshihen në zonën e mbrojtur ose në atë buferike në kundërshtim me nenin 9 pika 5 të ligjit nr. 8906, date 6.6.2002 ñPër Zonat e Mbrojtura ñi ndryshuar . Nga Qeveria Qendrore dhe Pushteti Vendor nuk është zgjidhur problem i taksimit specifik tëpersonave fizik dhe juridik që shfrytëzojnë vlerat natyrore, historike dhe kulturore të zonave të mbrojtura, nëpërmjet përfshirjes së tyre në paketat fiskale.

-Nga auditimi i të ardhurave rezultoi se ZM Lezhë, kanëvetëmnjë pikë kontrolli për hyrjen e vizitoreve Kune-Vain,nuk ka pika tjerakontrolli nëzonat hyrëse të zonave të mbrojturadhe si rezultat i kësaj dhe të ardhura nuk janë në nivelet të larta. Si rezultat I kësaj, u konstatua se:

Në zonat e mbrojtura Lezhe , flora dhe fauna është e kërcënuar për vete faktin se brenda zonave të mbrojtura jetojnë një numër i lartë banorësh, që me aktivitetin e tyre po cenojnë këto vlera si dhe po dëmtojnë biodiversitetin. Ka tendenca të njerëzve për gjueti te paligjshme, prerje të paligjshme apo aktivitete që bien ndesh me planet apo draft-planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura.

Rekomandimi: AdZM në bashkëpunim me AKM, ku njëra monitoron dhe konstaton dhe tjetra procedon, për çdo kontroll të kryer në terren të merren masa që rastet e flagrancës të dokumentohen e ndëshkohen rastet e kundra vajtjeve administrative dhe shkeljeve ligjore.

-*Kontributi i AdZM për vjeljen e të ardhurave* nëpërmjet tarifave si një prioritet i punës së saj është në vlera minimale. Pasi nuk ka një kontroll në pikat tjera hyrëse të zonave të mbrojtura. Ndërsa Janë lidhur *14 kontrat a*të përkohshme, nga 8 subjekte me afat 1 vjeçare me të drejtë përsëritje. Ndërsa, nga Ministria e linjës dhe AKZM, janë miratuar tarifat për vjeljen e të ardhurave për vizitorët në pikat turistike, por nuk ka posto blloqe për të mbledhur të ardhurat nëçdo pike hyrje, për vizitorët që hyjnë në pikathistorike dhe kombëtare, të ardhura këto që do të përdoreshin për mirë administrimin e tyre. Gjithashtu, ka munguar infrastruktura për ngritjen e pikave të kalimit të vizitorëve, pasi ka disa rrugë hyrëse të pakontrollueshme në një pikë turistike. Nga Ministra e Turizmit dhe Mjedisit, megjithëse e ka patur detyrim ligjor, nuk e ka zgjidhur problemin e vendosjes së infrastrukturës së nevojshme dhe gjetjen e rrugëve dhe mjeteve për rritjen e të ardhurave. Mos marrja e masave nga institucionet që menaxhojnë Zonat e Mbrojtura, janë në kundërshtim me VKM nr.102 datë 04.02.2015 ñPër krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojturaò, Kreu III, pika 2, me ligjin nr. 81/2017 datë 04.05.2017, neni 17, pika 4, ku përcaktohet*"Në përputhje me shkallën e mbrojtjes së monumentit dhe me potencialet turistike e rekreacionin e zonës, ministri miraton me urdhër e rregulla të veçanta për vizitat ose kalimin e vizitorëve a të turistëve për afate të shkurtra kohore" dhe neni 57* ñBurimet e financimit dhe administrimiò, pika 4, ku citohet: ñ*Me propozim të AKZM-së, ministri miraton udhëzimin për rregullat e përdorimit e të gëzimit të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore dhe për pagimin e çmimeve për to".*

Rekomandim: AdZM Lezhë në bashkëpunim me AKZM Tiranë të kërkojë pranë Ministrisë së linjës për përcaktimin e vendosjen e pikave të kalimit në pjesët turistike të Zonave të mbrojtura, si dhe të japë kontributin e saj në hartimin e projekt-drafteve për miratimin e tarifave vizitore që do të përdoren për vjeljen e të ardhurave nga turistët vizitorë të ZM.

1.Titulli gjetjes: Hartimi i kontratave me të tretët.

Në tre raste nuk ishte të përcaktuar në kontratë*vendgrumbullimi të mbetjeve urbane që mundë të gjenerohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë dhe mënyrën e largimit tyre nga zona e mbrojtur sipas një grafiku të miratuar respektivisht nga AdZM Lezhë dhe Bashkia përkatëse.*

-Në vitin 2021 janë lidhur 4 kontrata të cilat janë në vazhdim nga vitet e mëparshme por nuk kanë plan menaxhimi sipas përcaktimeve në ligj, nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit nukjanëhartuar plane menaxhimi edhe pse AdZM, ka venë ne dijeni ministrinë.

Situata:Në AdZM Lezhë, nuk janë hartuar plane Menaxhimi nga Ministriae Mjedisit dhe Turizmit.

Kriteri: Ligjin nr. 81/2017 datë 04.05.2017, ñPër zonat e Mbrojturaò.

Ndikimi/Efekti: Menaxhimi i zonave të mbrojtura.

Shkaku: Mos hartim i planit të menaxhimit nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit.

Rekomandimi: AdZM Lezhë në bashkëpunim me AKZM Tiranë të kërkojë pranë Ministrisë së Linjës për përcaktimin e vendosjen e pikave të kalimit në pjesët turistike të Zonave të mbrojtura, si dhe të japë kontributin e saj në hartimin e projekt-drafteve për miratimin e tarifave vizitore që do të përdoren për vjeljen e të ardhurave nga turistët vizitorë të ZM.

Afati:Në vazhdimësi

2.Titulli gjetjes:Në zonat e mbrojtura ushtrojnë aktivitet individ privat banorë të zonës si dhe një numër i konsiderueshëm biznesesh,që shfrytëzojnë këto burimenatyrore fitimprurëse.

Situata: Nga AdZM ka një evidentim dhe regjistrim të subjekteve të biznesit të cilat kryejnë veprimtari të ndryshme me karakter ekonomik dhe social si bujqësia tradicionale, agro-pylltaria dhe të gjitha aktivitetet artizanale, kulturore, sportive dhe shërbimet turistike. Nuk ka të dhëna për to në lidhje me

aktivitetet e tyre (licencimi, koha e ushtrimit të aktivitetin, lejet mjedisore, territoret apo dhe veprimtaritë e të cilëve përfshihen në zonën e mbrojtur ose në atë buferike.Nga Qeveria Qendrore dhe Pushteti Vendor nuk është zgjidhur problem i taksimit specifik tëpersonave fizik dhe juridik që shfrytëzojnë vlerat natyrore, historike dhe kulturore të zonave të mbrojtura, nëpërmjet përfshirjes së tyre në paketat fiskale.

Kriteri:Në kundërshtim me nenin 56të ligjit nr. 81/2017 ñPër Zonat e Mbrojturaò.

Ndikimi/Efekti: Mos arkëtim i të ardhurave.

Shkaku: Mos hartim i planit të menaxhimit nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit.

Rëndësia:E Ulët

Rekomandimi: AdZM Lezhë të marrë masa që në çdo raste tëketë informacionin e duhur nëpërmes monitorimeve për aktivitete që kryhen brenda zonës së mbrojtur.

Afati: Në vazhdimësi

Pika 2.Mbi administrimin e pronës shtetërore. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin ruajtjen,dokumentimin edhe qarkullimin e vlerave materialedhe përdorimin e karburantit".

-Mbi shpenzimet e kryera për harxhimin e karburantit.

Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë, për shpenzimet e kryera në lidhje me karburantin, mjetet në dispozicion, pagat, etj, është në varësi të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe çdo parashikim/shpenzim është i miratuar nga Agjencia.

Për shpenzimet e kryera dhe sasinë e karburantit të harxhuar nga Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhra inspektimi

-Fletë udhëtimet

-Normat e konsumit të karburantit sipas mjeteve

-Urdhra udhëtimi dhe autorizime.

-Urdhrat e punës për kryerjen e monitorimeve.

-Dokumentacioni justifikues i lëvizjeve të kryera, etj

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë, për periudhën objekt auditimi ka në dispozicion 4 motoçikleta, 1 motobarkë dhe 2 makina.

U auditua dokumentacioni i shpenzimeve të karburantit për secilin mjet në përdorim për periudhën 2019-2021, i paraqitur si më poshtë:

Muaji	Mjetet	Vitet 2019				Vitet 2020				Vitet 2021			
		Tërheq Naftë	Harxhuar Naftë	Tërheq Benzinë	Harxhuar Benzinë	Tërheq Naftë	Harxhuar Naftë	Tërheq Benzinë	Harxhuar Benzinë	Tërheq Naftë	Harxhuar Naftë	Tërheq Benzinë	Harxhuar Benzinë
I	Makina	250	257			250	257			200	206		
	Motobarka			70	70			120	120			120	120
	Motoçikleta AV862			20	20			20	22			15	16
	Motoçikleta AV863			4	4			20	20			15	17
	Motoçikleta AV864			10	11			20	22			15	16
	Motoçikleta AV865			20	21			20	20			15	17
	Motoçikleta AP 928												
II	Makina	250	266			250	257			300	307		

	Motobarka			120	120			120	120			120	120
	Motorcikleta AV862			30	32			20	20			15	16
	Motorcikleta AV863			30	32			20	20			15	17
	Motorcikleta AV864			30	32			20	20			15	16
	Motorcikleta AV865			30	32			20	21			15	17
	Motorcikleta AP 928												
III	Makina	250	260			250	255			250	260		
	Motobarka			120	120			120	120			120	120
	Motoçikleta AV862			30	32			20	20			15	16
	Motoçikleta AV863			30	32			20	20			15	17
	Motoçikleta AV864			30	32			20	20			15	16
	Motoçikleta AV865			30	32			20	21			15	17
	Motoçikleta AP 928												
IV	Makina	250	256			200	204			250	253		
	Motobarka			120	120			120	120			120	120
	Motoçikleta AV862			30	30			15	16			15	16
	Motoçikleta AV863			30	30			15	17			15	17
	Motoçikleta AV864			30	30			15	16			15	16
	Motoçikleta AV865			30	30			15	17			15	17
	Motoçikleta AP 928												
V	Makina	250	252			210	215			250	267		
	Motobarka			120	120			120	120			120	120
	Motoçikleta AV862			30	30			15	16			15	19
	Motoçikleta AV863			30	30			15	17			15	19
	Motoçikleta AV864			30	30			15	16			15	19
	Motoçikleta AV865			30	30			15	17			15	19
	Motoçikleta AP 928												
VI	Makina	250	255			280	281			250	256		
	Motobarka			120	120			120	120			520	525
	Motoçikleta AV862			30	30			15	16			15	19
	Motoçikleta AV863			30	30			15	17			15	19
	Motoçikleta AV864			30	30			15	16			15	19
	Motoçikleta AV865			30	30			15	17			15	19
	Motoçikleta AP 928											15	19
VII	Makina	250	268			250	256			250	260		
	Motobarka			120	120			120	120			500	504
	Motoçikleta AV862			30	30			15	17			15	16
	Motoçikleta AV863			30	30			15	17			15	19

	Motoçikleta AV864			30	30			15	17			15	16
	Motoçikleta AV865			30	30			15	17			15	19
	Motoçikleta AP 928											15	19
VIII	Makina	250	259			200	219			250	269		
	Motobarka			120	120			120	120			500	504
	Motoçikleta AV862			30	30			15	16			20	20
	Motoçikleta AV863			30	30			15	16			20	20
	Motoçikleta AV864			30	30			15	16			20	20
	Motoçikleta AV865			30	30			15	16			20	20
	Motoçikleta AP 928											20	20
IX	Makina	250	253			200	209			250	254		
	Motobarka			120	120			120	120			400	399
	Motoçikleta AV862			30	30			15	15			20	23
	Motoçikleta AV863			30	30			15	16			20	20
	Motoçikleta AV864			30	30			15	15			20	23
	Motoçikleta AV865			30	30			15	16			20	20
	Motoçikleta AP 928											20	23
X	Makina	250	252			250	267			150	160		
	Makina AA770OM									100	104		
	Motobarka			120	120			120	120			200	204
	Motoçikleta AV862			30	30			15	15			20	23
	Motoçikleta AV863			30	30			15	16			20	20
	Motoçikleta AV864			30	30			15	15			20	23
	Motoçikleta AV865			30	30			15	16			20	20
	Motoçikleta AP 928											20	23
XI	Makina	250	252			250	266			180	210		
	Makina AA770OM									70	78		
	Motobarka			120	120			120	120			120	132
	Motoçikleta AV862			20	20			15	16			20	21
	Motoçikleta AV863			20	20			15	15			20	20
	Motoçikleta AV864			20	20			15	16			20	21
	Motoçikleta AV865			20	20			15	15			20	20
	Motoçikleta AP 928											20	21
XII	Makina	300	306			200	200			200	222		
	Makina AA770OM									50	66		
	Motobarka			120	120			120	120			120	120
	Motoçikleta AV862			20	20			20	21			20	21
	Motoçikleta			20	20			20	20			20	20

	AV863												
	Motoçikleta AV864			20	20			20	21			20	21
	Motoçikleta AV865			20	20			20	20			20	20
	Motoçikleta AP 928											20	21
TOTALI		**3050**	**3136**	**2684**	**2702**	**2790**	**2886**	**2240**	**2284**	**3000**	**3172**	**3910**	**4036**

Për vitin 2019,janë harxhuar 3136 litra naftë nga 3050 litra të tërhequra, ose ***+86 litra*** dhe 2702 litra benzinë nga 2684 litra të tërhequra, ose ***+18 litra***.
Për vitin 2020,janë harxhuar 2886 litra naftë nga 2790 litra të tërhequra, ose ***+96 litra*** dhe 2284 litra benzinë nga 2240 litra të tërhequra, ose ***+44 litra***.
Për vitin 2021,janë harxhuar 3172 litra naftë nga 3000 litra të tërhequra, ose ***+172litra*** dhe 4036 litra benzinë nga 3910 litra të tërhequra, ose ***+126 litra***.
Referuar dokumentacionit të mbajtur për harxhimin e karburantit konstatohet rritje nga viti në vit si për naftën ashtu edhe për benzinën.
Po kështu, për të 3 vitet objekt auditimi konstatohet se administrata ka plotësuar dokumentacionin i cili pasqyron harxhim të karburantit në sasi më tepër nga ajo që është tërhequr nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe është venë në dispozicion të këtij subjekti, fakt i cili flet se dokumentacioni nuk pasqyron realitetin.
Dokumentet justifikues përbëhen nga: autorizimet e Titullarit për punonjësin, i cili do të përdorë automjetin e përcaktuar të institucionit për periudha të përcaktuara me data dhe Urdhrat e Titullarit për inspektim.
Për shërbimet e kryera në zona të përcaktuara në urdhrat përkatës sipas datave janë identifikuar dhe përshkruar në raportet e shërbimit të mbajtura nga grupi i kontrollit të autorizuar. Në fund të muajit është hartuar dokumentacioni i udhëtimit, i cili përmban datat e lëvizjeve, leximi i fillimit të km, vend-nisja, vend-mbërritja, leximi i fundit të km lëvizjes së mjetit, distanca në km, sasia në litra e karburantit të përllogaritur, nënshkrimi i grupit udhëtues. Bashkëlidhur dokumentacionit të udhëtimit mujor janë edhe kuponët tatimorë të sasisë së karburantit të furnizuar dhe shpenzuar, ku në fakt furnizimi realizohej me karta.
Nga auditimi i këtij dokumentacioni për secilin automjet dhe për çdo muaj rezulton se në disa raste sasia e furnizuar nuk përputhej me sasinë e harxhuar, por ishte më e lartë sasia e harxhuar me sasinë e dokumentuar në dokumentet autorizues, financiar dhe mbështetës të bashkëlidhur praktikave të konsumit të karburantit.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar, **"Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve"** pikat 34, ku citohet se: *"Veprimet ekonomike që kryhen në njësite publike si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi"*,
35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a. Dokumente autorizues - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.
b. Dokumente vërtetues - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe te tjera akte me natyre verifikues shpenzimi. c. Dokumente të kontabilitetit - janë dokumentet përmbledhës ose regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitike, kartelat e aktiveve, etj) të çdo lloj forme bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
36. Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve.
Konkluzioni:Përdorimi i mjeteve dhe sasia e konsumit të karburantit flasin për plotësim të dokumentacionit thjesht për justifikim të shpenzimeve për karburant dhe janë pranuar nga Drejtoria e Financës dheShërbimeve pa asnjë argumentim.
Plotësimi dhe nënshkrimi i dokumentacionit justifikues, si urdhër shërbime, fletë udhëtimi, përmbledhëse e harxhimit të karburantit janë nënshkruar nga personat përgjegjës.
Konstatohet harxhim karburanti më i lartë në vitet 2020 dhe 2021.
Për veprimet e mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi.Pjetër Toni, në cilësinë e titullarit të institucionit dhe z. Kreshnik Toni, me detyrë përgjegjës i menaxhimit dhe monitorimit.
3.Titulli i Gjetjes: Mangësi në dokumentacionin e shpenzimeve për karburant.
Situata:-Referuar dokumentacionit të mbajtur për harxhimin e karburantit konstatohet rritje nga viti në vit si për naftën ashtu edhe për benzinën. -Referuar dokumentacionit të mbajtur për harxhimin e karburantit konstatohet rritje nga viti në vit si për naftën ashtu edhe për benzinën.
-Po kështu, për të 3 vitet objekt auditimi konstatohet se administrata ka plotësuar dokumentacionin i cili pasqyron harxhim të karburantit në sasi më tepër (354 litra naftë dhe 188 litra benzinë) nga sasiae tërhequr nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe është venë në dispozicion të këtij subjekti, fakt i cili flet se dokumentacioni nuk pasqyron realitetin.
-Përdorimi i mjeteve dhe sasia e konsumit të karburantit flasin për plotësim të dokumentacionit thjesht për justifikim të shpenzimeve për karburant dhe janë pranuar nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve pa asnjë argumentim.
Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar, pika 34,35,36.
Ndikimi: Moskryerje e objektivave
Shkaku: Mos programim i saktë i nevojave
Rëndësia: E mesme
-Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me
Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë, të marrin masa për planifikimin e shpenzimeve të karburantit referuar volumit të punës, nevojave reale dhe normativave të harxhimit për çdo mjet me

qëllim realizimin e objektivave dhe përdorimin me efektivitet të aktiveve.
-Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me
Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë, të analizojnë trendin në rritje të konsumit të karburantit duke e ballafaquar me volumin e punës, inspektimet, etj, të kryera nga AdZM duke e argumentuar rritjen e shpenzimeve me qëllim përdorimin me efektivitet dhe mundësimin e kryerjes së punës brenda limiteve ligjore të miratuara.
Rekomandimi:-Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me
Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë, të marrin masa për planifikimin e shpenzimeve të karburantit referuar volumit të punës, nevojave reale dhe normativave të harxhimit për çdo mjet me qëllim realizimin e objektivave dhe përdorimin me efektivitet të aktiveve.
-Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me
Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë, të analizojnë trendin në rritje të konsumit të karburantit duke e ballafaquar me volumin e punës, inspektimet, etj, të kryera nga AdZM duke e argumentuar rritjen e shpenzimeve me qëllim përdorimin me efektivitet dhe mundësimin e kryerjes së punës brenda limiteve ligjore të miratuara.

Pika 2.1-Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave.

Me Urdhrin e brendshëm të Titullarit nr. 15, datë 20.01.2020, të AKZM ñPër kryerjen e inventarit të aktiveve në përdorim dhe administrim nga punonjësit e AdZMò janë ngritur komisionet për inventarizimin e aktiveve në AdZM në Qarqe.
Me Urdhrin e brendshëm të Titullarit nr. 23, datë 21.01.2021, të protokolluar në AKZM me nr.prot 19.02.2021 ñPër kryerjen e inventarit të aktiveve në përdorim dhe administrim nga punonjësit e AdZMò janë ngritur komisionet për inventarizimin e aktiveve në AdZM në Qarqe.
Bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, komisioni i inventarizimit ka hartuar kartelat personale me aktivet në ngarkim, si pajisje zyre dhe automjetet në ngarkim të secilit punonjës.
Fletët e inventarit janë të firmosura nga komisioni dhe sipas të dhënave të tyre nuk kanë rezultuar diferenca.
Për periudhën objekt auditimi janë kryer inventarët e viteve 2019 dhe 2020, por ende nuk është kryer inventari i vitit 2021, për këtë në AdZM nuk ka ardhur urdhër për kryerjen e inventarit të vitit 2021 nga AKZM.
Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12. 2011ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, Kreu IV ñSistemi i kontrollit periodik të aktiveveò pikat 73,74 ku citohet se ñ*Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimittëaktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjesfiziketëaktivevenë një kohë të caktuar, si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efiçiencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe me urdhër/udhëzim të miratuar nga titullari i njësisë publike"*dhe ñ*Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin aktiveve afatgjata materiale dhe jo materialë, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhetëdrejtave,nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionitmbështetës".*
4.Titulli i Gjetjes: Mos kryerja e inventarëve të vitit 2021.

Situata: Për periudhën objekt auditimi janë kryer inventarët e viteve 2019 dhe 2020, por ende nuk është kryer inventari i vitit 2021, për këtë në AdZM nuk ka ardhur urdhër për kryerjen e inventarit të vitit 2021 nga AKZM.

Kriteri: Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò. Pasaktësi në pasqyrat financiare

Ndikimi/efekti: Pasaktësi në pasqyrat financiare

Shkaku: Mos zbatim i legjislacionit.

Rendësia:E mesme

Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë të marrë masa për kryerjen e inventarëve brenda afateve të përcaktuara në respektim të kritereve dhe kërkesave ligjore, me qëllim kontrollin e menaxhimin e aktiveve të njësisë, për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të tyre dhe pasqyrimin e drejtë të gjendjes në pasqyrat financiare brenda afateve ligjore.

<u>Pika.3.</u> Auditimi mbi zbatimin e lidhshmërisë në monitorimin e mjedisit.*Mbi zbatimin e procedurave,vlersimin periodik të situatave mjedisore,auditimi i evidentimit tërelacioneve dhe të subjekteve të (peshkimit)zbatimit tëprocedurave të monitorimit të mjedisit në zona të mbrojturasi dhe ruajtja e monumenteve të natyrës.*

Lidhur me këtë çështje të programit u ushtrua auditim në Administratën rajonale e zonave të mbrojtura Lezhë , në zbatim të pikës 4 tëprogramit të auditimit të miratuar nga kryetari i KLSH ï së, menr . 1275/1 prot., datë 26.11. 2021, për periudhën 01.01.2019 deri në 31.12.2021, mbajtur më datë 04.02.2022.

Në bazë të programit të auditimit, nr.1275/1 prot., datë 26.11.2021 ,pika 4 eprogramit të auditimitñ mbi auditimin ezbatimit të procedurave të vete monitorimit dhe monitorimit të mjedisit në zonat e mbrojtura Lezhëò për periudhën 01.01. 2019 deri në 31.12.2021 , u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion:

1. Raportet e monitorimit për periudhën 01.01.2019 deri në 31.12.2021 të kryera nga Administrata e zonave të mbrojtura Lezhë , në zbatim të ligjit Nr. 81/2017 ñ Për zonat e mbrojtura ñ;
2. Procesverbalet e konstatimit për periudhën 01.01.2019 deri në 31.12.2021 të mbajtura nga Administrata e zonave të mbrojtura Lezhë ;
3. Kontrata e qirasë ndërmjet AdZM Lezhë dhe subjekteve private (lidhur me raportet e vet monitorimit) , në zbatim të ligjit Nr.81/2017 ñPër Zonat e Mbrojtura ñ

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që :

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2021 për vlerësimin e rregullshmërisë e veprimeve të kryerau përzgjodh metoda e raporteve dhe informacionit.

Për auditimet e kësaj pikë u mbështetëm në:

Ligjit Nr. 81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò. ***VKM NR. 102, datë 04.02.2015*** *"Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të administrative rajonale të zonave të mbrojtura).* ***Rregullore e Brendshme*** *"Për funksionimin dhe organizimin e AKZM dhe ADZM".* ***-Urdhri i KM nr. 48, datë 29.03.2016****"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe administrative rajonale të zonave të mbrojtura".* ***-Urdhri i KM nr. 26, datë 03.02.2020****"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe administrative rajonale të zonave të mbrojtura".*

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se:
Bazuar në Ligjin Nr.81/2017 ñPër Zonat e Mbrojturañ, është përcaktuar struktura përgjegjëse në nivel qarku (AdZM Lezhë) për ruajtjen dhe menaxhimin e zonës /zonave të mbrojtura. Sipas vendimit të mësipërm, nga AdZM Lezhë është realizuar monitorimi i zonave të mbrojtura dhe nga auditimii dokumentacionit me zgjedhje, lidhur me zbatimin e dispozitave ligjore dhe të akteve të tjera nënligjore rezultoi:
Sektori i Monitorimit ka realizuar monitorimin e zonave të mbrojtura , monitorimin e gjendjes së biodiversitetit, habitateve , popullatave të specieve të florës dhe të faunës së egër dhe ekosistemeve natyror, që mund të jenë ose rrezikohen nga veprimtari në zonat e mbrojtura. Në zbatim të kësaj pikë të programit të auditimit mbi procedurën eraporteve të monitorimit u përzgjodhën mbi bazë risku 20 urdhra inspektimi për çdo vit (viti 2019-viti 2020-2021).
11 Monumente te natyrës rrethi: LEZHE
1.Rëra e Hedhur. Ndodhet në veriperëndim të portit të Shëngjinit, rrëzë malit të Rencit. Përfaqëson një rast unikal tëgrumbullimit të madh rëre nga era në bregdetin e lartë. Është 600m i gjatë, rreth 100 m i gjerë. Ka vlera shkencore gjeomorfologjike, didaktike dhe turistike. Vizitohet nga deti, por edhe nga Velipoja dhe Shëngjini.**2.Shpella e Hutit**. Ndodhet pranë fshatit Grykë, 310 m mbi nivelin e detit. Përben shpellë karstike në gëlqerorët e Kretës, me gjatësi 16 m, gjerësi 6-8 m, lartësi 9-11 m. Është eksploruar nga speleologë të huaj dhe J.Gjini. Ka vlera shkencore gjeomorfologjike,didaktike, turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Manati-Grykë.**3.Shpella e Sukës së Vogël**. Ndodhet afër fshatit Petran, 460 m mbi nivelin e detit. Është shpellë karstike e formuar në gëlqerorët Kretës, me gjatësi 40 m, gjerësi 14-16 m, lartësi 3-5 m. Është eksploruar nga speleologë tè huaj dhe J.Gjini Ka vlera shkencoregjeomorfologjike, didaktike, turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Manati-Petran.
4.Dritarja tektonike e Mirditës. Gjendet në juglindje të fshatit Manati, komuna Kolsh, 80-600 m mbi nivelin e detit. Këtu, nënzonatektonike e Spitenit, del në brendësi të asaj të Krastës, në mbi 1500m dhe mbi 1000 m gjerësi. Është studiuar nga prof. V. Melo e prof.J. Kanani. Ka vlera shkencore gjeologjike, didaktike. Vizitohen me rrugën Manati-Gryke-Kolsh.**5.Këneta e Kashtës**. Ndodhet në bregdet në jug të Shëngjinit.Përbën lagunë të kënetëzuar dhe të formuar nga akumulimet lumore e detare. Është e gjatë 800-850 m dhe e gjerë rreth 300 400 m. Ky ekosistem ligatinor dallohet për florën e faunën e pasur. Ka vlera shkencore biologjike, ekologjike, didaktike. Vizitohet sipas rrugës Lezhe-Shengjin-Merxhan.**6.Rivat e Drinit**. Ndodhen afër Ishull Shëngjinit, 0,5 m mbi nivelin e detit. Përbëjnë habitat ligatinor, me botë të pasur shtazore, disa në rrezik zhdukjeje. Kanë vlera shkencore biologjike, ekologjike,turistike. Vizitohen sipas rrugës Lezhe-Shëngjin-Merxhan-Rivat eDrinit.**7.Rrepet e Grykës**. Gjenden në luginën e përroit të Kolshit (Manatisë), pranë fshatit Grykë. Janë tri drurë rrapi, dy me trunggati të bashkuar. Njihen si "Repet e Kuvendit & Burrave". Lartësiae drurëve arrin 15 m, diametri i trungut të dy rrapeve të bashkuar230 cm, ndërsa tjetri 90 cm. Kanë vlera historike, estetike, biologjike. Vizitohen sipas rrugës Manati-Gryke.**8.Rrepet e Kolshit**. Ndodhen pranë fshatit Kolsh. Përbëhet nga grup trepesh me lartësi 15-20 m, diametër trungut 0.70-1 m, mevlera biologjike, estetike. Për t'i mbrojtur Ndërmarrja Pyjore veshi me beton bregun e përroit të Kolshit. Vizitohen sipas rrugës Manati-Kolsh**. 9.Rrapi i Pirajve**. Ndodhet në lagjen Piraj të fshatit Blinishtë. Ka diametër të trungut 2-3 m, lartësi mbi 20 m dhe kurorë shumë të bukur, vlera shkencore, biologjike, ekologjike, estetike. Vizitohet sipas rrugës Lezhe-Blinisht**. 10.Lisi Markatomajt**. Ndodhet në varrezat e fshatit Zejmen. Ka dy degëzime në lartësinë reth 1,3 m nga toka. Diametri i çdo trunguështë rreth 0,80 m, lartësia arrin 10-12 m, ndërsa kurora krejt e veçantë dhe shumë e bukur. Ka vlera shkencore biologjike, fetare.Vizitohet, duke marrë rrugën automobilistike Lezhë (Milot)Zejmen.**11.Pylli i Shën Eufemisë**

(rreth 1 ha). Gjendet pranë fshatit Kallmet ¡ Vogel, 400-440 m mbi nivelin e detit. Përbehet nga dushk e fletorëttë tjerë pranë kishës, burimit e livadhit. Lartësia e drurëve arrin 10-12 m, diametri i trungut 35-45 cm, mosha 95-105 vjet.. Ka vlera shkencore biologjike, fetare, turistike. Vizitohet sipas rrugës Lezhë-Kallmet i Vogël-pylli i Shën Eufemisë.

17 Monumente te natyrës rrethi: KURBIN

1.Taraca Detare e Laçit.Ndodhet në lindje të qytetit tëLaçit. Përfaqëson një fragment të nivelit të tarracës të formuar nga veprimtariaevalëve detare në pozicionin e dikurshëm të detit helvecian. Është e gjatë rreth 500 m dhe e gjere rreth 80 m. Ka vera shkencore (ekologjike,gjeomorfologike), didaktike. Vizitohet sipas rrugës në lindje të Laçit.**2.Gryka e Shkopetit**. Ndodhet në fshatin Shkopet, në luginën e Matit, 150 m mbi nivelin e detit. Është grykë tërthore-kanion i trashëguar, e formuar në gëlqeroret nga lumi Mat. Është e gjatë rreth 60 m, e thellë rreth 50 m, e gjërë rreth 20 m. Ka shpate të thepisura. Përbën ekosistem interesant karstik. Ka vlera shkencore gjeomorfologjike, didaktike,turistike. Vizitohet, duke marrë rrugën Milot-Burrel.**3.Shpella e Shënavlashit (Shënandoi)**. Ndodhet ne lindje të Laçit, 250 m mbi nivelin e detit. Përbën shpellë karstike në gëlqerorë, e gjatë disa metra, e gjerë 14 m, e lartë 23 m. Legjenda e lidh me shenjtin e ShënNdout. Shërben si vend peligrinazhi fetar. Ka vlera fetare, didaktike, ekologjike e speleologjike. Vizitohet sipas rrugës Laç-kisha e Shënandout.**4.Ishulli i Cabokut**. Ndodhet në deltën e Matit, në lartësinë rreth 1.5 m mbi nivelin e detit. Ishull interesant (4,5 ha), i formuar nga akumulimet i mbetjeve organike, në të cilin është krijuar ekosistemi me botë të pasur bimore barishtore, ku folenizon pelikanikaçurel. Ka vlera shkencore biologjike, ekologjike, didaktike. Vizitohet sipas rrugës Laç-Patok-delta e Matit.**5.Kordoni litoral i Bregut të Ri**. Ndodhet në perëndim të Lagunës së Vjetër të Patokut, rreth 0.5 m mbi nivelin e detit. Është formuarnga akumulimet detare e lumore. Zgjatet në drejtimin veri-jug dhe ka krijuar Lagunën e Re. Përbën ekosistem me botë të gjallë të pasur.Ka vlera shkencore (gjeomorfologjike, biologjike), ekologjike, didaktike. Vizitohet sipas rrugës Laç-Patok.**6.Burimi i Vinjollit**. Ndodhet në afërsi të fshatit Vinjoll, 580 m mbi nivelin e detit. Burim karstik me prurje mjaft të madhe në kontaktin litologjik gëlqerorë-flish. Me ujin e pastër, të ftohtë e bimësinë përreth , krijon mjedis tërheqës. Ujësjellësi ka prekur vlerat shkencore hidrologjike, didaktike, turistike. Vizitohet sipas rrugës Milot- Gallatë-Vinjoll.**7.Fashëri në Skuraj (Kurbin**). Ndodhet afër fshatit Skuraj, 550 m mbi nivelin e detit, Është grumbull i vetëm me frashër (Fraxsinus excelsior), me trung e kurorë të veçantë, me lartësi 12 m, diametër të trungut rreth 70 cm, moshë mbi 100 vjet. Ka vlera shkencore, biologjike, ekologjike, didaktike, turistike. Vizitohet duke marrë rrugën Milot-Skuraj.**8.Lisat e Shënmillit.**Ndodhet pranë kishës të fshatit Mali i Bardhë. Janë rreth 70 drurë dushqesh, lisi e shparthi, me kurorë të veçantë(trapezi), lartësi 25 m, diametër trungu 1.1 m, moshë mbi 300 vjet. Cilësohet "vakëf" dhe nuk preket nga askush. Përdoret për piknikë.Ka vlera shkencore biologjike, estetike, fetare. Vizitohet me rrugën Laç-Mali i Bardhë.**9.Plepi i Bardhë.** Ndodhetafër fshatit Mali i Bardhë, 640 mmbi nivelin e detit. Përbën dru me trung dhe kurorë të veçantë, me lartësi 30 m dhe diametër trungu 1.2 m, moshë mbi 250 vjet. Kavlera shkencore biologjike, ekologjike, didaktike, turistike. Vizitohet,duke marrë rrugën Laç-Mali i Bardhë.**10.Gështenja e Vjetër**. Ndodhet në shpatin perëndimor të malit të Trodhës (Mali i Skënderbeut), 310 m mbi nivelin e detit. Përbëndru me kurorë ombrellore, me lartësi 20 m dhe diametër trungu rreth 2,3 m, moshë mbi 400 vjet.Pranë ka livadh, burim karstik dhe kishën e Sheneprenës. Përreth ka pyje dushku. Gështenja quhet e shenjtë. Ka vlera shkencorebiologjike, ekologjike, fetare, turistike. Vizitohet, duke marrë rrugën Laç ï Gallatë. **11.Rrapi i Daullës**. Ndodhet afër fshatit Daulle, 450 m mbi nivelin e detit. Përbën dru me kurorë të veçantë, me lartësi 30 m,diametër trungu 2 m, mosha 300 vjet. Ka vlera shkencore biologjike, ekologjike, turistike. Vizitohet

sipas rrugës Laç- Daullë.**12.Pylli i selvisë së Shën mërisë**. Ndodhet pranë fshatit Shëmri, në lindje të Mamurrasit. Pylli është 5,2 ha, përbëhet nga drurë me lartësi 20-25 m, diametër trungu 36-60 cm, mosha 100-120 vjet. Vlera janë biologjike, estetike, fetare. Vizitohet sipas rrugës Laç - Shëmëri.

12 Monumente te natyrës rrethi: MIRDITË

1.Kanioni Shehut të Keq. Gjendet afër Kurbneshit, komuna Gjocaj. I formuar në gëlqerore nga karsti dhe përroi i Shehut tëKeq, dallohet për pragjet, gjatësi mbi 1,5 km, gjerësi disa metra, thellësi 70-100 m. Ka vlera shkencore gjeomorfologjike, didaktike, turistike. Vizitohet sipas rrugës Rrëshen - Kurbnesh- Mërkurth.**2.Shpella Kusia e Ndue Gjonit.** Gjendet në luginën e Urakës (degë e Matit), pranë fshatit Mërkurth, komuna Kurbnesh, 800 m mbi nivelin e detit. U eksplorua nga grupispeleologjik i Milanos dhe P. Qiriazi. Shpella karstike ka disa galeri me gjatësi 650 m dhe dy kate: i poshtmi nën shtratin e Urakës, ndërsa i dyti me salla 10-15 m të gjata, 15-20 m të larta, plot me konkrecione të rralla nga bukuria(Salla e Bukur) dhe liqene të thellë. Ka vlera shkencore gjeomorfologjike, didaktike, turistike. Vizitohet sipas rrugës Rrëshen-Kurbnesh-Mërkurth.**3.Guri i Gjonit**. Gjendet afër Kurbneshit, 1300 m mbi nivelin e detit. Ka formë gati piramidale, lartësi disa dhjetëra metra, gjerësi 20-25 m dhe vlera shkencore (gjeologjikegjeomorfologjike), didaktike, turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Rrëshen-Kurbnesh.**4.Guri i Nuses.** Gjendet afër fshatit Konaj, komuna Shebë, 1700 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson gur me formë të veçantëtë formuar nga erozioni e era. Legjenda e lidh me nusen. Ka vlera shkencore gjeomorfologjike, turistike. Vizitohet me rrugënRrëshen-Klos-Konaj.**5.Kroi i Bardhë**. Gjendet në sektorin e sipërm të kanionit të Shehut të Keq, afër fshatit Kumbull, komuna Gjocaj, 1300 m mbinivelin e detit. Përfaqëson burim minerar, me vlera kurative, i përdorur nga banorët. Vizitohet sipas rrugës rurale Rrëshen-Kurbnesh-Mërkurth.**6.Mrizi i Shënaprenes**. Gjendet pranë (shfatit Shebë, komuna Kthelle, 634 m mbi nivelin e detit. Përbën pyll(0, 5 ha) me shkozë të bardhë, frashër, qarr etj, me lartësi 15-25 m, diametër të trungjeve 40-92 cm e perimetër 169-330 cm, moshë 110 vjet. Ka vlera shkencore, biologjike, didaktike, turistike. Vizitohet sips rrugës rurale Rrëshen-Kthelle-Shebë.**7.Rrapi iKaçinarit**. Gjendet pranë fshatit Kaçinar, 500 m mbi nivelin e detit. Është dru 150 vjeçar me lartësi 12-13 m, diametërtrungu mbi 60-70 cm, perimetër mbi 200 cm, me perimetër kurore 42 m. Ka vlera shkencore biologjike,didaktike, historike, turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Rrëshen-Kaçinar.**8.Lisi i Shpalit.** Gjendet afër fshatit Blinisht, komuna Orosh, 450 m mbi nivelin e detit. Përbën dru të zgavruar, me lartësi 17-20 m, diametër trungu 100-110 cm e perimetër mbi 340 cm. Pranë janë varrezat dhe kisha e Shpalit. Ka vlera shkencore biologjike,didaktike, estetike dhe fetare. Vizitohet sipas rrugës rurale Rrëshen-Shpal.**9.Lisat e Marpepës**. Gjenden afër fshatit Mashtërkor, komuna Orosh, 350 m mbi nivelin e detit. Janë 10 drurë lisi e qarri, melartësi 12-15 m, diametër trungu 45-80 cm e perimetër 130-240 cm, moshë rreth 90 vjet. Kanë vlera shkencore biologjike, didaktike, estetike, turistike. Vizitohet sipas rrugës ruraleRrëshen-Shpal-Fan.

Konkluzion:Këto monumente të natyrës si pjesë e zonave të mbrojtura janë burime për të garantuar të ardhura, por në fakt nuk janë vënë në eficencë,për shkak të vakumit ligjor dhe mungesës së udhëzimeve, për menaxhimin dhe administrimin e këtyre monumenteve**.** Në ligjin nr. 81/2017 datë 04.05.2017 nen17 pika 4 përcaktohet : ñ*Në përputhje me shkallën e mbrojtjes së monumentit dhe me potencialet turistike e rekreacionin e zonës, ministri miraton me urdhër e rregulla të veçanta për vizitat ose kalimin e vizitorëve a të turistëve për afate të shkurtra kohore".*

5.Titulli i Gjetjes: Mos vënia në eficencë e Monumenteve të Natyrës.

Situata: Stafi AdZM Qarkut Lezhë zhvillon kontrolledhe monitorime të Monumenteve të Natyrës në të 3 Rrethet Lezhë, Kurbin dhe Mirditë. Objektivi kryesorë i monitorimeve është promovimi i këtyre

MN-ve tek turistët që shprehin interes për vizitimin e këtyre objekteve natyrore me vlera të larta turistike. Të gjithë këto monumente vizitohen nga turistë vendas dhe të huaj pasi secili prej tyre ka karakteristikat e tij të veçanta, por ndër më të vizituarat konkretisht për rrethin e Lezhës janë: Ishulli i Kunes, Rëra e Hedhun, Pylli rreth kishës së Shën Eufemisë , Lisi i Markatomajve. Në rrethin Kurbin: Gryka e Shkopetit, Shpella e Shenavlashit, Ishulli i Cabokut, Burimi i Vinjollit, Plepi i Bardhe, Gështenja e Vjetër, Rrapi i Daullës. Rrethi Mirditë : Kroi Bardhe, Shpella e Pashes, Guri i Gjonit, Guri Nuses. Nga këto monumente të natyrës AdZM Lezhë nuk merr të ardhura, nga vizitorëtdrejt tyre.

Kriteri:Në ligjin nr. 81/2017 datë 04.05.2017 nen17 pika 4 përcaktohet : ñ*Në përputhje me shkallën e mbrojtjes së monumentit dhe me potencialet turistike e rekreacionin e zonës, ministri miraton me urdhër e rregulla të veçanta për vizitat ose kalimin e vizitorëve a të turistëve për afate të shkurtra kohore".*

Ndikimi:Këto monumente të natyrës si pjesë e zonave të mbrojtura janë burime për të garantuar të ardhura, por në fakt nuk janë vënë në eficencë , për shkak të vakumit ligjor dhe mungesës së udhëzimeve, për menaxhimin dhe administrimin e këtyre monumenteve.

Shkaku: Mos eficenca e monumenteve të natyrës vjen si pasojë e mos pasjes së infrastukturës së duhur dhe investimit të duhur pranë tyre.

Rëndësia: E ulët.

Rekomandimi: AdZM Lezhë në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës, ti japi prioritet promovimit të Monumenteve të Natyrës, si dhe gradualisht të bëhet e mundur vënia në eficencë e tyre.

1. Raportete monitorimit për vitin 2019

Sektori i Monitorimit ka realizuar monitorimin e zonave të mbrojtura , monitorimin e gjendjes së biodiversitetit , habitateve , popullatave të specieve të florës dhe të faunës së egër dhe ekosistemeve natyrore, që mund të jenë ose rrezikohen nga veprimtari në zonat e mbrojtura . Për vitin 2019 , Administrata Rajonale e zonave të mbrojtura Lezhë kakryer1439 kontrolle dhe monitorime të aktiviteteve të paligjshme në tëgjithë territorin e zonave të mbrojtura Qarku Lezhë nga këto :

19 kontrolle të përbashkëta me Policinë e Shtetit, ISHMPUT për gjueti, peshkim të paligjshëm dhe prerje;

821 kontrolle dhe monitorime për prerje dhe zënie të sipërfaqes së menaxhuar nga ana e rangë save;

28 kontrolle dhe monitorime të gjendjes fito sanitarë të pyjeve në zonat e menaxhuara;

124 kontrolle dhe monitorime të gjendjes së Monumenteve të Natyrës;

447 kontrolle dhe monitorime me urdhër inspektimi për gjueti, peshkimit të paligjshëm, ,zënie të sipërfaqeve të menaxhuara etj.

- Më poshtë disa prejkontrollevetë realizuaranga rojet mjedisore (rangers) për vitet 2019:

Situata:Në AdZM Lezhë nuk ka të dhëna për bashkëpunime me Drejtoritë e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës sidomos përsa i përket zonave ujore, të cilat gjenden në sipërfaqet e zonave të mbrojtura në lidhje me zbatimin e planit të menaxhimit për mbrojtjen e ujërave nga ndotjet dhe peshkimi i pa kontrolluar, në Kuneï Vain si dhe Patok Fusheï Kuqe nuk kanë dalë udhëzimet përkatëse për përcaktimin e aktorëve pjesëmarrës dhe procedurave që duhen ndjekur për peshkimin në kuadër të menaxhimit të ujërave burime natyrore. Kështu funksionimi i inspektimit të peshkimit në ZM, duhet të përcaktohet edhe nga Ministria Mjedisit dhe Turizmit . Ndërsa në kontratën e lidhur mes Ministrisë së Bujqësisë dhe Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit, është parashikuar që inspektimin e kryen me mjetet e veta Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, gjë e cila është në konflikt interesi, pasi kjo organizatë nuk mund të kontrollojë aktivitetin e vet. Përjashtimi nga kontrata e Ministrisë së Mjedisit dhe AdZM ka sjellë mos kontrolli dhe mos parandalimin e peshkimit të paligjshëm, duke shmangur rolin mbrojtës të AdZM në ruajtjen e Kune-Vain si dhe Patok ï Fushe Kuqe,si pjesë e ZM. OMP si subjekt privat ka kryer liçensimin e peshkatarëve pa asnjë lloj studimi paraprak, pa marrë aspak në konsiderate statusin si zonë e mbrojtur , numri i licencave, peshkimi i paligjshëm ka reduktuar ndjeshëm rezervën peshkore në Kuneï Vain Fusheï Kuqe Patok, e cila ndikon drejt për drejt në praninë

ose jo të shpendëve ujore dimërues. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.81/2-017 ñPër zonate mbrojturaò datë 04.05.2017 neni 34 , pika 2 .

Kriteri:Për zbatimin e VKM nr. 430 datë 23.07.2016 ñPër Bashkë menaxhimin e Ujërave të Brendshme të Kune ï Vain,në kundërshtim me LigjinNr. 111/2012 ñPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreò, dhe nenit 34 të ligjit nr.81/2017 ñPër zonat e Mbrojturaò.

Ndikimi/Efekti: Eshtë shmangur roli i mbrojtës të AdZM në ruajtjen e Kune-Vain si dhe Patok ï Fushe Kuqe, si pjesë e ZM.

Shkaku:Përjashtimi nga kontrata e Ministrisë së Mjedisit dhe AdZM ka sjellë mos kontrolli dhe mosparandalimin e peshkimit të paligjshëm.

Rëndësia:E Mesëm

Rekomandimi: AdZM-të të marrin masa që brenda kuadrit ligjor dhe reciprocitetit institucional vënien ne dijeni të AKZM qetë kryejnë bashkëpunime me Drejtoritë e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit si dhe Ministrinë e Bujqësisë, për të hartuar një marrëveshje të përbashkët për kontrollin dhe ruajtjen e zonave të ndaluara për peshkim dhe parandalimin e peshkimit pa kriter dhëtë paligjshëm në ZM.

8.Titulli gjetjes: Territori buferik i zonës së menaxhimit të habitateve.

Situata: Nga auditimi u konstatua se nuk është vendosur dhe nuk ekziston territori buferik i zonës së menaxhimit të habitoreve dhe llojeve me gjerësi 50 ml nga kufiri i zonës. Në rezervatet natyror të menaxhuar ku mungon zona buferike futen Kune -Vain, Shëngjin.

Kriteri: veprime jo në përputhje të nenit 3/30 të ligjit nr.81/2017, ku citohet: ñ*Zonë buferike" është hapësira e kufizuar, në periferi të zonës së mbrojtur mjedisore, që shërben për parandalimin ose zbutjen e ndikimeve ekologjikisht të dëmshme në mjediset dhe elementet e rëndësishme të zonës së mbrojtur*ò.

Ndikimi/Efekti: Është shmangur roli i mbrojtës të AdZM në ruajtjen e Kune-Vain si dhe Patok ï Fushe Kuqe, si pjesë e ZM.

Shkaku: Mos marrja e masave nga Njësite e Qeverisjes Vendore për rregullimin e planeve për vijën bregdetare.

Rëndësia:E Mesëm

Rekomandimi: AdZM-të në bashkëpunim me Njësite ë Qeverisjes Vendore të marrë masa për të vendosur, caktuar dhe kufizuar sipas standardit ligjor zonat buferike në rezervatet natyrore Kune-Vain, Shëngjin etj., në funksion të ruajtjes dhe përmirësimit të funksioneve natyrore të tyre.

Pika 3.1-Auditimi mbi zbatimin e proceduarve planet zhvillimore si dhe (ndërtimeve informale në zonat e mbrojtura) .

Drejtoria Vendore e ASHK Lezhë ushtron aktivitetin e saj ne Sektorin e Legalizimeve në rang Qarku duke përfshireBashkinë Lezhë, Kurbin dhe Mirdite.

Përsa i përket Zonave te Mbrojtura Mjedisore kemi dy përkatësisht :

- REZERVATI NATYROR ñ KUNE-VAIN-TALE ò
- REZERVAT NATYROR I MENAXHUARò TË EKOSISTEMIT NATYROR-LIGATINOR TË ñ PATOK-FUSHËKUQE-ISHËMò

Zonat e Mbrojtura ndahen ne Disa Nen Kategori përnga shkalla e mbrojtjes nga me e Lehta deri në Strikt e Mbrojtur te radhitura si me poshtë :

- Zone Buferike (ZB)
- Zone e Përdorimit të Qëndrueshëm (ZPQ)
- Zone e Përdorimit Traditional (ZPT)

- Zone Rekreacion (ZR)
- Zone Qendrore (ZQ)

Duhet theksuar se ne këto 3 zonat e para përkatësisht në Nen zonat (ZB , ZPQ dhe ZPT) ka pasur një numër të larte të ndërtimeve pa leje dhe Vetë deklarimeve për legalizim . Për këtë arsye në disa zona aty ku ka pasur edhe një dendësi te larte të ndërtimeve është vepruar duke i shpallur Zona Informal përkatësisht :

3 Zona Informale brenda kufijve të zonës se mbrojtur mjedisore ñKune-Vain-Taleò, një në Ishull Lezhe dhe dy ne fshatin Gryke-Lumi .

3 Zona Informal brenda kufijve të zonës së mbrojtur mjedisore ñPatok-Fushëkuqe-Ishëmò, me saktësisht një ne fshatin Fushe Kuqe , një ne fshatin Patok dhe një ne fshatin Adriatik .

Me ndryshimet Ligjore të herë pas hershme është vepruar me legalizimet ne këto zona ne mënyre permanente sipas kërkesave te qytetareve kryesisht ne Zonat Informal dhe në Nen Zonën Buferike e cila nuk e ndalon procesin e legalizimeve . Për një pasqyrim me të qarte të situatës në zona po bashkëlidhim njëdata basë me Konturin e dy zonave te mbrojtura me Objektet e evidentuara për legalizim ndër vite .

Nga dhënat e marra nga AdZM si dhemarrja e informacionit nga Ashk Lezhë, rezultoi se ndërtimet informale janë që prej vitesh dhe nga ana e ADZM është administruar një data basë, ku në bashkëpunim më

-AdZM me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Lezhë ka hartuar data basëekadastrës me të dhënat e viteve 1999 për nën zonat e ZM-ve me emërtimin ZR Tale, Kune - Vaine ,Fuhe ï Kuqe Patok, duke përfshirë këto elemente si sipërfaqet, kodin kadastral, emërtimin, vendodhja në nj.q.v, kategorizimi, akti ligjor i shpalljes, statusi dhe situata e inventarizimit.Në këtë data basë nuk ka të dhëna për sipërfaqet ujore. Gjithashtu regjistri elektronik iZM nuk është real ,pasi nuk ka të azhurnuar të dhënat e përditësuara për ndryshimet e ndodhura në sipërfaqet territoriale nën juridiksionin administrativ. Nuk ka përpunim të hartave të territoreve dhe zoonimet e brendshme. Nuk ka të dhëna për ekosistemet pyjore që do të inventarizohen dhe mbarështohen, për përditësimin periodik të inventarit kombëtar të pyjeve, për hartografinë dhe dixhitalizimin e njësive të mbarështimit.

Rekomandim: AdZM membështetjen e AKZM-së, të bashkërendoje punën dhe të krijojë korrespondence zyrtare me ZRVPP, Njësitë Vendore e strukturave të tjera përkatëse, për saktësimin dhe azhurnimin e përditësimeve të dhënave esipërfaqeve të ZM si dhe përpunimin e hartave të shtrirjes dhe zonimit sipas kategorive si dhe përcaktimin e kufijve të zonave dhe territoreve në pronësi apo në përdorim të njësive vendore.

-AdZM Lezhë nuk ka të evidentuar ndërtimet pa leje të kryera në ZM të Qarkut Lezhë , të cilat duhet të ishin raportuar pranë AKZM Tiranë. Nga të dhënat e marra në ALUIZMI-n Lezhëkanë rezultuar 3 rasteobjektesh të legalizuara, që janë aktualisht brenda zonës së mbrojtur Kune-Vaine , fushe ï kuqe dhe Tale , dhe në 4 rastebrenda zonës së mbrojtur tëFushe ï Kuqe Patok. Këto legalizime ishin bërë në mungesë të planit të menaxhimit të zonës në kundërshtimme ligjin nr. 9868, datë 4.2.2008 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 ñPër zonat e mbrojturaò neni 19 ñPërdoruesit e zonave të mbrojturaò dhe Neni 25 ñVeprimtaritë në zonat e mbrojturaò ligjit 81/2017 datë 04.05.2017.

Rekomandim: AdZM Lezhë në sinkronizim me AKZM Tiranë të vendosi ura lidhëse me Policinë e Shtetit, Policinë dhe IKMT Bashkiake, për marrjen e të dhënave për ndërtimet informal dhe të kryeje verifikimin e tyre në terren. Gjithashtu të vendosi korrespondencë zyrtare me ALUIZNI-n dhe ZRVPP Lezhë, për shkëmbimin e informacionit për dosjet e ndërtimeve pa leje të shtrira në ZM që janë në

proces legalizimi e hipotekimi, me qëllim parandalimin e legalizimit dhe prishjen e tyre në rastet kur mungon leja mjedisore e aprovuar.

9-Titulli i gjetjes: Ndërtimet informale nëZM.

Situata: AdZM Lezhë ka të evidentuara ndërtimet pa leje të kryera në ZM të Qarkut Lezhë ,

Nga informacioni i marrë nga zyra e ASHK Lezhë rezulton se ka pasur një numër të larte të ndërtimeve pa leje dhe Vetë deklarimeve për legalizim. Për këtë arsye në disa zona aty ku ka pasur edhe një dendësi te larte të ndërtimeve është vepruar duke i shpallur Zona Informal.

Figurojnëtë ndërtuaranë zone të mbrojtur **123 objekte** banimi, social ekonomike etj. që nga viti 1999 e deri tani. AdZM,kanjë data-basë, me të dhënat për ndërtimet në këto zona.

-Nuk ka komunikim shkresor me njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Institucionet Ligj Zbatuese dhe ASHK-në,veprime në kundërshtim me ligjin Nr. 111/2018 ñôPër KadastrënòôñPër zonat e mbrojturaò për parandalimin e ndërtimetin formalë.Veprime në kundërshtim me nenin nr. 9 pika (ç) dhe (f) tëligjitNr.81/2017 ñ për Zonat e Mbrojturaò.

Kriteri: Veprime të kryera në mungese të planit të menaxhimit të zonës në kundërshtimme ligjin ligjit 81/2017 datë 04.05.2017,si dhe ligjin nr. 111/2018 ñôPër Kadastrënò.

Ndikimi/Efekti: Ndërtimet pa kriter dhe dëmtimi i florës dhe faunës në zonat e mbrojtura.

Rëndësia:E Mesëm

Rekomandimi:Rekomandimi:.ADZM Lezhë të marrë masa dhe të këtë të gjithë informacionet për ndërtimet informale, si dhe të bashkëpunoje me të gjitha institucionet ligj zbatuese për Zonën e mbrojtura me njoftime periodike shkresore pranë IKMT dhe ASHK për ndjekjenprocedurave ligjorenë të gjitha ato zona ku ka objekte të ndërtuara jashtë ligjit.

<u>Pika3.2.</u>Hartimi dhe zbatimi i planeve të nenaxhimit për Zonat e Mbrojtura.
Planet e Menaxhimit, AKZM Lezhë.



1.Për periudhën objekt auditimi u auditua dokumentacioni, sa i përket menaxhimit të zonave të mbrojtura nga ku konstatohet se AdZM Qarkut Lezhë administron dhe menaxhon katër zona të mbrojtura:

1. RNM Kune ï Vain - Tale, i shpallur me VKM nr. 432, date 28/04/2010, me sipërfaqe 4393.2 ha.
2. RNM Bërzane ,shpallur me VKM në vitin,1994.

3. RNM Patok ï Fushë Kuqe ï Ishëm ï Ishëm, shpallur me VKM nr. 995 datë 03/11/2010 me sipërfaqe 5000.7 ha.
4. Bjeshka Oroshit, Zonë e Burimeve të Menaxhuar ,shpallur me V.K.M. Nr. 102datë 15.01.1996 me sipërfaqe 4691.2.
5. Gjithashtu në territorin e Qarkut Lezhë janë gjithsej 40 monumente natyrë që janë të shpërndara sipas rretheve Lezhë 11,Mirditë 17,Kurbin 12.

Bazuar në ligjin Nr.81/2017 për ñZonat e Mbrojturaò, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, në Kreun IV , Neni 42 për Planet e Menaxhimit rreth hartimit dhe miratimit të planit të menaxhimit të zonave të mbrojtura:

1. Ministria, në bashkëpunim me ministritë e linjës, me bashkitë, me publikun e interesuar, shoqërinë civile dhe me pronarët privatë, pronat e të cilëve shtrihen brenda territorit të zonës së mbrojtur, miraton për secilën zonë të mbrojtur planin e menaxhimit të saj, të hartuar nga AKZM-ja.
2. Objektivat dhe kërkesat e politikave, planeve dhe programeve sektoriale që lidhen me to merren parasysh gjatë hartimit të planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe integrohen në vendimmarrjet kombëtare, rajonale e vendore që prekin zonat e mbrojtura.
3. Në planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur mjedisore përfshihen të paktën: a) objektivat e menaxhimit të zonës së mbrojtur; b) mekanizmat dhe autoriteti drejtues; c) proceset dhe kategoritë e veprimtarive që janë kërcënuese për zonën e mbrojtur, përfshirë edhe zonat rrethuese; ç) masat rregullatorë ose administrative që nevojiten për të shmangur ose pakësuar kërcënimet e identifikuara; d) veprimtaritë e lejuara brenda zonës së mbrojtur; dh) veprimtaritë e duhura për zonat përreth, duke përfshirë ato në zonat buferike; e) kushtet për zhvillimin e shërbimeve të tjera; ë) të dhënat për pronësinë e mëparshme të truallit dhe të drejtat për të përdorur elementet e diversitetit biologjik brenda tij, duke përfshirë veprimtaritë tradicionale për jetesën e popullatës të bashkësisë vendore; f) kushtet për të zhvilluar veprimtari tradicionale për jetesë të zonës ose të elementeve të diversitetit biologjik brenda saj, nëse ato nuk bien ndesh me objektivat e administrimit të zonës së mbrojtur; g) kushtet për të ndarë përfitimet nga krijimi dhe administrimi i zonës së mbrojtur, veçanërisht me bashkësitë dhe popullatat vendore; gj) kushtet për kërkim shkencor, inventarizim dhe monitorim; h) burimet financiare, përfshirë ato që sjellin fitim; i) masat për informimin e publikut dhe përfshirjen e tyre në qeverisjen e zonës; j) kushte të tjera të veçanta për zonën në fjalë.
4. Struktura e planit të menaxhimit, përmbajtja dhe kriteret e rishikimit të tij miratohen me udhëzim të ministrit. Planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur mjedisore janë 10-vjeçare.
5. Në planin e menaxhimit, sipas nënzonave të administrimit, caktohen qartë dhe në mënyrë të detajuar veprimtaritë e ndaluara, ato që mund të ushtrohen pasi të pajisen me leje mjedisi apo që duan miratim të administratës së zonës.

Konkluzion: Nga grupi i auditimit u konstatua që për periudhën objekt auditimi përkatësisht viti 2020 dhe viti 2021, ADZM Lezhë nuk ka të planifikuar Plan Menaxhimi. Në kundërshtim kjo me nenin 42, pika 1, ku theksohet se *"Ministria, në bashkëpunim me ministritë e linjës, me bashkitë, me publikun e interesuar, shoqërinë civile dhe me pronarët privatë, pronat e të cilëve shtrihen brenda territorit të zonës së mbrojtur, miraton për secilën zonë të mbrojtur planin e menaxhimit të saj, të hartuar nga AKZMja".*Për vitin 2019 Ministria ka përgatitur Plan Menaxhimi pasi ka qenë e përfshirë në Planin e

Menaxhimit të zonës Kënetore të Kune Vainit për periudhën 2010-2019 të përgatitur dhe rishikuar në Janar të vitit 2010.

9.Titulli i Gjetjes: Mos ekzistenca e Planit të Menaxhimit.

Situata: Nga grupi i auditimit u konstatua që për periudhën objekt auditimi përkatësisht viti 2020 dhe viti 2021, ADZM Lezhë nuk ka të planifikuar Plan Menaxhimi. Për vitin 2019 Ministria ka përgatitur Plan Menaxhimi pasi ka qenë e përfshirë në Planin e Menaxhimit të zonës Kënetore të Kune Vainit për periudhën 2010-2019 të përgatitur dhe rishikuar në Janar të vitit 2010.

Kriteri: Në kundërshtim kjo me nenin 42, pika 1, ku theksohet se *"Ministria, në bashkëpunim me ministritë e linjës, me bashkitë, me publikun e interesuar, shoqërinë civile dhe me pronarët privatë, pronat e të cilëve shtrihen brenda territorit të zonës së mbrojtur, miraton për secilën zonë të mbrojtur planin e menaxhimit të saj, të hartuar nga AKZM-ja".*

Ndikimi: Nga mos ekzistenca e një Plani Menaxhimi në AdZM Lezhë, për periudhën objekt auditimi, nuk jepet informacioni i duhur për funksionimin dhe detyrat e AdZM.

Shkaku: Nga AdMZ Lezhë dhe nga Ministria e linjës nuk është miratuar plani i menaxhimit për 10-vjeçarin e ardhshëm.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AdZM Lezhë në bashkëpunim me Ministrinë e linjës, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, të marrin masa për planifikimin dhe miratimin e Planit të Menaxhimit për 10- vjecarin e ardhshëm.

2.Planet e Menaxhimit

Për vitin 2019 plani i menaxhimit i shërben arritjes së objektivave si:

- Parandalimi dhe stopimi i të gjithë aktiviteteve të paligjshme që kërcënojnë Zonat e Mbrojtura të Qarkut Lezhë si p.sh. Gjuetia, Prerjet, Zeniet dhe Ndotjet Mjedisore.
  - 6Hartimi i planit të masave për parandalimin e zjarreve në pyje dhe kullota.
  - Mbrojtja nga zjarret si një nga objektivat më kryesore të stafitpasi zjarret në ekonomitë pyjore kanë një efekt shkatërrues por nuk ka pasur kërcënime serioze gjatë vitit.
- Bashkëpunimi me institucionet e tjera Vendore dhe Qendrore të cilat janë pjesë e interesit të Zonave të Mbrojtura kryesisht për një bashkëmenaxhim sa më të mirë të zonës.
- Promovimin e zonave të mbrojtura për tû bërë të mundur thithja e sa më shumë turisteve kryesisht të huaj duke treguar vlerat unike që mbartin keto zona.
- Propozimi i disa projekteve të ndryshme në dobi të Zonave të Mbrojtura të Qarkut Lezhë

➢ Rezultatet kryesore të punës së AdZM Qarkut Lezhë janë:

- Në kuadër të projektit Eba janë pyllëzuar gjithsej 7 ha të sipërfaqeve të zhveshura në RNM Kune ï Vain ï Tale, si dhe 1.8 ha pyllëzime me duna ranore.
- Janë mbjellur 1600 fidanëpishë e egër përreth zyrave të AdZM Qarkut Lezhë, rruga hoteli gjuetisë, Shkolla Mesme Ishull Lezhë.
- Janë mbjellë 1400 fidanë pishë egër në ZM Patok ï F kuqe ï Ishëm, rruga adriatik, ishulli cabokut, lumi mat, godull dhe plazhi vjetër.
- Janë mbjellë 500 fidanë pishë egër në Reps në ekonominë pyjore lugina fanit vogël.

- Numri i turistëve që kanë vizituar Zonat e Mbrojtura të Qarkut Lezhë gjithsej janë 176.908 nga këto të huaj 32.623,vendas 144.285.
- Të ardhura nga shitja e biletave të vizitorëve 133.700 lekë.
- Të ardhura nga kontratat e dhëna në përdorim 167.700 lekë

Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur të gjitha të ardhurat nga biletat e postobllokut, të ardhurat nga kontratat e qerasë, numri i vizitorëve vendas dhe të huaj si dhe numrin e vizitorëve total.

Tabela nr.1:Të ardhurat dhe vizitorët e AKZM Lezhë, viti 2019

	Viti 2018	**Viti 2019**	**Rritja ne % 2018-2019**
Të ardhurat nga Bileta	126,000 lekë	133,700 lekë	9,4
Të ardhura nga kontrata qeraje	170,250 lekë	167,700 lekë	-1,6
Nr i Vizitoreve Vendas	84,119vizitore	144,285 vizitore	58
Nr i Vizitoreve te Huaj	15,998vizitore	32,623 vizitore	49
Nr i Vizitoreve Total	100,117vizitore	176,908 vizitore	56

Punuar nga grupi i Klsh-së

➢ Aktivitetet kryesore të realizuara nga AdZM Lezhë :

Seminari për Trajnimin e specialistëve të AdZM-ve, lidhur me përgatitjen dhe hartimin e Planeve të Mbar shtrimit të Pyje dhe Kullota ne ZM.

Dita Ndërkombëtare e ligatinave Aktivitete sensibilizuese me nxënës shkollash me titull òEkosistemet Ligatinore dhe Ndryshimet Klimaterikeò.

Ndjekja e ecurisë së zbatimit të projektit: óArritja e përshtatjes së lagunës Kune- Vain përmes përqasjes së Adaptimit të bazuar në Ekosistemô(EBA).

Janë hartuar skedat biologjike për secilën ZM. dhe skedat për monumentet e natyrës.

Është përgatitur dokumentacioni teknik për dhënien e sipërfaqeve në përdorim dhe 4 NV *ndjekja e kontratave me subjektet private.

Me specialistët është ndjekur gjendja e florës dhe faunës së egër dhe asaj ujore.

Është planifikuar dhe realizuar në kuadër të nismës ñkrijo O2 tëndò mbjella 3500 (tremijë e pesëqind) pemë, me shkollat, subjektet private, institucionet

Pastrimi sëbashku me shoqatën E.V.përgjatë vijës bregdetare të Kune-Vainit për një sezon turistik të pastër dhe më të sigurt.

Mbyllja me sukses e projektit S. A. e cila i solli bregdetit të Shëngjinit buzëqeshjen e të rinjve shqiptare për dy muaj me radhë duke promovuar bukuritë natyrore të Qarkut të Lezhës dhe jo vetëm.

Bashkëpunimi me fakultete të ndryshëm për njohjen me resurset natyrore të zonës së mbrojtur.

Zhvillimi i panairit te fotografive te RNM Kune ï Vain me rastin e ditës ndërkombëtare të biodiversitit.

Zhvillimi i Festivalit ñU...ò nga data 31 maj deri me 3 qershor ku morën pjesë mbi 50 dj të huaj dhe vendas për zhvillimin e turizmit në këtë zonë.Sensibilizimi me anë të takimeve me komunitetin, Njësite Administrative, nxënës shkollash 9-Vjecare, etj për rëndësinë që kanë Zonat e Mbrojtura të Qarkut Lezhë.

Bashkëpunim me Bashkitë e Qarkut Lezhë për njohjen e Monumenteve të Natyrës si dhe rëndësinë ekoturistike që ato kanë.

Gjatë gjithë periudhës së vitit 2019 ekologjiko-mjedisor janë organizuar 23 eventepër të gjitha ngjarjet mjedsiore qe lidhen me biodiversitetin .

- **<u>Për vitin 2020</u>** objektivat kryesore të punës kanë qene:

Zbatimi me rigorozitet i akteve ligjore dhe nënligjore, të rregulloreve, urdhrave të punës.
Përmirësimi dhe mirëmbajtja e habitatit natyror, faunës dhe florës ne përgjithësi.
Rritje të bashkëpunimit dhe koordinimin e punëve të përbashkëta me strukturat lokale, policinë e shtetit dhe komunitetin.
Përmirësimi i menaxhimit të ZM-ve përmes rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe monitoruese të stafit.
Rritja e ndërgjegjësimit për komunitetet lokale nëpërmjet edukimit mjedisor.
Më shumëbashkëpunimeme inspektoratin e peshkimit mbi mënyrën e kontrollit të këtij aktiviteti.
Mbajtja në gjendje të qëndrueshme të Ekosistemeve Lagunore dhe Pyjore që zënë pjesën më të madhe të Zonave të Mbrojtura në këtë qark.
Hartimi i planit të masave për parandalimin dhe mbrojtjen e pyje dhe kullotave nga zjarret.
Promovimin e zonave të mbrojtura për tû bërë të mundur thithja e sa më shumë turistëve kryesisht të huaj duke treguar vlerat unike që mbartin këto zona.
Propozimi i disa projekteve të ndryshme në dobi të Zonave të Mbrojtura të Qarkut Lezhë.

- <u>Aktivitetet kryesore te realizuara për vitin 2020 janë:</u>

Dita Ndërkombëtare e ligatinave takim me stafin si dhe mbjedhja e 22 fidanëve në ambientet e AdZM.
Aktivitet sensibilizues me përfaqësues të REC Albania dhe nxënësit e shkollës së mesme profesionale ñ Kolin Gjoka ñ
Aktivitet sensibilizues për pastrimin e mbeturinave plastike , mbledhjen e disa pemëve dekorative përgjatë shëtitores së Shëngjinit së bashku me Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit, Kryetarin e Bashkisë Lezhe si dhe nxënës shkollash.
Ekspozita Fotografike mbi vlerat natyrore të RNM Kune ï Vain se bashku me drejtorinë e Turizmit dhe Klubin Ekologjik Lezhë.
Mbjellja e 55 fidanëve dekorativ , AdZM Lezhë se bashku me nxënësit e shkollës 9- vjeçare Gorre.
Dita Ndërkombëtare e Jetës së Egër aktivitet sensibilizues në ruajtje të faunës së egër së bashku me nxënësit e shkollës 9- vjecare Adriatik.
Censusi i Pelikanit i zhvilluar në 3 pika Kune, Vain , Patok.
Së bashku me DRM stafi AdZM Lezhë bëri të mundur verifikimin e hapësirave të plazheve të menaxhuara dhe publike për mbarëvajtjen e sezonit turistik.
Aksion pastrimi me Prefektin e Qarkut Lezhë dhe institucionet për pastrimin e plazhit të Shëngjinit për një sezon turistik sa më të pastër.
Pastrimi së bashku me shoqatën E. V.përgjatë vijës bregdetare të Kune-Vainit për një sezon turistik të pastër dhe më të sigurt.
Së bashku me Bashkinë Lezhë aksion pastrimi në bregdetin e Vainit.
Mbledhja e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit ku u bë e mundur njohja me plan- veprimin e sezonit turistik 2020, hartuar në varësi të kushteve të reja të diktuara nga pandemia e COVID-19.
Aksion pastrimi i mbetjeve plastike në grykëderdhjen e lumit Ishëm së bashku me AdZM Durrës dhe studente të universitetit Bujqësor të Tiranës.
Aktivitet informues ne kuadër të propozimit të Masivit të Munellës Park Kombëtare.
Bashkëpunimi me studente dhe pedagogë të Universitetit Bujqësor të Tiranës, studente të Fakultetit te Shkencave Pyjore, studente të Fakultetit te Shkencave të Natyrëspër njohjen me resurset natyrore të zonës së mbrojtur.

- <u>Rezultatet kryesore të punes së AdZM Qarkut Lezhë janë:</u>

29 takime me pjesëmarrje të stafit të AdZM Qarkut Lezhë në aktivitete që synojnë promovimin e vlerave të ZM-ve të Qarkut Lezhë.
47 takime me komunitetetet, Kryetar Fshatrash dhe me subjektet që operojnë në territorin e zonave të mbrojtura Qarkut Lezhë për rritjen e gatishmërisë në raste zjarresh, pastrimin sistematik nga ndotjet urbane, parandalimin e rasteve të gjuetisë dhe peshkimit të paligjshëm etj.
Janë mbjellë 50 fidanë pishë e egër përreth zyrave të AdZM Qarkut Lezhë.
Janë mbjellë 50 fidanë pishe egër në ZM.Patokï F.kuqeï Ishëm pranë shkollës gorre.
Numri i turistëve që kanë vizituar Zonat e Mbrojtura të Qarkut Lezhë gjithsej janë 147458 nga këto të huaj 3044,vendas 144414.
Të ardhura nga shitja e biletave të vizitorëve 129.000 lekë.
Të ardhura nga kontratat e dhëna në përdorim 463.450 lekë
Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur të gjitha të ardhurat nga biletat e posto bllokut, të ardhurat nga kontratat e qerasë, numri i vizitorëve vendas dhe të huaj si dhe numrin e vizitorëve total.

Tabela nr.2:Të ardhurat dhe vizitorët e AKZM Lezhë, viti 2020

	Viti 2019	**Viti 2020**	**Rritja ne % 2018-2019-2020**
Të ardhurat nga Bileta	133,700 lekë	129000	2.6
Të ardhura nga kontrata qeraje	167,700 lekë	463450	12.5
Nr i Vizitorëve Vendas	144,285 vizitore	144,414 vizitor	41.7
Nr i Vizitorëve të Huaj	32,623 vizitore	3044 vizitor	-46
Nr i Vizitorëve Total	176,908 vizitore	147,458 vizitor	23.4

Punuar nga grupi i Klsh-së
Përqindja negative është krahasim i viteve 2019-2020, si rezultat i pandemisë Covid-19.

- **<u>Për vitin 2021</u>**objektivat kryesore të punës kanë qenë:

Parandalimi dhe stopimi i të gjithë aktiviteteve të paligjshme që kërcënojnë Zonat e Mbrojtura të Qarkut Lezhë si Gjuetia, Prerjet e lëndës drusore, Zëniet e sipërfaqeve Ndotjet Mjedisore si dhe parandalimin e rasteve të shfaqjes së zjarreve në pyje dhe kullota.
Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i gjendjes së faunës dhe florës, vendbanimeve natyrore dhe peizazheve.
Sigurimi i mbrojtjes së integruar të natyrës përmes bashkëpunimit me sektorët e tjerë, shfrytëzimi i qëndrueshëm i biodiversitetit.
Promovimi i edukimit dhe komunikimit efektiv për biodiversitetin.
Pakësim i rasteve të zjarreve dhe të sipërfaqeve të dëmtuara.
Më pak aktivitete të paligjshme në zonën e mbrojtur.
Rritja e bashkëpunimitme inspektoratin e peshkimit mbi mënyrën e kontrollit të këtij aktiviteti.
Rritje të bashkëpunimit dhe koordinimin e punëve të përbashkëta me strukturat lokale, policinë e shtetit dhe komunitetin.
Rritja e ndërgjegjësimit për komunitetet lokale nëpërmjet edukimit mjedisor
Mbajtja në gjendje të Qëndrueshme të Ekosistemeve Lagunore dhe Pyjore që zënë pjesën më të madhe të Zonave të Mbrojtura në këtë Qark.

Hartimi i planit të masave për parandalimin dhe mbrojtjen e pyje dhe kullotave nga zjarret.
Propozimin e projekteve të ndryshme në dobi të Zonave të Mbrojtura të Qarkut Lezhë për ti shpalosur akoma më bukur vlerat e këtyre zonave si dhe për të lehtësuar punën epërditshme të stafit të AdZM Lezhë.
Promovimin sa më të mirë të zonave për të bërë të mundur thithjen e sa më shumë turistëve kryesisht të huaj duke u treguar atyre vlerat unike që mbartin këto zona, gjë e cila në një farë mënyre është publiciteti më i mirë jashtë kufijve të Shqipërisë.

- Rezultatet kryesore të punës përgjatë vitit:

31 takime me pjesëmarrje të stafit te AdZM Qarkut Lezhë në aktivitete që synojnë promovimin e vlerave te ZM-ve të Qarkut Lezhë.
34 takime me komunitetetet, Kryetar Fshatrash dhe me subjektet që operojnë në territorin e zonave të mbrojtura Qarkut Lezhë për rritjen e gatishmërisë në raste zjarresh, pastrimin sistematik nga ndotjet urbane, parandalimin e rasteve të gjuetisë dhe peshkimit të paligjshëm etj.
Numri i turistëve që kanë vizituar Zonat e Mbrojtura të Qarkut Lezhë gjithsej janë 182481 nga këto të huaj 19546,vendas 162935
Të ardhurat nga shitja e biletave të vizitorëve 454000 lekë.
Të ardhura nga kontratat e dhëna në përdorim 543750lekë
Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur të gjitha të ardhurat nga biletat e postbllokut, të ardhurat nga kontratat e qerasë.

Tabela nr.3: Të ardhurat dhe vizitorët e AKZM Lezhë viti 2021

	Viti 2021
Të ardhurat nga Bileta	454,000
Të ardhura nga kontrata qeraje	543,750
Nr i Vizitorëve Vendas	162,935
Nr i vizitorëve të huaj	19,546
Nr i Vizitorëve Total	182,481

Punuar nga grupi i Klsh-së.

3.Hartimi dhe zbatimi i plan-veprimeve

Nga Adzm janë hartuar, plane mujorenë bazë të urdhrit të strukturuar nr.122 datë 08.02.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM, mbi aktivitetin që ndiqet në lidhje me:
Koordinimi i punës në zyra dhe terren,monitorim në gjuetinë e paligjshme të faunës së egër dhe prerje të paligjshme, i shpendëve emigratore, përpunime të dhënash të mbledhura në terren mbi studime të ndryshme, sistemimi i qendrës Kune Vain, vënia e traut pranë qendrës së vizitorëve në eficencë për pritjen e vizitorëve, censusi i shpendëve në Lagunat e Kune Vain, Laguna e Patokut, dhënie asistence dhe shërbim këshillimor pranë Bashkisë Qarku Lezhë, për Menaxhimin e pyjeveqë shtrihen në këto njësi vendore, përpunimi i të dhënave mujore e vjetore të kadastrave për ndryshimet e ndodhura ose jo, shkëmbime eksperiencë me ADZM e tjera, evidentim i gjendjesfito sanitare të grumbujve në derdhjen e lumit Drin dhe Ishëm për zonën e mbrojtur Patok, Tale dhe Kune Vain.
Në përgjigje të hartimit të planeve mujore janë përgatitur informacionet përrealizimin e detyravetë sektorit të menaxhimit, të cilat konsistojnë në:
-Përpunimin e të dhënave për faunën e egër, të dhëna të marra nga secili ranger i zonës përkatëse që mbulon si dhe kujdesi i veçantë i është kushtuarfaunës së egër në disa raste,
-Takimet informuese dhe ndërgjegjësuese me komunitetin vendas dhe bizneset që operojnë në të katër ZM.

-Krijimin e infrastrukturës së nevojshme,jo vetëm meuniformat por edhe mjete logjistike.
-Promovimin e turizmit gjatë sezonit veror, mbledhja e të dhëna të sakta dhe të nevojshme në lidhje me numrit të turistëve dhe bizneseve që operojnë në të katër ZM, të cilat ndihmojnë për krijimin sa më të mirë të politikave për menaxhimin dhe zhvillimin e turizmit në ZM me potenciale të jashtëzakonshme natyrore, kulturore.
-Kushtimi i vëmendjes së veçantë mediave dhe rrjeteve sociale për pasqyrimin e punës si dhe promovimin e ZM.
- Zhvillimin e aktivitetevetë organizuara për ditë tradicionale dhe për promovimin e turizmit e ditëve mjedisore për promovimin e zonave te mbrojtura.

- Sipas raporteve mjedisore të AdZM Lezhë rezulton se stafi i saj ka marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm trajnimesh, takime, të cilat janë realizuar me projektet e huaja mjedisore që operojnë në vend, me institucionet e specializuara në fushat që prekin mjedisin, me personalitete akademike dhe specialiste të kooperacioneve të huaja për tema në të gjitha fushat mjedisore.

- *Nga stafi i AdZM që ka marrë pjesë në to janë evidentuar vetëm si veprimtari, por nuk ka relacione se si janë reflektuar dhe si kanë ndikuar njohuritë dhe përvojat e marra në këto trajnime në punën menaxhuese të mjedisit të ZM.*

Gjithashtu nga AdZM për vitet 2019, 2020 dhe 2021 janë zhvilluar një numër i madh veprimtarish për edukimin mjedisor dhe aktivitetesh në dite te shënuara mjedisore e turistike me nxënësit e shkollave apo komunitetin vendas të ZM, të cilat janë evidentuar siveprimtari dhe aktivitete,*por nuk janë shoqëruar me materiale mbështetëse dhe dokumente vërtetues të aktivitetit(fotografi apo vidio).*

- Përsa i përket shërbimit këshillimor raportohet se specialistët e Sektorit të Menaxhimit kanëdhënëasistencëteknike në Bashkitë Lezhë, Laç ,Mirditë si dhe të gjitha në të gjitha Njësitë Administrative respektive. Po ashtu, janë zhvilluar disa takime me punonjësit e Drejtorive Pyjore të këtyre bashkive ku u është dhënë shërbim këshillimor për njohjen me aktet ligjore, njohjen dhe zbatiminekërkesaveteknikeshkencorenëmbarështiminepyjevee kullotave,në hartimin e dokumentacionit në raste të rënies së zjarrit dhe të plan-programeve për marrjen e masave efektive për mbrojtjen e pyjeve e kullotave nga zjarri.

Edhe *për veprimtaritë këshillimore të kryera sipas relatimit në raportin vjetor të punës së AdZM nuk ka një dokumentim më të specifikuar që të përshkruaje veprimin e kryer dhe të lërë gjurmën e realizimit të tij.*

- Nga ky institucion mbi bazën e informacioneve mujore për punën e kryer dhe programeve monitoruese janë hartuar raportet e punës vjetore për realizimin e detyrave funksionale dhe përgjegjësive të përcaktuara në VKMe sipërcituar.

Në këto zona veprojnë edhe zhvillojnë aktivitet turistik shumë sipërmarrje private, të cilat thithin shumë turistë dhe realizojnë të ardhura të konsiderueshme, të cilat në prani të vakumit ligjor nuk kontribuojnë në krijimin e të ardhurave për AdZM që administrojnë këto zona të mbrojtura.
-Bashkëpunimi me institucionet shtetërore dhe ato vendore bashkitë, ka qenë i mire për rrjedhojë puna jonë ka patur rritje të vazhdueshme.

Konkluzion: Për këto nuk ka dokumentacion shkresor evidentues për lënien e gjurmës së auditimit, që vërteton kryerjen e këtyre veprimtarive, te cilat janë në kundërshtim me *"Rregulloren e brendshme për organizmin dhe funksionimin' e AdZM", neni 30 pika 1,ku përcaktohet se: Administrata kryen këto detyra dhe shërbimekryesore.**Dokumenton veprimtari,**kërkime shkencore të kryera në territorin e zonës së mbrojtur* ôô.Ndërsa ekzistojnë imai-le për ftesat për takime, trajnime si dhe për programet dhe axhendat e tyre të zhvillimit.

10.Titulli i gjetjes: Mungesa e dokumentacionit vërtetues për kryerjen e veprimtarisë së AdZM Lezhë.

Situata: Nga stafi i AdZM që ka marrë pjesë në to janë evidentuar vetëm si veprimtari, por nuk ka relacione se si janë reflektuar dhe si kanë ndikuar njohuritë dhe përvojat e marra në këto trajnime në punën menaxhuese të mjedisit të ZM.Gjthashtu nga AdZM për vitet 2019, 2020 dhe 2021 janë zhvilluar një numër i madh veprimtarish për edukimin mjedisor dhe aktivitetesh në dite te shënuara mjedisore e turistike me nxënësit e shkollave apo komunitetin vendas të ZM, të cilat janë evidentuar siveprimtari dhe aktivitete,por nuk janë shoqëruar me materiale mbështetëse dhe dokumente vërtetues të aktivitetit(fotografi apo video). Edhe për veprimtaritë këshillimore të kryera sipas relatimit në raportin vjetor të punës së AdZM nuk ka një dokumentim më të specifikuar që të përshkruajë veprimin e kryer dhe të lërë gjurmën e realizimit të tij.

Kriteri:Në kundërshtim kjo, me *"Rregulloren e brendshme për organizmin dhe funksionimin' e AdZM", neni 30 pika 1,ku përcaktohet se: Administra kryen këto detyra dhe shërbime kryesore.....**dokumenton veprimtari,**kërkime shkencore të kryera në territorin e zonës së mbrojtur*ò.

Ndikimi: Kjo mënyrë e mos evidentimit të dokumentacioneve vërtetuese dhe shoqëruese, nuk jep informacionin e saktë rreth kryerjes së detyrave që i përkasin AdZM Lezhë.

Shkaku: Gjatë mbledhjeve, trajnimeve dhe detyrave të AdZM Lezhë, nuk janë evidentuar nga ata, procesverbale, foto, video duke mos i dhënë rëndësinë e duhur mbajtjes së tyre gjatë veprimtarive.

Rëndësia: E ulët.

Rekomandimi: AdZM Lezhë gjatë veprimtarive që ajo kryen, të bëjë të mundur mbajtjen e dokumentacioneve vërtetuese dhe shoqëruese.

4.Në territorin e Qarkut Lezhë janë gjithsej 40 monumente natyre që janë të shpërndara sipas rretheve Lezhë 11, Mirditë 17, Kurbin 12. Një pjesë e këtyre monumenteve janë brenda territorit të Zonave të mbrojtura dhe një pjesë jashtë tyre. Stafi AdZM Qarkut Lezhë zhvillon kontrolledhe monitorime të Monumenteve të Natyrës në të 3 Rrethet Lezhë, Kurbin dhe Mirditë. Objektivi kryesorë i monitorimeve është promovimi i këtyre MN-ve tek turistët që shprehin interes për vizitimin e këtyre objekteve natyrore me vlera të larta turistike. Të gjithë këto monumente vizitohen nga turistë vendas dhe të huaj pasi secili prej tyre ka karakteristikat e tij të veçanta, por ndër më të vizituarat konkretisht për rrethin e Lezhës janë: Ishulli i Kunes, Rera e Hedhun, Pylli rreth kishës së Shën Eufemisë , Lisi i Markatomajve. Në rrethin Kurbin: Gryka e Shkopetit, Shpella e Shenavlashit, Ishulli i Cabokut, Burimi i Vinjollit, Plepi i Bardhe, Gështenja e Vjetër, Rrapi i Daullës. Rrethi Mirditë : Kroi Bardhe, Shpella e Pashës, Guri i Gjonit, Guri Nuses.

6.Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura përgjigjet për realizimine detyrave të mëposhtme:

- vlerësimin e gjendjes ekologjike të burimeve natyrore dhe përpunon planet për ruajtjen dhe rimëkëmbjen e tyre;

  Në lidhje me këtë detyrë AdZM nuk ka bërë në mënyrë të detajuar gjendjen ekologjike të burimeve natyrore, por vetëm ka konstatuar problematikat. Nuk ka përcaktuar në mënyrë të hollësishme shtrirjen në zonat e mbrojtura të ndotjeve në gjithë territorin por vetëm në raste sporadike të inspektimit. Si rrjedhim e kësaj nuk ka përpunuar plane për rimëkëmbjen e burimeve natyrore ngandotjet ekologjike, pasi mungojnë fondet, megithëse ruajtja dhe rimëkëmbja e tyre janë parashikuar në planin e menaxhimit 3-vjecar si dhe kostot për to.
- mban dhe përditëson regjistrin e zonave të mbrojtura, skedarët dhe krijon bazën e të dhënave dixhitale të rrjetit ekologjik të vendit;

  Nga AdZM nuk është bërë përditësimi i regjistrit të zonave të mbrojtura, skedulimi i tyre dhe krijimi i

të dhënave dixhitale të rrjetit ekologjik të vendit;

- propozon dhe zbaton masat dhe programet për ripërtëritjen e mjediseve të dëmtuara, të shkatërruara apo të degraduara të zonës së mbrojtur;
  Mungojnë nga AdZM propozimet për zbatimet e masave dhe programeve për ripërtëritjen e mjediseve të dëmtuara, të shkatërruara dhe të degraduara të zonave të mbrojtura, megjithëse ato janë konstatuar dhe janë programuar për ripërtëritje në planet e menaxhimit afatmesëm.Në këto plane menaxhimi për to janë përllogaritur kosto të veçanta për ripërtëritjet e nevojshme dhe strukturat përgjegjëse, po mungon mbështetja me fonde nga AKZM dhe Ministria e linjës që menaxhon projektet si dhe në fakt kjo administratë nuk administron fonde.
  Kjo administratë nuk ka kapacitete ekonomike dhe njerëzore për realizimin e detyrave të përcaktuara në ligj dhe rregullore si: identifikimin dhe mbrojtjen e zonave të populluara me llojet e florës dhe të faunës së egër si dhe rrugët e emigrimit;mbrojtjen e zonave të riprodhimit, të pushimit dhe të ushqimit të faunës së egër;
  ndjek realizimin e programeve vjetore të monitorimit të zonës së mbrojtur, në bashkëpunim me institute e katedra të specializuara, të ngarkuara me monitorimin dhe publikimin e të dhënave;
  përcakton vendet e vendosjes së tabelave dhe shenjave treguese;
  Nga AdZm janë vendosur tabela treguese dhe informuese me mbështetje të Ministrisë së Mjedisit.
  kontribuon në grumbullimin e tarifave për përdorimin dhe shfrytëzimin e burimeve bio-natyrore të zonës së mbrojtur;
  Kontributi i AdZM për vjeljen e të ardhurave nëpërmjet tarifave është në vlera minimalepasi ka vakum ligjor për ligjin e vjetër dhe ndryshimet e bëra në ligji nuk ka janë miratuar me akte nënligjore tarifa të posaçme për shfrytëziminnga subjekte të ndryshme qe ushtrojnëaktivitetnë zonave të mbrojtura. Megjithatë nuk është zgjidhur nga Qeveria Qendrore, problemi i vendosjes së infrastrukturës së nevojshme dhe gjetjen e rrugëve dhe mjeteve për realizimin e të ardhurave,nga institucionet që menaxhojnë zonat e mbrojtura.
- kontakton përdoruesit dhe vizitorët e të gjitha llojeve; Administrata për menaxhimin e qëndrueshëm të zonës së mbrojtur duhet të bashkëpunoje me Subjektet e biznesit (territoret apo dhe veprimtaritë e të cilëve përfshihen në zonën e mbrojtur ose në atë buferike) për kryerjen e veprimtarive të ndryshme me karakter ekonomik dhe social si bujqësia tradicionale, agro-pylltaria dhe të gjitha aktivitetet artizanale, kulturore, sportive dhe shërbimet turistike.
- përdor me frytshmëri fondet për mirëmbajtjen e zonës së mbrojtur; dokumenton veprimtaritë, investimet, kërkimet shkencore të kryera në territorin e zonës së mbrojtur;
  AdZM nuk administron fonde për mirëmbajtjenzonave të mbrojtura, pasi fondet e limituara për ushtrimin e funksioneve të monitorimit dhe menaxhimit te AdZm administrohen , menaxhohen dhe evidentohen përdorimi i tyre si për mirmabjtje dhe investime nga AKZM. Këtë fakt e vërtetojnë dhefinancimet e investimevemodeste të kryera për funksionimin e AdZM Lezhësi; ndërtimi i qendrës për vizitorët në Kune Vain, financuar nga buxheti i shtetit ; vendosja e tabelave informuese, treguese, promovuese në të gjitha zonat e mbrojtura financuar nga buxheti i shtetit; Blerje pajisje zyrash dhe uniforma personelit të financuar nga projektiNatural.
- organizon sistemin e vrojtimit dhe sinjalizimit për zonën e mbrojtur;
  Kjo detyrë realizohet sipas përcaktimeve të plan-veprimeve mujore si dhe nga rengersat qëfunksionojnë në pikatpërcaktuara gjatë gjithë periudhës së punës në AdZM
- përgatit dhe publikon çdo fund viti raportin vjetor të gjendjes së zonës të mbrojtur dhe e paraqet në AKZM, si dhe në njësitë e qeverisjes vendore;

AdZM në fund të vitit përgatitet raporti i punës së kryer, i gjendjes së ZM dhe problematikave të dala, por nuk jepen rrugët e zgjidhjes dhe nuk hartohen plan masash, por përcaktohen në të sfidat për periudhën e ardhshme. Këto raporte depozitohen pranë AKZM, por nuk publikohen dhe nuk i dërgohet Bashkisë Lezhë për bashkërendimin e punës për zgjidhjen e problematikave.

- bashkëpunon me institucione kërkimore shkencore, me komunitetin për mbrojtjen e zonës së mbrojtur dhe ruajtjen e biodiversitetit të tij;
- organizon, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, me institucionet kërkimore-shkencore, me institucionet arsimore e kulturore, me komunitetin, etj, veprimtari ndërgjegjësuese dhe bën botime të ndryshme, për të bërë të njohura vlerat e zonës së mbrojtur;
- përgjigjet dhe mirëmban qendrat e informimit e pritjes së vizitorëve dhe organizon veprimtaritë informuese, edukuese dhe vizitat ekoturistike;
- bashkërendon festimin e ditëve dhe ndodhive mjedisore që lidhen me zonën e mbrojtur, veprimtaritë informative dhe edukative.

AdZM në lidhje me punën e saj kërkimore-shkencore,veprimtarinë ndërgjegjësuese dhe përgjegjësisë për mirëmbajtjen e qendrave të informimit të pritjes dhe organizimit të guidës së vizitorëve bashkëpunon meprojekte të ndryshme e institucione akademike, gjë të cilën e vërtetojnë organizimet e takimeve, ftesat për trajnimet,pjesëmarrja në konferenca e kumtesa shkencore për mjedisin,realizimi i aktiviteteve në ditë të shënuara të sferës mjedisore .

-Për realizimin e këtyre aktiviteteve nga AdZM janë ndjekur këto hapat si:-Përcaktimi i temës së aktivitetit nëpërmjet konsultimit të donatorit me AKZM dhe AdZM;-Identifikimi i aktorëve që do të marrin pjesë në trajnim;Caktimi i datësdhe vendit ku do të zhvillohet aktiviteti;-Ftesa e pjesëmarrësve;Zhvillimi i aktivitetit(prezantime,diskutime, ushtrime teorike dhe praktike sipas rastit)

-Për Ȑorkshopet e organizuara tre ditore për formimin profesional i personave të rojeve mjedisore qe do të merren me trajnimin e vazhdueshëm te komunitetit, janë ndjekur këto hapa si: janë bërë prezantimet lidhur me zbatimin e ligjshmerise;evidentimin dhe raportimin e ngjarjeve të paligjshme nëzonën e mbrojtur;Hartimi i dokumenteve ligjore;menyra e raportimit;reagimi i rojeve mjedisore ne rast rënie zjarri;perdorimi i instrumenteve gjate monitorimit(GPS,dylbiteleskop,kamera kurth,teleskop etj)dhe orientimi nëpërmjet hartave topografike dhe ortofotove; zbatimi praktik i teorisë sipas prezantimeve te bëra për rojet mjedisore që të marrin njohuri te plota për realizimin e detyrave qe i ngarkon ligji;zhvillimi i veprimeve praktike me grupe pune për veprimet ne terren për te gjitha situatat qe paraqiten gjate kryerjes se detyrës, certifikimi për rojet mjedisore dhetrajnerëvepërçdo qark.

-Trajnimet janëzhvilluar me eksperte ndërkombëtare dhe eksperte kombëtar te AdZM-ve si nga projekti NATURAL.Këto trajnime janë kryer për planifikimin dhe hartimin e projekteve, për të cilat janë dhënë udhëzime se si do të hartohen dhe çfarë duhet të përmbajnë si: gjithë elementet qe duhet tëpërmbajënjë projekt; temat më të rëndësishme që duhen zhvilluar në zonat e mbrojtur,rëndësinë jetike që kanë këto projekte për zonat e mbrojtura;mënyra e hartimit të projekteve në zonën e mbrojtur, shkëmbimi i eksperiencave më të mira në këtë proces; certifikimi i ekspertëve për hartimin e projekteve për çdo qark.

<u>AdZM ka kontaktuar dhe evidentuar në relacionet e realizimit të plan-veprimeve problematika, të cilat kanë të bëjnë me:</u>

- Flora dhe fauna është e kërcënuar për vete faktin se brenda zonave të mbrojtura jetojnë një numër i lartë banorësh që me aktivitetin e tyre, po cenojnëkëto vlera si dhe po dëmtojnë biodiversitetin.
- Tendenca e njerëzve për gjueti te paligjshme,prerje të paligjshme apo aktivitete që bien ndesh me planet apo draft-planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura.

- Mos menaxhimi i mbeturinave urbane ne zonat turistike brenda zonës së mbrojtur nga ana e bashkive po cenon rende këto zona duke dhënë një impakt negativ në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe mbrojtjes së biodiversietit.
- Tendenca e vazhdueshme e OJF për të zhvilluar projekte dhe aktivitete në zonat e mbrojtura pa vënë në dijeni administratën e zonave të mbrojtura shpesh here zhvillojnë tënjëjtat gjera në tënjëjtin vend dhe impakti i këtyre projekteve është minimal ose i papërfillshëm.
- Një pjesë stafit për shkak tëpa eksperience dhe pa arsimin e duhur puna e tyre ka qenë më të meta në njohjen dhe zbatimin e ligjit dhe të rregulloreve, disiplinën efektivitetin, profesionalizmin, seriozitetin , etiken në pune.
- Pavarësisht bashkëpunimit të mirë në punën eAdZM , ku njëra monitoron dhe konstaton dhe tjetra në procedon, bën shumë të vështire hartimin e dokumentacionit në kushtet e flagrancës dhe shton burokracinë ne ekzekutimin ë rasteve te paligjshme.

Pika 4. Mbi auditimin e procedurave të vetë monitorimit dhe monitorimit të mjediset në zonat e mbrojtura.

Raportet e vet monitorimit për subjektet që kanë lidhur kontratë me AdZM Lezhë **.**

Referuar Ligjit Nr.81/2017 ñ Për zonat e mbrojturaò dheUrdhrit Nr. 129 datë 23.06.2016ñ Për miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontrata qiraje të sipërfaqeve në zonat e mbrojturaò janë nënshkruar 8 kontrata mes Administratës së zonave të mbrojtura Lezhë dhe subjekteve të ndryshme.

1. Subjekti ñ R.L.ñ me numër nipti: M.....K , me aktivitet ñ Instalim të njësive me konstruksion vetëm prej druri për nevoja të çastit, e përkohshme pa themele , me material të çmontueshëm , pa përdorur strukturë betoni ò me vendodhje në zonën e mbrojtur Patok-Fushë Kuqe- Ishëm. Kontrata është1 vjeçare duke filluar nga data 02.07.2020 deri në datën 01.07.2021. Kontrata e qirasë ndërmjet Administratës së zonave të mbrojtura Lezhëdhe subjektit ñ R.L. ñ mban Nr. 154 prot., datë 02.07.2021 . Objekti i kontratës është dhënia me qira sipërfaqen prej 0.12 ha.

2**.** Subjekti ñN.C.ò me numër nipti L.....L, me veprimtari ñ Instalim të njësive me konstruksion vetëm prej druri për nevoja të çastit , e përkohshme , pa themele, me material të çmontueshëm , pa përdorur strukturë banimi betoniò ,me vendndodhje Patok ï Fushë Kuqe- Ishëm. Kontrata është 1 vjeçare duke filluar nga data 18.9.2020 deri në datën 17.09.2021.Kontrata e qirasë ndërmjet Administratës së Zonave të Mbrojtura Lezhë dhe subjektit ñN.C.ñ mban Nr. 147 prot. , datë 18.09.2021 . Objekti i kontratës është dhënia me qira sipërfaqen prej 0.550 ha.Statusi i subjektit ñN. C. ò në ekstraktin e regjistrit tregtar është aktiv.

3. Subjekti ñA.L.ò , me numër nipti L.....G, me aktivitet ñ Instalim të njësive me konstruksion prej druri të çmontueshme për qëllime turistike pa cenuar vlerat turistike, pa cenuar vlerat natyroreò , me vendodhje Kuin-Vain-Tale. Kontrata është1 vjeçare duke filluar nga data 12.7.2019 deri në 12.07.2020.Sipërfaqja e dhënë me qira është 6300 m 2 . Kontrata e qirasë ndërmjet Administratës së Zonave të mbrojtura Lezhë dhe subjektit ñA. L.ò mban nr.93 prot. , datë 12.7.2019 . Statusi i subjektit ñA. L.ò në ekstraktin e regjistrit tregtar është aktiv.

4. Subjekti ñS.V.ò me numër nipti L.....U, me veprimtari ñinstalimi të njësive me konstruksion vetëm prej druri për nevoja të çastit , e përkohshme , pa themele , me material të çmontueshëm , pa përdorur strukturë betoni ñme vendndodhenë Patok-Fushë Kuqe ï Ishëm. Kontrata është ëme afat 1 vjeçar duke filluar 08.01.2021 deri në datën 07.01.2022. Sipërfaqja është 0.42 ha . Kontrata e qirasë ndërmjet subjektit dhe AdZM Lezhëmban Nr.1 prot., datë 08.01.2021.Statusi i subjektit ñS. V.ò në ekstraktin e regjistrit tregtar është aktiv.

5.Subjekti ñM.M.ò me numër nipti K.....U, me aktivitetò Instalimi e njësive portative me konstruksion druri për qëllime turistike pa cenuar vlerat natyrore të Lagunës ñme vendndodhjenë zonën e mbrojtur Patok-Fushë Kuqe-Ishëm. Kontrata është 5 vjecare duke filluarnga viti 22.02.2017-22.02.2022.Sipërfaqja është prej 2000 m2 . Kontrata e qirasë ndërmjet subjektit ñ M. M.ò dhe AdZM Lezhë mban Nr. 50 prot. datë 22.02.2017. Statusi i subjektit ñM.M.ò në ekstraktin e regjistrit tregtar është aktiv.

6.Subjekti ñL. N.ò me numër nipti K.....U me aktivitet ñ Instalimin e njësive portative prej druri pa cënuar vlerat natyrore ñ me vendndodhje Patok-Fushë Kuqe- Ishëm. Kontrata është 5 vjeçare duke filluar nga data 4.11.2016 deri në 04.11.2021. Kontrata e qirasë ndërmjet AdZM Lezhë dhe subjektitñ L.N. ñ mban Nr. 154 prot. , datë 04.11.2016. Objekti i kontratës është dhënia me qira e sipërfaqes prej 10000 m 2.

7.Subjekti ñM. D.ò me numër nipti L.....H me aktivitetñ Instalimin e objektit me strukturë prej druri , e çmontueshme pa themel për qëllime turistike pa cenuar vlerat natyroreñ me vendndodhje Patok -Fushë Kuqe-Ishëm . Kontrata është 1 vjeçare duke filluar nga data 29.12.2020 deri në 28.12.2021 .Kontrata e qirasë ndërmjet AdZM Lezhë dhe subjektitñ M.D. ñ mban Nr. 204/1 prot. , datë 29.12.2020. Objekti i kontratës është dhënia me qira sipërfaqen prejh 1000 m

8.Subjekti ñO.Dòme numër nipti L.....K me aktivitet ñ Instalimin të njësive me konstruksion prej druri , e çmontueshme pa themel për qëllime turistike pa cenuar vlerat natyroreñ me vendndodhje Kune-Vain-Tale . Kontrata është 1 vjeçare duke filluar nga data 29.12.2020 deri në 28.12.2021 . Kontrata e qirasë ndërmjet AdZM Lezhë dhe subjektitñO. D.ñ mban Nr. 205 prot. , datë 29.12.2020.Objekti i kontratës është dhënia me qira e sipërfaqes prej 100 m 2.

Konkluzione: Nga auditimi rezultoi që 8 subjektet e sipërcituara që kanë lidhur kontratë qiraje me Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë, nuk kanë dorëzuar raportet e vetëmonitorimit kjo në kundërshtim me Ligjin ñ Për Zonat e Mbrojtura ñ, Nenet 60 dhe 66 ñ *Monitorimi i veprimtarisë në zonat e mbrojtura*ò , *Subjektet, që kryejnë veprimtari të lejuar në zonat e mbrojtura mjedisore, vete monitorojnë aktivitetin që ushtrojnë, sipas kërkesave të specifikuara nga AKZM-ja në zbatim të programit të monitorimit të zonës dhe ia njoftojnë AdZM-së përkatëse të dhënat që dalin nga vete monitorimi*ò ñInspektimi ñPika 4/a ñ*Administrata e zonës së mbrojtur: a) kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për zonat e mbrojtura, florën e faunën e egër dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në zonën e mbrojtur nga subjektet private e publike, juridike e fizike, si dhe i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së heqjen e certifikatës/zgjidhjen e kontratës në rastet kur subjektet veprojnë në kundërshtim me këto dispozit*aò.

Administrata e zonave të mbrojtura Lezhë nuk rezultonqë ti ketë propozuar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, zgjidhjen për asnjë kontratë për subjektet e mësipërme që kanë vepruar në kundërshtim me ligjin ñPër zonat e mbrojturaò.

11.Titulli iGjetjes: Hartimi i programeve vjetore të punës

Situata:Administrata e zonave të mbrojtura Lezhë , për periudhën e audituar 01.01.2019-31.12.2021 nuk ka hartuar programet vjetore të punës për rojet mjedisore (rangersat) .

Kriteri: Rregullore e Brendshme ñPër Organizimin dhe funksionimin të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës rajonale të zonave të mbrojturaò.

Ndikimi/Efekti: AdZM Lezhënuk ka mënjanuar sa më shpejt që të jetë e mundur shfrytëzimin ose veprimtaritë e paligjshme në të gjithë zonën, sigurimin dhe respektimin e karakteristikave ekologjike, biologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike apo estetike, të cilat kanë ndikuar në dhënien e statusit të zonës së mbrojtur.

Shkaku: Mungesë objektivash dhe mos-organizim i punës.
Rëndësia: E mesme
Rekomandimi: AdZM Lezhë të hartojë programet e punës vjetore për rojet mjedisore (rangersat) dhe të përgjigjet për realizimin e detyrave në afat dhe në cilësinë e duhur. Programet e punës vjetor të përgatitet mbi bazë risku, duke i dhënë rëndësi mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit në të gjitha pjesët përbërëse të tij.
Afati: Në vazhdimësi
12.Titulli iGjetjes: Inspektimet e kryera në zonat e mbrojtura Lezhë
Situata: Administrata e zonave të mbrojtura Lezhë , në3 raste për dënimet apo marrjet e vendimeve për kundërvajtje administrative për periudhën e audituar nuk rezulton të ketëpërcaktuar vlerën e dëmit.
Kriteri: VKM nr.128 datë 13.2.2020 ñPër përcaktimin e vlerës së dëmit të shkaktuar në zonat e mbrotjura mjedisore , mënyrën e vlerësimit,mbledhjes dhe administrimit të saj.
Ndikimi/Efekti: Të gjitha procesverbalet e mbajtura nga rojet mjedisore mbetennëfazën e konstatimit dhe nuk është ndjekur procedura e mëtejshme.
Shkaku: Mbas shfuqizimit të Ligjit nr. 8906 datë 06.06.2002 dhe hyrjen në fuqi i Ligjit me nr. 81,datë 04.05.2017 ñPër Zonat e Mbrojtura ñnuk u ndryshua formati i modelit për procesverbalet për kundërvajtjet administrative.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: AdZM Lezhë të kërkojë përmirësime ligjore në drejtim të caktimit dhe zbatimit për të marrë masa për kryerjen e inspektimeve dhe të ndjekë të gjitha rrugët e duhura deri në nxjerrjen e vendimeve për masat administrative. AdZM Lezhë të vlerësojë dëmin e shkaktuar në zonën e mbrojtur Lezhë, bazuar në metoda standarte të matjes së sasisë apo sipërfaqes së dëmtuar.
Afati: Në vazhdimësi
13.Titulli igjetjes: Raportet e vetë monitorimit në zonat e mbrojtura Lezhë për subjektet që kanë lidhur kontratë qiraje.
Situata: Në 9 subjekte që kanë lidhur kontratë qiraje me AdMZ Lezhë rezulton që asnjëra prej tyre nuk ka dorëzuar pranë AdMZ Lezhë raportet e vet monitorimit.
Kriteri: Ligjinr.81/2018 ñPër Zonat e Mbrojturaò, neni 60, pika 2 ñMonitorimi i veprimtarisë në zonat e mbrojturaò .
Ndikimi/Efekti: AdZM Lezhë nuk ka informacion për subjektet që kanë lidhur kontratë qiraje dhe njëkohësisht ruajnë mjedisin dhe kujdesen për një zhvillimin e qëndrueshëm të tij.
Rëndësia: E mesme
Rekomandim: Administrata e zonave të mbrojtura Lezhë duhet tõ propozojë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, zgjidhjen e kontratave për subjektet që nuk dorëzojnë pranë AdZM raportet e vet monitorimit.
Afati: Në vazhdimësi
-Pika5.Auditim mbi bashkëpunimin me organet e tjera të kontrollit për kryerjen e inspektimeve e kontrolleve të përbashkëta në zonat e mbrojtura Lezhë. Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimittë miratuar nga kryetari i KLSHï së, me nr. 1275/1 prot., datë 26.11. 2021, për periudhën 01.01.2019 deri në 31.12.2021 , mbajtur më datë 04.02.2022, mbi bashkëpunimin me organet e tjera të kontrollit për kryerjen e inspektimeve e kontrolleve të përbashkëta u shqyrtua dhe u verifikua dokumentacioni i vënë në dispozicion, në zbatim të Ligjit Nr.81/2017 ñPër Zonat e Mbrojturaò dhe Rregullores e brendshme ñPër organizimin dhe funksionimin të Agjencisë Kombëtare të Zonave të

Mbrojtura dhe Administratës rajonale të zonave të mbrojturaò.Referuar Nenit 30 të rregullores së brendshme të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

➢ **Administrata për menaxhimin e qëndrueshëm të zonës së mbrojtur duhet të bashkëpunojë me:**

Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, Inspektoratin e Peshkimit, Policinë e Shtetit, Inspektoratin e ndërtimit, atë tatimore e doganore, sipas përgjegjësive dhe detyrave të caktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga auditimi i ushtruar për periudhën 01.01.2019 -31.12.2021,Administrata e zonave të mbrojtura Lezhë ka hartuar program bashkëpunimi me Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë që mban numër 20 prot.,datë 24.02.2021 ñ Për bashkëpunimin ndër-institucional për parandalimin e aktiviteteve të kundërligjshme në territorin e zonave të mbrojtura Kune-Vain-Tale , Bërzani , rrethi Lezhë . Qëllimi i këtij programi bashkëpunimi është:

-kontrolli dhe monitorimi i të gjithë veprimtarive që zhvillohen brenda territorit të zonave të mbrojtura

-zënien me anë të mbushjes të sipërfaqeve të menaxhuara mjedisore;

-prerjen dhe dëmtimin e materialit drusor;

-gjuetia dhe peshkimi i paligjshëm në zonë;

-kullotja me anë të bagëtive;

-tendencat për kultivimin e bimëve narkotike;

-ndotja e sipërfaqeve mjedisore;

-kontrolli dhe monitorimi i të gjitha sipërfaqeve të dhëna në përdorim;

-zbatim i kontratave të subjekteve të lidhura e AdZM Lezhë Qarku Lezhë .

Gjithashtu, AdZM Lezhë ka shkëmbyer informacion meInspektoratin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, Qarku Lezhë. Referuar ligjit nr. 90/2012 ñPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetëroreò, kreu V, Neni 24, pika a ñ Bashkëpunimi dhe bashkërendimi në Administratën Shtetëroreò,

Institucionet e administratës shtetërore:

a) i sigurojnë njëri-tjetrit të dhëna, informacione dhe ndihmën e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tyre;

Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë një kopje të procesverbaleve të kundërvajtjeve administrative, ia ka dërguar Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve.

Nga AdZM nuk ka dokumentacion të lënies gjurmë për bashkëpunimin meinstitucionet e tjeranë lidhje me kontrollin e zbatimit e rregullave, planin e menaxhimit dhe dispozitave ligjore për ruajtjen dhe përdorimin e burimeve natyrore.

b) Pronarët privatë apo përdoruesit, prona e të cilëve është përfshirë në zonën e mbrojtur, për planifikimin, ruajtjen dhe përdorimin e burimeve natyrore, duke zbatuar me përpikmëri rregullat e caktuar, planin e menaxhimit dhe programet e hartuara për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

Nga AdZM nuk ka dokumentacion të lënies gjurmë për bashkëpunimin me privatët që përdorin dhe ushtrojnë aktivitetet e tyre në zonat e mbrojtura në lidhje me kontrollin e zbatimit e rregullave, planin e menaxhimit dhe dispozitave ligjore për ruajtjen dhe përdorimin e burimeve natyrore.

c) Organet e pushtetit vendor, duke respektuar pavarësinë e tyre dhe kompetencat e përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi.

Nga AdZM Lezhë është hartuar Plani i masave ñPër parandalimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri në territorin e zonave të mbrojtura të rrethit të Mirditës për vitin 2021 ñ me Bashkinë Mirditë me nr. 56 prot ., datë 07.04.2021, ku specifikohet se:

-AdZM Lezhë në zbatim të kuadrit ligjor ka marrë masa për parandalimindhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave në territorin e zonave të mbrojturaduke ngritur një shtab monitorimi për konstatimin , sinjalizimin,evidentimin dhe marrjen e masave për shuarjen e zjarreve. Personi përgjegjës do të bëjë raportimin në AKZMmbi mbajtjen në gatishmëri të personelit në raste të rënies së zjarrit në zonën e mbrojtur Patok-Fushë Kuqe .

-Nga AdZM Lezhë është hartuar Plani i masave ñPër parandalimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri në territorin e zonave të mbrojtura të rrethit të Mirditës për vitin 2021 ñme Bashkinë Lezhëme Nr. 57 prot , datë 07.04.2021datë ku specifikohet se:

AdZM Lezhë në zbatim të kuadrit ligjor ka marrë masa për parandalimindhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave në territorin e zonave të mbrojturaduke ngritur një shtab monitorimi për konstatimin , sinjalizimin, evidentimin dhe marrjen e masave për shuarjen e zjarreve . Personi përgjegjës do të bëjë raportimin në AKZM mbi mbajtjen në gatishmëri të personelit në rast të rënies së zjarrit në zonën e mbrojtur Patok- Fushë Kuqe .

Ndërsa me Bashkinë Kurbin, Administrata e Zonave të Mbrojtura nuk ka hartuar plan masash për parandalimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri në territorin e zonave të mbrojtura të rrethit Lezhë për vitin 2021 .

d) Subjektet e biznesit (territoret apo dhe veprimtaritë e të cilëve përfshihen në zonën e mbrojtur ose në atë buferike) për kryerjen e veprimtarive të ndryshme me karakter ekonomik dhe social si bujqësia tradicionale, agro-pylltaria dhe të gjitha aktivitetet artizanale, kulturore, sportive dhe shërbimet turistike.

Nga AdZM nuk ka dokumentacion të lënies gjurmë për bashkëpunimin me privatët që përdorin dhe ushtrojnë aktivitetet e tyre me karakter ekonomik dhe social në zonën e mbrojtur ose në atë buferike.

e) Me Agjensitë Rajonale të Mjedisit dhe Këshillin e Baseneve të Ujëmbledhësve, duke koordinuar veprimet për ruajtjen e mjedisit dhe të baseneve ujëmbledhëse të lumenjve dhe liqeneve.

f) Bordet e Kullimit dhe shoqatat e përdorimit të ujërave, duke koordinuar problemet e kullimit dhe të ujitjes;

g) OJF-të mjedisore për ndërgjegjësimin e komunitetit, të promovimit të vlerave ekoturistike e natyrore të peizazhit;

h) Agjencitë turistike, të cilat promovojnë turizmin lokal, nëpërmjet përfshirjes së peizazhit të mbrojtur në turret turistike;

Në bashkëpunimet me OJF mjedisore janë kryer takime dhe trajnime me rojet trajnuese për komunitetin vendas, por nuk ka bashkëpunim me agjencitë turistike, për promovimin e turizmit për rritjen e numrit të turistëve dhe të ardhurave të zonës, por janë mjaftuar vetëm me punën sqaruese-këshillimore-promovuesee të ngritura në pikat turistike të zonave të mbrojtura.

i) Qendrën Operacionale Ndër dikasteriale Detare për ruajtjen dhe zbatimin e ligjshmërisë dhe të konventave ndërkombëtare për zonat e mbrojtura detare.

j) Institute e katedra të specializuara dhe institucionet kërkimore shkencore, të ngarkuara me monitorimin dhe publikimin e të dhënave, për mbrojtjen e zonës dhe ruajtjen e biodiversitetit të tij.

Nga AdZM nuk ka dokumentacion të lënies gjurmë për bashkëpunimin me Qendrën operacionale Ndërdikasteriale detaredhe me institucionet kërkimore shkencore të ngarkuara me monitorimin dhe publikimin e të dhënave, për mbrojtjen e zonës dhe ruajtjen e biodiversitetit të tij .

Konkluzion: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë nuk ka bashkëpunuar me institucionet e kërkuara në rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Nenin 30 të rregullores së brendshme të Agjencisë Kombëtare të

Zonave të Mbrojtura.
14.Titulli igjetjes: Bashkëpunimi mes AdZM Lezhë dhe institucioneve të tjera ligj zbatuese.
Situata: Nuk ka gjurmë të bashkëpunimit me institucionet si: inspektoratin e peshkimit , inspektoratin e ndërtimit, tatimet, institucionet kërkimore shkencore, institute dhe katedra të specializuara etj.
Kriteri:Në kundërshtim me rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.
Ndikimi/Efekti: Mungesa e bashkëpunimit me institucionet ligj zbatuese ka sjellë monitorim jo efecientë në zonat e mbrojtura Lezhë.
Shkaku: Mungesa e programeve të bashkëpunimit me institucionet ligj zbatuese.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: AdZM Lezhë të marrë masa dhe të bashkëpunojë sipas legjislacionit në fuqi, me të gjitha institucionet ligjzbatuse për parandalimine aktiviteteve të paligjshme në zonat e mbrojtura.
Afati: Në vazhdimësi.

Shënim: *Nga ana e subjektit të audituar nuk ka pasur kontestime dhe nuk janë paraqitur observacione.*

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontributit për vjeljen e të ardhurave konstatojmë se ato përfaqësohen nga: Të ardhura në vlera jo të larta i 8 kontratave të përkohshme me afat 1-vjecare më të drejtë përsëritje. Hyrje në një pikë kalim të vizitorëve në Zonat e Mbrojtura. Nga Ministria e linjës dhe AKZM nuk janë miratuar tarifa për vjeljen e të ardhurave nga vizitorët në pikat turistikedhe monumentet natyrore me vlera historike dhe kombëtare. Gjithashtu mungon infrastruktura për ngritjen e pikave të kalimit të vizitorëve,pasi ka disa rrugë hyrëse në një pikë turistike.Nga Ministra e Turizmit dhe Mjedisit nuk është zgjidhur, problemi i vendosjes së infrastrukturës së nevojshme dhe gjetjen e rrugëve dhe mjeteve për realizimin e të ardhurave, nga institucionet që menaxhojnë zonat e mbrojtura në kundërshtim me VKM nr.102 datë 04.02.2015ñPër krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të MbrojturaòKreu III pika 2,me ligjin nr. 81/2017 datë 04.05.2017, neni 17 pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1faqe 9-16 të Raportit përfundimtare të Auditimit)*
1.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në bashkëpunim me AKZM Tiranë, të kërkojë pranë Ministrisë së Linjës për përcaktimin e vendosjen e pikave të kalimit në pjesët turistike të Zonave të mbrojtura, si dhe të japë kontributin e saj në hartimin e projekt-drafteve për miratimin e tarifave vizitore që do të përdoren për vjeljen e të ardhurave nga turistët vizitorë të ZM.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryerkonstatohet se në tre raste ishin miratuar kontrata në kundërshtim memon e hartuar nga drejtoria e projektit AKZM, ku theksohet se *vend grumbullimi i mbetjeve urbane që mund të gjenerohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë dhe mënyrën e largimit tyre*

nga zona e mbrojtur të bëhet sipas një grafiku të miratuar respektivisht nga AdZM Lezhë dhe Bashkia përkatëse.

-Në vitin 2021 janë lidhur 4 kontrata të cilat janë në vazhdim nga vitet e mëparshme por nuk kanë plan menaxhimi sipas përcaktimeve në ligj, nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, nuk janë hartuar plane menaxhimi edhe pse AdZM, ka venë ne dijeni ministrinëò.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1,faqe16--19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi:Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhënëbashkëpunim me AKZM dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, të marrin masa përgarantimin e planeve të menaxhimit sipas përcaktimeve në ligj, si dhe në çdo rast kontratat e nënshkruara me të tretët të jenë në përputhje me memo dhe urdhrat e Titullaritò.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.Gjetje nga auditimi:Në zonat e mbrojtura ushtrojnë aktivitet individ privat banorë të zonës si dhe një numër i konsiderueshëm biznesesh, që shfrytëzojnë këto burime fitimprurëse. Nga AdZM ka evidentim dhe regjistrim të subjekteve të biznesit të cilat kryejnë veprimtari të ndryshme me karakter ekonomik dhe social si bujqësi, kulturore, dhe shërbimet turistike. Nuk ka të dhëna për to në lidhje me aktivitetet e tyre (licencimi,koha e ushtrimit të aktivitetin, mendime, territoret apo dhe veprimtaritë e të cilëve përfshihen në zonën e mbrojtur ose në atë buferike) në kundërshtim me neni 9 pika 5i ligjet nr. 81/2017 ñPër Zonat e Mbrojturaò.

-Nga Qeveria Qendrore dhe Pushteti Vendor nuk është zgjidhur problem i taksimit specifik tëpersonave fizik dhe juridik që shfrytëzojnë vlerat natyrore, historike dhe kulturore të zonave të mbrojtura, nëpërmjet përfshirjes së tyre në paketat fiskale të tyre.ò*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3,faqe9-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë, në bashkëpunim me AKZM Tiranë, të kërkojë pranë Ministrisë së Linjës për krijimin e urave lidhëse meNjësitë e Qeverisjes Vendore, që të jetë pjesë e paketës fiskale të qeverisë apo e Bashkive dhe taksa specifike për shfrytëzimin e peizazhit natyror të ZM, si burim të ardhurash, për AKZM dhe AdZM rajonale për krijimin e fondeve për mirëmbajtjen dhe ushtrimin e funksioneve të monitorimit e menaxhimit të zonave të mbrojtura.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë, nuk dispononinudhëzimet përkatëse për përcaktimin e aktorëve pjesëmarrës dhe procedurave që duhen ndjekur për peshkimin në kuadër të menaxhimit të ujërave burime natyrore. Kështu funksionimi i inspektimit të peshkimit në ZM, duhet të përcaktohet edhe nga Ministria e Turizmi dhe Mjedisit. Ndërsa në kontratën e lidhur në mes Ministrisë së Bujqësisë dhe Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit, është parashikuar që inspektimin e kryen me mjetet e veta Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, gjë e cila është në konflikt interesi, pasi kjo organizatë nuk mund të kontrollojë aktivitetin e vet. Përjashtimi nga kontrata e Ministrisë së Mjedisit dhe AdZM ka sjellë mos kontrollin dhe mos parandalimin e peshkimit të paligjshëm, duke shmangur rolin mbrojtës të AdZM në ruajtjen Kune-Vain, Tale dhe Shëngjin. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.81/2-017 ñPër zonat mbrojturaò datë 04.05.2017 neni 34,pika 1,2.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3,faqe28-42 të Raport Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit e Turizmit dhe Ministrinë e Bujqësisë të hartojnë një marrëveshje të përbashkët për kontrollin dhe ruajtjen e zonave të ndaluara për peshkim dhe parandalimin e peshkimit të paligjshëm në ZM.

Menjëherë

5.Gjetje nga auditimi: Në zonat e mbrojtura Lezhë, flora dhe fauna është e kërcënuar për vetë faktin se brenda zonave të mbrojtura jetojnë një numër i lartë banorësh, që me aktivitetin e tyre cenojnë këto vlera si dhe dëmtojnë biodiversitetin. Nga Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhëmungojnë propozimet për zbatimet e masave dhe programeve për ripërtëritjen e mjediseve të dëmtuara, të shkatërruara dhe të degraduara të zonave të mbrojturaò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe28-42të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, ku njëra monitoron dhe konstaton dhe tjetra procedon, për çdo kontroll të kryer në terren të merren masa që rastet e flagrancës të dokumentohen e ndëshkohen rastet e kundërvajtjeve administrative dhe shkeljeve ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë ka të evidentuar ndërtimet pa leje të kryera në ZM të Qarkut Lezhe, por nuk ishin raportuar pranë AKZM Tiranë. Nga informacioni i marrë nga zyra e ASHK Lezhë, rezulton seka pasur një numër të ndërtimeve pa leje dhe vetë deklarimeve për legalizim. Për këtë arsye në disa zona aty ku ka pasur edhe një dendësi të lartë të ndërtimeve është vepruar duke i shpallur Zona Informale.Këto legalizime janë bërë në mungesë të planit të menaxhimit të zonës të aprovuar në kundërshtim meligjin nr. 81/2017,ñPër zonat e mbrojturaò neni 19 ñPërdoruesit e zonave të mbrojturaò dhe Neni 25 ñVeprimtaritë në zonat e mbrojturaò ligjin nr. 2020/2020 ñPër përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisëò për parandalimin e ndërtimeve informalë. Veprime në kundërshtim me nenin nr.9 pika (ç) dhe (f) tëligjitNr.81/2017 ñPër Zonat e Mbrojturaò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1,faqe 39-41të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në sinkronizim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë të vendosi ura lidhëse me Policinë e Shtetit,dhe IKMT Bashkiake, për marrjen e të dhënave për ndërtimet informale dhe të kryeje verifikimin e tyre në terren. Gjithashtu të vendosi korrespondencë zyrtare me ASHK-n Lezhë, për shkëmbimin e informacionit për dosjet e ndërtimeve pa leje të shtrira në ZM që janë në proces legalizimi e hipotekimi, me qëllim parandalimin e legalizimit dhe prishjen e tyre në rastet kur mungon leja mjedisore e aprovuar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë kryer inventarët e viteve 2019 dhe 2020, por ende nuk është kryer inventari i vitit 2021, për këtë në AdZM nuk ka ardhur urdhër për kryerjen e inventarit të vitit 2021 nga AKZM,ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12. 2011ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, Kreu IV ñSistemi i kontrollit periodik të aktiveveò pikat 73,74. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1faqe23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë,të marrë masa për kryerjen e inventarëve brenda afateve të përcaktuara në respektim të kritereve dhe kërkesave ligjore, me qëllim kontrollin e menaxhimin e aktiveve të njësisë, për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të tyre dhe pasqyrimin e drejtë të gjendjes në pasqyrat financiare brenda afateve ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8.Gjetje nga auditimi:Nga auditimi i dokumentacionit për secilin automjet dhe për çdo muaj rezulton se në disa raste sasia e furnizuar nuk përputhej me sasinë e harxhuar, por ishte më e lartë sasia e

harxhuar me sasinë e dokumentuar në dokumentet autorizues,financiar dhe mbështetës të bashkëlidhur praktikave të konsumit të karburantit.Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar, ñDokumentimi i lëvizjes së aktiveveò pikat 34. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2,faqe23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë, të marrin masa për planifikimin e shpenzimeve të karburantit referuar volumit të punës, nevojave reale dhe normativave të harxhimit për çdo mjet me qëllim realizimin e objektivave dhe përdorimin me efektivitet të aktiveve.

-Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë të analizojnë trendin në rritje të konsumit të karburantit duke e ballafaquar me volumin e punës, inspektimet,etj, duke e argumentuar rritjen e shpenzimeve me qëllim përdorimin me efektivitet dhe mundësimin e kryerjes së punës brenda limiteve ligjore të miratuara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimit u konstatua që për periudhën objekt auditimi përkatësisht viti 2019-2020 dhe viti 2021, Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë nuk ka të planifikuar Plan Menaxhimi. Për vitin 2019 Ministria ka përgatitur Plan Menaxhimi pasi ka qënë e përfshirë në Planin e Menaxhimit të zonës Kënetore të Kune Vainit për periudhën 2010-2019 të përgatitur dhe rishikuar në Janar të vitit 2010.

Në kundërshtim kjo me nenin 42,pika 1 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2, faqe44-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në sinkron me AKZM Tiranë të kërkojnë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, përshpejtimin e miratimit të planeve të menaxhimit, për zonat e mbrojtura, për sigurimin e ruajtjes dhe mirë menaxhimit të tyre, me përfshirjen e të gjithë aktorët që janë pjesë dhe shfrytëzojnë burimet natyrore dhe vlerat kulturore, historike tëZM për 10-vjeçarin e ardhshëm.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i administrimit të Zonës së Mbrojtur Lezhëkonstatohet se institucionet si Drejtoria e Shërbimit PyjorLezhë; Bashkia Kurbin administrojnë të dhënat e viteve 1980 për nën zonat e ZM-ve me emërtimin ekonomi pyjore-kullosore.Në këtë data basë nuk ka të dhëna për sipërfaqet ujore. Gjithashtu regjistri elektronik i ZM nuk është real,pasi nuk ka të azhurnuar të dhënat e përditësuara për ndryshimet e ndodhura në sipërfaqet territoriale nën juridiksionin administrativ. Nuk ka përpunim të hartave të territoreve dhe zonimet e brendshme. Nuk ka të dhëna për ekosistemet pyjore që do të inventarizohen dhe mbarështohen, për përditësimin periodik të inventarit kombëtar të pyjeve, për hartografinë dhe dixhitalizimin e njësive të mbarështimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1,faqe40-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë me mbështetjen e AKZM-së, të bashkërendoje punën dhe të krijojë korrespondencë zyrtare me ZRVPP, Njësitë Vendore e strukturave të tjera përkatëse, për saktësimin dhe azhurnimin e përditësimeve të dhënave esipërfaqeve të ZM si dhe përpunimin e hartave të shtrirjes dhe zonimit sipas kategorive si dhe përcaktimin e kufijve të zonave dhe territoreve në pronësi apo në përdorim të njësive vendore.

Menjëherë

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se 8 procesverbale konstatimi rezultojnë të jenë pa autorë, konkretisht:

-Procesverbal i mbajtur në datë 07.03.2019;
- Procesverbal imbajtur në datë 14.06.2019;
- Proçesverbali mbajtur në datë 16.1.2020 në zonën e mbrojturnë Patok;
- Procesverbal i mbajtur në datën 18.1.2020,në zonën e mbrojturPatok- Fushë Kuqe;
- Procesverbal i mbajtur në datë 09.4.2020,në zonën e mbrojtur Kune;
- Procesverbal i mbajtur në datë 05.06.2020në zonën pyjoreFushë Kuqe;
- Procesverbal i mbajtur në datë 11.10.2020 në zonën e mbrojtur Patok- Fushe Kuqe;
- Procesverbal i mbajtur në datë 24.11.2021 në zonën e mbrojtur Kune-Vain-Tale.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim të ligjit Nr. 81/2017 ñPër Zonat e mbrojturaò.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3,faqe21-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në bashkërendim me Inspektoratin e Policisë Pyjore të marrë masa për të zbuluardhe ndëshkuar, rastet e dëmtimit, pushtimit, shpërdorimit, tjetërsimit, shkretimit dhe degradimit të zonave të mbrojtura brenda territorit të tyreò.

Menjëherë

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se, nga 9 subjekte që kanë lidhur kontratë qiraje me Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë, asnjëra prej tyre nuk ka dorëzuar pranë AdMZ Lezhë raportet e vet monitorimit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim të ligjit Nr.81/2017 ñPër zonat e mbrojturaò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4,faqe55-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dheti propozojëDrejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, zgjidhjen e kontratave për subjektet që nuk dorëzojnë pranë AdZM raportet e vet monitorimit.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë nuk ka të dokumentuar bashkëpunimi me organet ligj zbatuese si; inspektoratin e ndërtimit, inspektoratin e peshkimit, bordet e kullimit, agjencinë rajonale të mjedisit, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Zonave të MbrojturañPër organizimin dhe funksionimin të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës rajonale të zonave të mbrojturaò.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5,faqe44-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë të marrë masat e duhura ligjore dhe organizative që në bashkëpunim të dokumentuar me organet e tjera ligj zbatuese të ndalojnë procesin e degradimit dhe veprimtaritë e paligjshme brenda zonave të mbrojtura Lezhë.

Menjëherë

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatua se Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë zhvillonte kontrolledhe monitorime të Monumenteve të Natyrës në të 3 Rrethet Lezhë, Kurbin dhe Mirditë. Objektivi kryesorë i monitorimeve është promovimi i këtyre MN-ve tek turistët që shprehin interes për vizitimin e këtyre objekteve natyrore me vlera të larta turistike. Për rrethin e Lezhës janë: Ishulli i Kunes, Rera e Hedhun, Pylli rreth kishës së Shën Eufemisë , Lisi i Markatomajve. Në rrethin Kurbin: Gryka e Shkopetit, Shpella e Shena Vlashit, Ishulli i Cabokut, Burimi i Vinjollit, Plepi i Bardhe, Gështenja e Vjetër, Rrapi i Daullës. Në rrethi Mirditë: Kroi Bardhe, Shpella e Pashës, Guri i Gjonit, Guri Nuses. Nga këto monumente të natyrës AdZM Lezhë nuk merr të ardhura, nga vizitorët drejt tyre.

Këto monumente të natyrës si pjesë e zonave të mbrojtura janë burime për të garantuar të ardhura, por në fakt nuk janë vënë në eficencë, për shkak të vakumit ligjor dhe mungesës së udhëzimeve, për

menaxhimin dhe administrimin e këtyre monumenteve. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 81/2017 datë 04.05.2017 nen 17 pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 28-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

14.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës, ti japi prioritet promovimit të Monumenteve të Natyrës, si burim i të ardhurave, si dhe gradualisht të bëhet e mundur vënia në eficencë e tyre duke propozuar tarifa specifike.

Menjëherë dhe nëvazhdimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raporteve vjetore të menaxhimit të gjendjes dhe problematikave të dala në Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë u konstatua se nuk është bërë analizë faktorialë në mënyrë të detajuar si dhe nuk janë përcaktuar rrugët për zgjidhjen e tyre, nëpërmjet masave konkrete dhe vendosjen e urave të bashkëpunimit konkret me institucionet përgjegjëse. Mungon mbështetja institucionale në nivel ministror për përgatitjen e projekt-drafteve të udhëzimeve dhe marrëveshjeve të përbashkëta me institucionet e licencimit dhe që kanë tagrin e dhënieve të lejeve për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, për zvogëlimin e veprimtarive të paligjshme. Këto raporte depozitohen pranë AKZM, por nuk publikohen dhe nuk i dërgohen Bashkisë Lezhe. në kundërshtim me nenin 30 ñAdministrata Rajonale e Zonave të Mbrojturaò të rregullores të brendshme të organizimit dhe funksionimit të AKZM dhe ADZM të miratuar me datë 21.09.2015.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 5,faqe 28-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë të marrë masa që në raportet e vjetore të veprimtarisë dhe të gjendjes së ZM, të trajtohen në mënyrë sa më të detajuar problematikat e shfaqura në ruajtjen dhe mbrojtjen e burimeve natyrore si dhe të jepen rrugët konkrete dhe të propozojë plan-masat për ruajtjen dhe rimëkëmbjen e tyre. Këto raporte të bëhen publike dhe të bëhen të njohura dhe në Bashkinë Lezhe.

Menjëherë dhe nëvazhdimësi

16. Gjetje nga auditimi:Në Administratën e Zonave të Mbrojtura Lezhë janë kryer takime me banorët takime këshilluese informuese, ekzistojnë e-mail si ftesa për takime, trajnime si dhe për programet dhe axhendat e tyre të zhvillimit,por nuk ka dokumentacion shkresorevidentues për lënien e gjurmës së auditimit, që vërteton kryerjen e këtyre veprimtarive(takime),veprime në kundërshtim me *"Rregulloren e brendshme për organizmin dhe funksionimin e AdZM", neni 30 pika 1.*
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2, faqe57-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1.Rekomandimi: Administrata e Zonave të Mbrojtura Lezhë, të marre masa që në çdo takim të kryer në terren me banorët apo te interesuar siç janë organizata të ndryshme për zhvillimin e zonave të mbrojtura tõ evidentojnë nëpërmjet informacioneve ose procesverbaleve për lënie gjurme sipas rregullores së brendshme.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

VI.ANEKSE

Aneksi NR.1

Tabela për ndërtimet informal në ZM, Qarku Lezhë

Nr	Qarku	Zona e Mbrojtur	Zonimi	Subjekti/ personi	Adresa	Lloji i ndërtimit	Viti ndërtimit
1	Lezhë	Vain	ZR	A. L.	Vain	Bar Restorant Vendim K.RR.T Qarku Lezhe NR 30date 07.04.2011	1994
2	Lezhë	Vain	ZR	K.M.	Vain	Bar Restorant	1995
3	Lezhë	Vain	ZR	D.N.	Vain	Bar Restorant	1997
4	Lezhë	Vain	ZR	L. ShPK	Vain	Barake peshkimi	2007
5	Lezhë	Vain	ZR	T.L.	Vain	Bar Restorant	2008
6	Lezhë	Vain	ZR	B.T.	Vain	Beach Bar (Provizor)	2016
7	Lezhë	Vain	ZR	R.M.	Vain	Bar Restorant	2018
8	Lezhë	Vain	ZR	P.Gj.	Vain	Barake per bilanç	2008
9	Lezhë	Vain	ZR	Gj.H.	Vain	Barake per bilanç	2007
10	Lezhë	Vain	ZR	Gj. L.	Vain	Barake per bilanç	2007
11	Lezhë	Vain	ZR	V.Gj.	Vain	Barake per bilanç	2007
12	Lezhë	Vain	ZR	N. M.	Vain	Barake per bilanç	2013
13	Lezhë	Vain	ZR	D. N.	Vain	Hotel Restorant	2002
14	Lezhë	Vain	ZR	A.,A.,E. B. H.	Vain	Hotel Restorant	2002
15	Lezhë	Vain	ZB	N. Gj.	Vain	Kapanon	2015
16	Lezhë	Vain	ZPT	F.D.	Ish Fzanaeria	Shtepi banimi	1998
17	Lezhë	Vain	ZPT	Gj.Ll.	Ish Fzanaeria	Shtepi banimi	1999
18	Lezhë	Vain	ZPT	F.Gj.	Ish Fzanaeria	Shtepi banimi	1999
19	Lezhë	Vain	ZPT	M.Sh.	Ish Fzanaeria	Shtepi banimi	1999
20	Lezhë	Vain	ZPT	N.N. Ll.	Ish Fzanaeria	Shtepi banimi	1999
21	Lezhë	Vain	ZPT	M.Ll.	Ish Fzanaeria	Shtepi banimi	1999
22	Lezhë	Vain	ZPT	L.B.	Ish Fzanaeria	Shtepi banimi	1999
23	Lezhë	Vain	ZPT	Gj.B.	Ish Fzanaeria	Shtepi banimi	1999
24	Lezhë	Vain	ZPT	N.Gj.LL.	Ish Fzanaeria	Shtepi banimi	1999
25	Lezhë	Vain	ZPT	M.Gj.Ll.	Ish Fzanaeria	Shtepi banimi	1999
26	Lezhë	Vain	ZPT	P.M.	Ish Fzanaeria	Shtepi banimi	1999
27	Lezhë	Vain	ZPT	F.Gj.	Ish Fzanaeria	Shtepi banimi	1999
28	Lezhë	Vain	ZPT	A.D .Gj.	Ish Fzanaeria	Shtepi banimi	1999
29	Lezhë	Vain	ZPT	L.B.	Ish Fzanaeria	Shtepi banimi	1999
30	Lezhë	Vain	ZPT	Gj.M.	Ish Fzanaeria	Shtepi banimi	1999
31	Lezhë	Vain	ZPT	T.M.	Ish Fzanaeria	Shtepi banimi	1999
32	Lezhë	Vain	ZPT	D.S.	Lymi Sykajve	Kioske	1999
33	Lezhë	Kune	ZR	Sh.D.	Kune	Hotel	1998
34	Lezhë	Kune	ZR	A.P.	Kune	Lokal	1997
35	Lezhë	Kune	ZR	D.P.N.	Kune	Shtepi + lokal	1992
36	Lezhë	Kune	ZR	V.N.	Kune	Shtepi +lokal	1998
37	Lezhë	Kune	ZR	P.N.	Kune	Shtepi+lokal	2002
38	Lezhë	Kune	ZR	B.P.	Kune	lokal	2002

39	Lezhë	Kune	ZR	S. C.	Kune	Kioske	2015
40	Lezhë	Kune	ZR	B.M.	Kune	Kioskedruri	2015
41	Lezhë	Kune	ZR	U.P.	Kune	Kioske	2015
42	Lezhë	Kune	ZR	M.N.	Kune	Lokal	1998
43	Lezhë	Kune	ZR	S.P.	Kune	Lokal	1998
44	Lezhë	Kune	ZR	P.P.	Kune	Lokal	2005
45	Lezhë	Kune	ZR	E.P.	Kune	Lokal	2014
46	Lezhë	Kune	ZR	Z.D.	Kune	Kioskedruri (Provizor)	2017
47	Lezhë	Kune	ZR	T.P.	Kune	Shtepi+lokal	2005
48	Lezhë	Kune	ZR	E.Gj.	Kune	Lokal	2005
49	Lezhë	Kune	ZR	N.M.	Kune	Lokal	2013
50	Lezhë	Kune	ZR	M.P.	Kune	Zenjeme Zhavor	2013
51	Lezhë	Kune	ZR	F.N.	Kune	Kioskedruri (Provizore)	2017
52	Lezhë	Kune	ZR	E.M.	Kune	Kioskedruri (Provizore)	2017
53	Lezhë	Kune	ZR	E. D.	Kune	Kioskedruri (Provizore)	2017
54	Lezhë	Kune	ZR	A.Gj.	Kune	Kioskedruri (Provizore)	2019
55	Lezhë	Kune	ZPT	O.D.	Stomi ishull Shengjin	Lokal druri	2019
56	Lezhë	Tale	ZR	M. L.	Tale	Kjoske druri	2005
57	Lezhë	Tale	ZR	Gj.L.	Tale	Kjoske metalike	2005
58	Lezhë	Tale	ZR	V.M.	Tale	Kjoske druri	2019
59	Lezhë	Tale	ZPT	A.C.	Tale	Kjoske	2005
60	Lezhë	Tale	ZPT	T. D.	Tale	Kjoske druri	2005
61	Lezhë	Tale	ZPT	K.F.	Tale	Objekt kollona+solet	2005
62	Lezhë	Tale	ZPT	Z.Gj.	Tale	Kjoske druri	2005
63	Lezhë	Tale	ZPT	Gj.Ll.	Tale	Vileta druri	2005
64	Lezhë	Tale	ZPT	P.D.	Tale	Ndertes 1 kat	2005
65	Lezhë	Tale	ZPT	R.Xh.	Tale	Ndertes 3 kat	2005
66	Lezhë	Tale	ZPT	P.L.	Tale	Ndertes 3 kat	2000
67	Lezhë	Tale	ZPT	L. M.	Tale	Kost.metalik+beton	2005
68	Lezhë	Tale	ZPT	I.R.	Tale	Local druri	2015
69	Lezhë	Tale	ZPT	R.B.	Tale	Local	2008
70	Lezhë	Tale	ZPT	S.L.	Tale	Lokal	2015
71	Lezhë	Tale	ZPT	A. R.	Tale	Lokal	2000
72	Lezhë	Tale	ZPT	Gj.L.	Tale	Resort	2007
73	Lezhë	Tale	ZPT	F.B.	Tale	Ndertes 5 katesh	2012
74	Lezhë	Tale	ZPT	M.L.	Tale	Bar	2000
75	Lezhë	Tale	ZPT	K.P.	Tale	Kjoske druri	2000
76	Lezhë	Tale	ZPT	A.P.	Tale	Lokal+dhomaplazhi	2008
77	Lezhë	Tale	ZPT	A.A.	Tale	Ndertes 2 katesh	2000
78	Lezhë	Tale	ZPT	Xh.K.	Tale	Kioske druri	2012
79	Lezhë	Tale	ZPT	M.B.	Tale	Ndertes 2 katesh	2000
80	Lezhë	Tale	ZPT	I.D.	Tale	Kioske druri	2012
81	Lezhë	Tale	ZPT	L.L.	Tale	Ndertes	2012
82	Lezhë	Tale	ZPT	A. Ll.	Tale	Kioske druri	2015
83	Lezhë	Tale	ZPT	P.N.	Tale	Ndertes druri	2012
84	Lezhë	Tale	ZPT	R. K.	Tale	Kioske hekuri	2012
85	Lezhë	Tale	ZPT	P.Ll.	Tale	Kioska druri	2007
86	Lezhë	Tale	ZPT	P.P.	Tale	Rrethim +Kioske me konstruksion metalik	2007
87	Lezhë	Tale	ZPT	A. Ll.	Tale	Kioske druri	2015
89	Lezhë	Tale	ZPT	B. L.	Tale	Ndertes druri	2012
90	Lezhë	Tale	ZPT	R. K.	Tale	Kioske hekuri	2012

91	Lezhë	Tale	ZPT	Sh.B.	Tale	Kioske druri	2012
92	Lezhë	Tale	ZPT	D. P.	Tale	Kioske druri	2018
93	Lezhë	Tale	ZPT	Sh.D.	Tale	Shpia druri	2015
94	Lezhë	Tale	ZPT	N.D.	Tale	Lokal breg detit	2008
95	Lezhë	Tale	ZPT	Gj.M.	Tale	Objekt kater katesh	2009
1	Lezhë	Patok	ZPQ	V. N. Gj.	Patok	Mbushje me zhavor	2017
2	Lezhë	Patok	ZPQ	Sh.H.	Patok	Mbushje me zhavor	2006
3	Lezhë	Patok	ZPQ	G. L.	Patok	Mbushje me zhavor	2010
4	Lezhë	Patok	ZPQ	F. F.	Patok	Lokalñ Palmaò 1 katesh	2013
5	Lezhë	Patok	ZPQ	P. D.	Patok	Lokal	2007
6	Lezhë	Patok	ZPQ	F. M.	Patok	Lokal 1.5katesh, 9 kioska (belvedete) druri me shtylla drurine uje.	2003
7	Lezhë	Patok	ZPQ	S.S.	Patok	Lokal 1.5katesh. 12 kioska druri me shtylla drurine uje	2003
8	Lezhë	Patok	ZPQ	M.Ç.	Patok	Lokal2 katesh me mbushje zhavorr ne dy anet . me Leje NdertimiNr 17 - 16.09.2003 KRRT,Q.Lezhe. 17 kioska druri me shtylla drurine uje.	2003
9	Lezhë	Patok	ZPQ	Y.M.	Patok	Lokal 2 katesh	2010
10	Lezhë	Patok	ZPQ	V.V.	Patok	Lokal ñLaguna e vjeterò2 kat. Me hedhje zhavorri e guresh anash. 7 kioska (belvedete) druri me shtylla drurine uje.	2010
12	Lezhë	Patok	ZPQ	B.V.	Patok	Lokal ñMario Fishò4 kioska druri me shtylla drurine uje.	2012
13	Lezhë	Patok	ZPQ	Z.T.	Patok	Lokal1 kat.93 m2. 6 kioska druri me shtylla druri ne uje .	2000
14	Lezhë	Patok	ZPQ	M. D.	Patok	Objekt i adaptuar ne lokal	2000
15	Lezhë	Patok	ZPQ	R.M.	Patok	Ambjente 2 katesh.	1996
16	Lezhë	Patok	ZPQ	R.M.	Patok	Lokal ñBrilantò 1 kat. me parking perpara	2011
17	Lezhë	Patok	ZPQ	Z.U.	Patok	Lokal ñPerla e Patokutò 2 kat. Leje Ndertimi .Nr 38- 16.11.2006 te KRRT Q. Lezhe.	2006
18	Lezhë	Patok	ZPQ	A. D.	Patok	Shtepi, hotel	2000
19	Lezhë	Patok	ZPQ	Gj. C.	Patok	Shtepi, local, vask rasati e rrethume 2 kat.	2012
20	Lezhë	Patok	ZPQ	S. V.	Patok	Local 1 kat + kioska drurit	2014
21	Lezhë	Patok	ZPQ	B.P.	Patok	Siperfaqe e mbushur me zhavorre me mure nga	2013

						uje .	
22	Lezhë	Patok	ZPQ	E.P.	Patok	Ambjente pune per peshkatarette subjektit ñTeki 03ò+Bar restorant	2013
23	Lezhë	Patok	ZPQ	M. Gj.	Patok	Lokal +barake peshkimi	2000
24	Lezhë	Patok	ZPT	V. C.	Godull	Stalle blegtorie	2012
25	Lezhë	Patok	ZR	Sh.K.	Patok I vjeter	Shtepi banimi	2008
26	Lezhë	Patok	ZR	Peshkataret	Plazhi godulles	Baraka druri 20 cope	2000